

MEDIA SHQIPTARE DHE STANDARDET EVROPIANE

**Raport i bazuar mbi Treguesit e Këshillit të Evropës
mbi Median në Demokraci**



**Albanian Media Institute
Instituti Shqiptar i Medias**

MEDIA SHQIPTARE DHE STANDARDET EVROPIANE

**Raport i bazuar mbi Treguesit e Këshillit të Evropës
mbi Median në Demokraci**



Kingdom of the Netherlands

Studimi është botuar me ndihmën financiare të Mbretërisë së Vendeve të Ulëta. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësia e vetme e Institutit Shqiptar të Medias dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta.

Botimi u hartua nga Ilda Londo, koordinatore e kërkimeve, Instituti Shqiptar i Medias. Bashkëpunuan për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave: Aleksandra Bogdani nga *Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative*, Dorian Matlija nga *Respublica*, Aleksandër Çipa nga *Unioni i Gazetarëve Shqiptarë*, Rrapo Zguri nga *Departamenti i Gazetarisë* në Universitetin e Tiranës, si dhe Blendi Salaj nga *Këshilli i Medias*.

Botues:



Albanian Media Institute
Instituti Shqiptar i Medias

Rr. Gjin Bue Shpata, Nr.8, Tiranë, Albania

Tel./fax: ++ 355 4 2229800

E-mail: info@institutemedia.org

www.institutemedia.org

TREGUESI I LËNDËS:

Parathënie	5
Hyrje	7
Media shqiptare në shifra dhe fakte	9
Mbrojtja e Lirisë së Shprehjes dhe Informimit	11
Liria për të Kritikuar Zyrtarët Qeveritarë	16
Domosdoshmëria dhe Proporcionaliteti i Kufizimeve të Lirisë së Shprehjes	19
Liria për Ushtrimin e Gazetarisë	21
Aksesi i Partive Politike në Media	23
Mosdiskriminimi i Gazetarëve të Huaj	26
Liria për të Zgjedhur Gjuhën e Komunikimit	28
Mbrojtja e Anonimit për Burimet Konfidenciale të Informacionit	30
Kufizimi i të Drejtave Ekskluzive të Raportimit	31
Proporcionaliteti i Mbrojtjes së Jetës Private dhe Sekretit Shtetëror	32
Mbrojtja e të Drejtave të Punës dhe të Drejtave Sociale të Gazetarëve	34
Liria e Gazetarëve për të Marrë Pjesë në Sindikata	36
Mbrojtja e një Politike Editoriale të Pavarur	38
Mbrojtja e Sigurisë së Gazetarëve	41
Paanshmëria dhe Efikasiteti i Autoriteteve Rregullatore	43
Akses i Barabartë në Rrjetet e Transmetimit dhe Shpërndarjes	47
Liria në Përdorimin e Internetit dhe Aksesi në Mediat e Huaja	49
Parandalimi i Monopoleve dhe Zhvillimi i Pluralizmit	51
Shpërndarja e Drejtë e Fondeve Shtetërore	55
Pavarësia e Transmetuesit Publik	58
Mbrojtja e Autonomisë Editoriale të Transmetuesit Publik	63
Dukuria e Padëshiruar e Pronësisë së Fshehtë të Shtetit në Media	65
Papajtueshmëria midis Postit Publik dhe Angazhimit Profesional në Media	66
Hapja e Institucioneve ndaj të Gjitha Mediave	67
Preferenca për Vetërregullim në Media	69
Respektimi i Kodit të Sjelljes për Gazetarët	71
Kujdesi i Kuvendit ndaj Zhvillimit të Lirisë së Medias	73
Analizë e situatës të medias në Shqipëri	74
Rekomandime	78

Parathënie

Cili është kuptimi i lirisë së shprehjes në demokraci? Roli i shtypit është thelbësor në çdo vend, pasi ai jep ndihmesën në ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë, me qytetarë aktivë që mund të marrin vendime të mirëinformuara. Për këtë arsye, Holanda e konsideron lirinë e shprehjes, si online, ashtu dhe offline, si një përparësi kryesore në politikën tona për të drejtat e njeriut. Ne luftojmë për pavarësinë e gazetarëve dhe kërkojmë vëmendje për sigurinë e tyre. Gazetarët duhet të jenë në gjendje të flasin lirshëm dhe të kenë kohën dhe hapësirën për të hetuar tema me rëndësi për publikun. Ambasada holandeze në Tiranë përpiqet të amplifikojë zërin e shoqërisë civile duke ofruar mbështetje në fushën e shtetit ligjor dhe të të drejtave të njeriut, duke pasur si qëllim kryesor fuqizimin e qytetarëve dhe institucionet të pavarura dhe të besueshme.

Është kënaqësi për mua të paraqes këtë raport për gjendjen e medias në Shqipëri. Raporti botohet nga Instituti Shqiptar i Medias dhe ndjek listën “Indikatorët për Median në Demokraci” të hartuar nga Këshilli i Evropës. Raporti paraqet një analizë metodologjike të gjendjes së medias në Shqipëri, duke u nisur nga një listë standardesh. Ai mund të shërbejë si model për analizë periodike të medias dhe për të monitoruar progresin në të ardhmen.

Qëllimi kryesor i raportit është të rrisë ndërgjegjësimin për lirinë e medias dhe lirinë e shprehjes në Shqipëri mes aktorëve kryesorë, të tillë si qeveria, hartuesit e politikave, institucionet mediatike, profesionistët e medias, shoqatat profesionale, ekspertët e medias, si dhe shoqëria civile. Të gjithë shtetet anëtare të BE janë anëtarë të Këshillit të Evropës dhe për pasojë kanë detyrimin që të zbatojnë normat e vendosura nga Këshilli i Evropës. Kjo vlen edhe për shtetet candidate si Shqipëria.

A mendoni se media shqiptare është e lirë dhe e pavarur? A e garanton këtë liri legjislacioni në fuqi dhe a zbatohet ai? Si janë standardet e medias shqiptare në krahasim me standardet evropiane? Përgjigjet për këto pyetje do t'i gjeni në këtë raport, i cili gjithashtu ofron rekomandime për përmirësim të gjendjes. Pasi, siç ka thënë Znj. Dunja Mijatovic, Komisionerja për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Evropës: “Kufizoni aksesin në informacion dhe mundësitë tuaja për t'u zhvilluar do të ngushtohen. Hapini kanalet e komunikimit të lirë dhe shoqëria juaj do të gjejë mënyra për të lulëzuar.”

Dewi van de Weerd

Ambasadore e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta

Hyrje

Parimi i lirisë së medias dhe roli i saj i rëndësishëm në mbarëvajtjen e një shoqërie demokratike njihet dhe pranohet nga të gjithë, por ky ndikim vështirë se mund të matet dhe të vlerësohet në mënyrë empirike. Përgjatë viteve janë hartuar dhe aplikuar rregullisht një mori metodash, me indekse dhe indikatorë të ndryshëm, por është e vështirë të gjendet një mënyrë e pranuar botërisht për të matur me saktësi lirinë e medias dhe rolin e saj në shoqëri dhe vende të ndryshme.

Secila metodë e matjes dhe vlerësimit të nivelit të lirisë të shprehjes ka avantazhet dhe problemet e saj, dhe për më tepër chdo analizë duhen të zhvillohet në kuadër të karakteristikave të veçanta të secilit vend. Megjithëse këto analiza nuk mund të japin rezultate matematikisht të përpikta, nuk ka dyshime për vlerën e tyre në testimin e nivelit të lirisë dhe pavarësisë së medias, si dhe nivelin e demokratizimit të një shoqërie. Janë krijuar dhe përdorur një sërë treguesish dhe mënyrash vlerësimi nga institucione dhe organizma të ndryshme, si IREX (- Treguesi i Qëndrueshmërisë së Medias apo MSI,) UNESCO, Freedom House, Reporterët pa Kufij (Reporters without borders), Banka Botërore, Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve (Committee to Protect Journalists), Federata Evropiane e Gazetarëve (European Federation of Journalists), etj. Megjithëse metodat e përdorura për të analizuar lirinë e medias ndryshojnë nga njëra tjetra, që të gjithë këta tregues bazohen kryesisht mbi lirinë e shprehjes si themeli i domosdoshëm për ndërtimin e një shoqërie demokratike.

Treguesit e përdorur në këtë raport për të vlerësuar nivelin e lirisë së medias, si dhe lirinë e informimit dhe lirinë e shprehjes, është lista e Treguesve për Median në Demokraci, që është hartuar nën patronazhin e Këshillit të Evropës. Kjo listë dhe Rekomandimi 1848/2008 u miratuan në vitin 2008 nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës që i sugjeron vendeve anëtare, dhe veçanërisht parlamenteve të tyre, që të hartojnë raporte periodike mbi lirinë e medias duke u bazuar mbi këtë listë me tregues. Edhe rekomandimi i sugjeron Komitetit Ministror të Këshillit të Evropës që të përdorë këtë listë për të bërë një vlerësim të përgjithshëm në lidhje me situatën e lirisë së medias në vendet anëtare.

Lista *Treguesit për Median në Demokraci* e hartuar nga Këshilli i Evropës rreshton 27 parametra apo tregues mbi lirinë e medias, që përcaktojnë edhe standardet e ideale të Këshillit të Evropës. Këta tregues janë përzgjedhur që të analizojnë gjendjen e medias në një diversitet vendesh anëtare të Këshillit të Evropës. Kjo listë përfshin ato që konsiderohen si elemente themelore për sigurimin e lirisë së medias në një shoqëri demokratike. Lista e treguesve fokusohet më shumë tek mediat tradicionale, duke u përqendruar kryesisht mbi vlerat themelore që sigurojnë garantimin e lirisë së medias dhe profesionalizmit, dhe jo aq shumë mbi zhvillimet e fundit në mediat online.

Përdorimi në praktikë i Treguesve për Median në Demokraci

Ky studim, që bazohet mbi listën e Këshillit të Evropës të treguesve për median në demokraci synon të bëjë një analizë të situatës aktuale të medias shqiptare në raport me standardet e paraqitura në këtë listë. Qëllimi i këtij studimi është të ndërgjegjësojë aktorët kryesorë si, politikëbërësit, përfaqësuesit e qeverisë, punonjësit e medias, organizata profesionale, ekspertët e medias, dhe shoqërinë civile, mbi situatën aktuale të medias në vend.

Për hartimin e këtij raporti janë përdorur një sërë metodash dhe instrumentesh, si dhe janë mbledhur opinionet e faktorëve që ndikojnë në aspektin ligjor, politik, ekonomik, dhe profesional të funksionimit të medias. Përveç mbledhjes dhe shqyrtimit të të dhënave statistikore nga burime publike të informacionit,

studimeve dhe sondazheve të mëparshme, puna kërkimore u përqëndrua mbi analizën ligjore të krahasimit të standardeve të Këshillit të Evropës me legjislacionin shqiptar, sondazhe me palët kryesore në proces, si dhe intervista të thelluara me profesionistë të fushës së medias, gjykatës, përfaqësues të qeverisë, parlamentit, dhe institucioneve publike. Gjatë përgatitjes së këtij raporti u zhvillua një sondazh, me anë të një pyetësoi të përpiluar posaçërisht për këtë studim, që iu shpërnda 110 kryeredaktorëve, pronarëve të medias, dhe gazetarëve të disa organeve mediatike në vend, duke përfshirë edhe përfaqësues nga minoritetet kombëtare. U zhvilluan një numër intervistash të thelluara me pronarë dhe drejtues mediash, redaktorë të organeve kryesore të medias në vend, si dhe me faktorë të tjerë me peshë në tregun mediatik, si Autoriteti i Mediave Audiovizive, radio televizioni publik RTSH, shoqatat e gazetarëve, organizatat profesionale, Këshilli i Medias, gazetarë nga media të ndryshme, etj.

Ky studim u zhvillua me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri, nga Instituti Shqiptar i Medias, në bashkëpunim me organizatat partnere, si Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative (BIRN), Respublica, Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, Departmenti i Gazetarisë në Universitetin e Tiranës, dhe Këshilli i Medias.

Media shqiptare në shifra dhe fakte

Treguesit	Shifrat	Burimi	Shënim
Numri i mediave të shkruara	Rreth 200 19 gazeta të përditshme	IDRA, e cituar në Monitorimin e Pronësisë së Medias, Shqipëri	Nuk ka listë zyrtare të regjistrimit të mediave të shkruara.
Numri i televizioneve	Pesë liçensa digjitale kombëtare 56 stacione televizive lokale 98 televizione kabllore	Autoriteti i Mediave Audiovizive	Të dhëna për vitin 2018
Numri i stacioneve të radios	51 stacione lokale Katër radio komunitetesh	Autoriteti i Mediave Audiovizive	Të dhëna për vitin 2018
Numri i mediave online	650 portale lajmesh	Unioni i Gazetarëve Shqiptarë	Të dhëna për vitin 2017
Numri i agjencive të lajmeve	1	Agjencia Telegrafike Shqiptare	Përkufizimi i agjencive të lajmeve ka ndryshuar disi me hyrjen e teknologjive të reja, por Agjencia Telegrafike Shqiptare është e vetmja agjenci lajmesh në kuptimin tradicional të fjalës.
Numri i radiove publike	5 programe kombëtare 4 programe lokale	RTSH	
Numri i televizioneve publike	8 programe kombëtare të RTSH-së 4 programe lokale	RTSH	
Numri i punonjësve në sektorin e medias	6,200	Unioni i Gazetarëve Shqiptarë	Nuk ka të dhëna zyrtare. Të dhëna nga shoqata e gazetarëve për vitin 2018.
Numri i gazetarëve	2,700	Unioni i Gazetarëve Shqiptarë	Nuk ka të dhëna zyrtare. Të dhëna nga shoqata e gazetarëve për vitin 2018.
Numri i punonjësve të radio televizionit publik	960	RTSH	Mars 2018
Numri i anëtarëve në shoqatat e gazetarëve	786	Unioni i Gazetarëve Shqiptarë	Të dhëna për vitin 2018
Burimet e informacionit të përdorura nga popullata	TV: 97 për qind Rrjete sociale: 56 për qind Media online: 44 për qind Shtypi: 25 për qind Radio: 9 për qind	Sondazhi i IDRA-s mbi pandëshkueshmërinë.	Sondazh i zhvilluar në vitin 2017 përfshin edhe një renditje të preferencave për burimin e informacionit, shifrat paraqesin shumën totale nga renditjet.

Përqindja e individëve që përdorin internetin	66.36 për qind	Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve (ITU)	Të dhëna për vitin 2016.
Përqindja e shtëpive me televizor	99.2 për qind	ITU	Të dhëna për vitin 2015.
Përqindja e shtëpive me akses në internet	37 për qind	ITU	Të dhëna për vitin 2017.
Fondi total i reklamave	38.4 milionë Euro	IDRA, cituar në revistën Monitor	Shifra që mendohet se është shpenzuar për vitin 2017, përfshi edhe reklamat në ambiente të hapura
Tregu i reklamave për median e shkruar	2 milionë Euro	IDRA, cituar në revistën Monitor	Shifra që mendohet se ka arritur për vitin 2017
Tregu i reklamave për mediat në internet	2.4 milionë Euro	IDRA, cituar në revistën Monitor	Shifra që mendohet se ka arritur për vitin 2017
Tregu i reklamave për televizionin	30.4 milionë Euro	IDRA, cituar në revistën Monitor	Shifra që mendohet se ka arritur për vitin 2017
Tregu i reklamave për radion	0.7 milionë Euro	IDRA, cituar në revistën Monitor	Shifra që mendohet se ka arritur për vitin 2017
Bilanci vjetor i televizioneve	36% e televizioneve: fitim 0-500,000 lekë 10% e televizioneve: fitim 500,000 -1 milionë lekë 12% e televizioneve: fitim 1-5 milionë lekë 5% e televizioneve: fitim 5-15 milionë lekë 5% e televizioneve: fitim 20-30 milionë lekë 3% e televizioneve: fitim 200-300 milionë lekë 28% e televizioneve: dalin me humbje	AMA, Buletini periodik Nr.2	Të dhëna për vitin 2016
Bilanci vjetor i stacioneve të radios	47% e stacioneve të radios: fitim 0 - 500,000 lekë 10% e stacioneve të radios: fitim 500,000 -1 milionë lekë 15% e stacioneve të radios: fitim 1-5 milionë lekë 7% e stacioneve të radios: fitim: 5-15 milionë lekë 2% e stacioneve të radios: fitim 20-30 milionë lekë 20% e stacioneve të radios dalin me humbje	AMA, Buletini periodik Nr.2	Të dhëna për vitin 2016
Përqindja e gazetarëve në personelin e radiove dhe televizioneve	TV: 27 për qind Radio: 29 për qind	AMA, Buletini periodik Nr.2	Të dhëna për vitin 2016

Mbrojtja e Lirisë së Shprehjes dhe Informimit

Treguesi I – E drejta për të gëzuar lirinë e shprehjes dhe informimit nëpërmjet medias duhet të jetë e garantuar me ligj, dhe kjo e drejtë duhet të jetë e zbatueshme në terren. Një numër i madh çështjesh gjyqësore në mbrojtje të kësaj të drejte është tregues i qartë i problemeve në zbatimin e legjislacionit kombëtar mbi median dhe tregon nevojën për përmirësimin e legjislacionit apo praktikave gjyqësore.

Vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare që merren me lirinë e shprehjes e cilësojnë Shqipërinë si vend pjesërisht të lirë. Freedom House e klasifikoi Shqipërinë në vitin 2017 si një vend pjesërisht të lirë, ndërsa organizata Reporterët pa Kufij (Reporters without Borders) e renditi Shqipërinë në vendin e 76 ndërmjet 180 shteteve. Sipas vlerësimeve të IREX nota e Shqipërisë për lirinë e shprehjes u ul nga 2.82 në 2.63 gjatë vitit 2017.

Edhe gazetarët shqiptarë kanë një opinion të zymtë mbi perspektivat e zbatimit në praktikë të lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias. Nga një anketim¹ i zhvilluar me redaktorë dhe gazetarë rezultoi se 39 përqind e tyre mendojnë se liria e shprehjes dhe medias has në shumë pengesa serioze në realitet, ndërsa 31 përqind e tyre thanë se në Shqipëri nuk ekzistojnë kushtet e nevojshme për të garantuar lirinë e medias. Vetëm katër përqind e redaktorëve dhe gazetarëve thanë se media është plotësisht e lirë, ndërsa 22 përqind e tyre mendonin se liria e medias çënohet vetëm në raste sporadike.

Legjislacioni mbi median

Në Shqipëri liria e shprehjes dhe e medias mbrohet dhe garantohet me ligj. Pikë së pari kjo e drejtë mbrohet nga Kushtetuta, dhe përforcohet më tej me Ligjin për Shtypin dhe Ligjin për Mediat Audiovizive. Shqipëria ka ratifikuar gjithashtu edhe traktate e marrëveshje ndërkombëtare për mbrojtjen e lirisë së fjalës dhe lirisë së medias, si Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Megjithëse kushtetuta e pranon faktin se liritë themelore, duke përfshirë këtu edhe lirinë e medias dhe informimit, mund të kufizohen në raste të veçanta, ajo e bën të qartë se këto kufizime “nuk mund të çënojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut” (Neni 17). Për më tepër, Kushtetuta garanton të drejtat kundrejt çdo kufizimi të mundshëm duke deklaruar se çdo kufizim i të drejtave dhe lirive mund të vendoset vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, dhe se ky kufizim duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka diktuar atë. (Neni 17)

Kushtetuta garanton në mënyrë të veçantë lirinë e shprehjes, si dhe lirinë e shtypit, radios, dhe televizionit, si dhe ndalon censurën paraprake (Neni 22.) Kushtetuta mbron të drejtën e informimit, duke deklaruar se kushdo ka të drejtë të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. (Neni 23) Liria e medias garantohet gjithashtu edhe nga Ligji për Shtypin dhe Ligji për Mediat Audiovizive, ndërsa e drejta e informimit përforcohet akoma më shumë me Ligjin për të Drejtën e Informimit, që u miratua në vitin 2014.

Sidoqoftë, garancitë dhe mbështetja ligjore ndaj lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias nuk sigurojnë një mbrojtje gjithëpërfshirëse. Fyerja dhe shpifja nuk janë eliminuar akoma plotësisht nga legjislacioni penal megjithë ndërhyrjet e shumta dhe presionin nga shoqëria civile, si dhe rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare për të ndryshuar këto ligje. Një përpjekje e politikës për ta rikthyer shpifjen në shkelje penale

¹ Të dhëna nga sondazhi i zhvilluar për këtë studim.

dështoi si rezultat i një presioni të menjëhershëm nga ana e gazetarëve dhe shoqërisë civile, dhe ky rast tregoi edhe njëherë se arritjet e deritanishme në fushën ligjore mbi lirinë e shprehjes nuk janë të garantuara dhe të pakthyeshme. Tendenca e gjykatave për të anonimizuar të dhënat personale në proceset gjyqësore, në emër të mbrojtjes së të drejtës për privatësi, është një hap prapa në krahasim me standardet e larta të vendosura nga Ligji për të Drejtën e Informimit.

Një tjetër problem shqetësues, që është kthyer së fundmi në qendër të vëmendjes të debatit për legjislacionin mbi lirinë e shprehjes dhe informimit, është edhe mungesa e pasqyrit në ligj të zhvillimeve teknologjike në fushën e informacionit. Legjislacioni aktual mbi median i referohet vetëm mediave tradicionale (me përjashtim të platformave informative në internet që përmenden në Ligjin për Mediat Audiovizive vetëm në lidhje me anën teknike të liçensimit të tyre). Disa nisma ligjore në këtë drejtim kanë dështuar apo janë shtyrë, por ato kishin prirjen për të propozuar masa shumë të vështira për t'u zbatuar në realitet, apo parashikonin rregulla më të ashpra mbi përmbajtjen mediatike, sidomos në lidhje me përmbajtjen e materialeve që botohen nga përdoruesit e këtyre mediave.

Mbrojtja Institucionale

Mbrojtja institucionale e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias nuk është aq e fortë sa duhet: ato institucione që duhet të ndikojnë më shumë në garantimin e lirisë së medias kanë marrë nota të ulëta në sondazhin e kryer me redaktorë dhe gazetarë. Sistemi gjyqësor u rendit në vend të fundit në lidhje me mbrojtjen e lirisë së medias (0.9 përqind), i ndjekur nga partitë politike dhe institucionet qeveritare (nga 1.7 përqind secili), organizmat rregullatore (4.3 përqind) dhe legjislacioni aktual (7.8 përqind). Sipas të anketuarve mbrojtjen më efektive të lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias e siguron vetë media dhe gazetarët (42 përqind), institucionet e pavarura shtetërore si Avokati i Popullit dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit (secili me nga 24 përqind), të ndjekura më pas nga organizatat e gazetarëve (19 përqind) dhe organizatat ndërkombëtare (17 përqind.) Policia dhe organizatat e shoqërisë civile ishin diku në mes me respektivisht 11 përqind dhe 10 përqind.

Niveli i ulët i besimit të gazetarëve ndaj gjyqësorit pasqyron përshtypjen negative të popullsisë ndaj këtij institucioni që po i nënshtrohet një reforme të përgjithshme për të ulur nivelin e korrupsionit dhe për të rritur efektivitetin e punës së tij. Në fakt proceset gjyqësore ndaj organeve të medias apo gazetarëve kanë qenë të rralla, përshi këtu edhe rastet për shpifje, gjë që pasqyron edhe mungesën e dëshirës nga qytetarët për t'u marrë me gjykatat, pjesërisht si pasojë e kohës shumë të gjatë deri në përfundimin e proceseve gjyqësore, por edhe si rezultat i nivelit të ulët të besimit në objektivitetin dhe efikasitetin e gjykatave.

Vetëm katër përqind e 110 redaktorëve dhe gazetarëve të pyetur në këtë sondazh mendonin se sistemi gjyqësor mbron në masën e duhur lirinë e medias në vend², ndërsa 40 përqind e tyre thanë se sistemi i drejtësisë nuk e siguron dot këtë lloj mbrojtjeje pasi nuk ishte fare efikas. Nga ana tjetër, 28.7 përqind e gazetarëve në sondazh mendonin se gjykatësit nuk e mbronin lirinë e medias pasi ishin të korruptuar dhe nën ndikimin e interesave dhe influencave të ndryshme. Së fundmi 13 përqind besonin se gjykatësit nuk kishin njohuri të mjaftueshme mbi lirinë e shprehjes.

Një rekomandim i vazhdueshëm i progres raporteve të Bashkimit Evropian ka qenë edhe nevoja për trajnime në lidhje me lirinë e shprehjes, veçanërisht për sa i përket shpifjes. Nuk ka patur shumë raste të hedhjes në gjyq të gazetarëve për shpifje, madje edhe shumica e atyre nuk ka shkuar deri në fund pasi pala paditëse është tërhequr nga procesi. Nga ana tjetër numri i padive për shpifje nga ana e politikanëve është më i lartë. Një studim³ i kryer mbi vendimet e gjykatave për këto raste në raport me praktikën e Gjykatës Evropiane të të

² Të dhëna nga sondazhi i zhvilluar për këtë studim.

³ ISPL, "Praktika gjyqësore në çështjet e shpifjes," 2015.

Drejtave të Njeriut (ECHR) tregoi se në përgjithësi gjykatësit shqiptarë i jepnin prioritet lirisë së shprehjes. Megjithatë citimet nga ana e gjykatave të praktikave dhe vendimeve të Gjykatës Evropiane duket se nuk përkonin gjithmonë dhe nuk ishin në të njëjtën linjë me vendimet origjinale të ECHR⁴.

Në praktikën e gjykatave shqiptare duket se gjykimet civile janë më të pakta në numër në krahasim me gjykimet penale. Ndryshimet e bëra në Kodin Civil në vitin 2012 përcaktuan një listë të gjatë kriteresh që duheshin patur parasysh kur të vlerësohej përgjegjësia civile në lidhje me dëmtimin e nderit dhe reputacionit të një individi. “Dispozitat e reja ligjore përcaktojnë 11 faktorë specifikë jo-shterues që duhen marrë parasysh nga gjykatat për të përcaktuar përgjegjësinë. Në këto raste duhet të shikohet: nëse deklaratat në media janë paraqitur si fakt apo opinion; nëse janë të vërteta apo të rreme, nëse i referohen saktësisht thënieve të një pale të tretë; nëse kanë lidhje me një ‘çështje me interes publik, persona në poste qeveritare, apo që konkurrojnë në zgjedhje’; dhe nëse autori ka respektuar rregullat e etikës profesionale (për shembull në rastet e mediave dhe profesionistëve të fushës së informimit).”⁵ Sidoqoftë shoqatat që mbështetin lirinë e shprehjes shprehin shqetësimin se pavarësisht listës së detajuar që duhet të orientojë gjykatësit, gjykimet civile mbartin rrezikun e gjobave dhe penalizimeve më të larta që mund të vendosen edhe në mënyrë arbitrare.

Koha veçanërisht e gjatë që harxhohet nga gjykatat për paditë civile është një tjetër faktor që duhet marrë në konsideratë për sa i përket efektit të sistemit gjyqësor ndaj medias. Sipas të dhënave të Gjykatës të Rrethit Tiranë, proceset civile për dëmshpërblime dëmi zgjatin mesatarisht 240 ditë në gjykatën e shkallës së parë, ndërsa në apel çështja mund të zgjasë edhe 12 deri në 24 muaj të tjerë⁶. Këto procese gjyqësore relativisht të gjata mund të jenë edhe shtysë për të tërhequr shumë nga paditë për shpifje, por nga ana tjetër mund të krijojë edhe një klimë pasigurie tek mediat e prekura nga këto çështje gjyqësore.

Nuk ka të dhëna statistikore mbi çështjet e shpifjeve kundër organeve të medias dhe gazetarëve. Po të kemi parasysh edhe vendimet e shumë gjykatave në vend për të fshehur identitetin e palëve të përfshira në procese gjyqësore, atëherë do të bëhet akoma edhe më e vështirë që të përcaktohet numri i saktë i këtyre çështjeve. Ministria e Drejtësisë raporton të dhëna vjetore mbi numrin e përgjithshëm të çështjeve dhe dënimeve për shpifje, por jo të dhëna specifike për çështjet ndaj gazetarëve. Sipas këtyre të dhënave, në vitin 2016 gjykatat kanë marrë vendime mbi 27 raste të padive penale për shpifje, dhe vetëm në dy raste pala e paditur është shpallur fajtorë për fyerje, në 11 raste ka dalë e pafajshme, ndërsa për pjesën tjetër të çështjeve janë tërhequr paditë⁷. Numri i çështjeve për fyerje është më i lartë: 63 raste në total, nga të cilat 16 janë vendime fajësie, 11 vendime pafajësie, ndërsa në 34 raste është tërhequr padia⁸. Megjithëse këto të dhëna statistikore nuk kanë të bëjnë vetëm me median, ato na ndihmojnë për të krijuar një ide të përgjithshme dhe për të kuptuar se rastet e padive penale që mund të çenojnë lirinë e medias janë të pakta në numër, duke patur parasysh edhe numrin e ulët të dënimeve për çështjet e shpifjeve. Numri i këtyre çështjeve nuk mendohet të jetë më i lartë se 10 në vit për kryeqytetin, dhe akoma më pak për pjesën tjetër të Shqipërisë⁹.

Ndryshe nga perceptimi për gjykatat, gazetarët mendojnë se institucionet më të rëndësishme për lirinë e medias në vend janë institucionet e pavarura shtetërore dhe organizatat profesionale të gazetarëve. Sidoqoftë duhet patur parasysh se sipas sondazhit me redaktorë dhe gazetarë ata e shohin veten e tyre si elementi

⁴ Po aty.

⁵ D. Pavli, i cituar nga Irion, K., Cavaliere, P., dhe Pavli, D. 2015. “Comparative study of best European practices of online content regulation. Law and policy of online content regulation, in particular defamation online, in the light of Albanian legislative proposals.” (Studim krahasimor i praktikave më të mira evropiane për rregullimin e mediave në internet. Legjislati dhe politikat për rregullimin e përmbajtjes online, sidomos për shpifjen online, në kuadër të propozimeve legjislative shqiptare). Studim i mbështetur nga Këshilli i Evropës, Amsterdam/ Edinburg/ Tiranë, Gusht 2015.

⁶ Të dhëna nga Respublica.

⁷ Ministria e Drejtësisë, Raporti Vjetor 2016, http://www.drejtesia.gov.al/files/userfiles/statistika/Vjetari_2016.pdf

⁸ Po aty.

⁹ Të dhëna nga Respublica.

kryesor për mbrojtjen e lirisë së fjalës, me 42 përqind të të anketuarve¹⁰. Megjithëse ka shumë shoqata të regjistruara mediash dhe gazetarësh vetëm pak prej tyre janë aktive. Zakonisht Unioni i Gazetarëve Shqiptarë reagon rregullisht me anë të prononcimeve dhe deklaratave për shtyp, organizon herë pas here protesta në mbrojtje të lirisë së medias, si dhe ndjek disa nga çështjet gjyqësore kundër medias, sidomos ato që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës. Tani së fundmi Shoqata e Gazetarëve Profesionistë është munduar të tregohet më aktive në lidhje me lirinë e medias. Ka edhe organizata të tjera, si për shembull Respublica, që ofron asistencë ligjore dhe ndjek çështjet e lidhura me median në gjykata, duke përfaqësuar dhe mbrojtur gazetarët. Organizata të tjera, si Instituti Shqiptar i Medias dhe Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative (BIRN - Balkan Investigative Reporting Network) monitorojnë shkeljet e lirisë së medias dhe mundohen të ndërjegjësojnë opinionin publik në lidhje me këto probleme. Ka patur edhe raste kur organizata të shoqërisë civile kanë krijuar një koalicion për të kërkuar (duke ia arritur me sukses) ndryshime të ligjeve të caktuara, si në rastin e shpifjes dhe të drejtës së informimit.

Tani së fundmi, pas miratimit të ligjit të ri për lirinë e informacionit në vitin 2014, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale luan një rol më të rëndësishëm në lidhje me kërkesat e gazetarëve dhe qytetarëve të tjerë për të patur akses në informacion. Kompetencat e komisionerit përfshijnë edhe shqyrtimin e ankesave nga qytetarë apo organizata të ndryshme, në rastet kur informacioni që sipas ligjit duhet të jepet refuzohet nga autoritetet publike. Zyra e komisionerit ndërhyr duke kryer rolin e ndërmjetësit midis palëve të përfshira në proces, apo duke dalë me një vendim që mund të parashikojë edhe penalizime në rast refuzimi të mëtijshëm. Në vitin 2017 kjo zyrë shqyrtoi 560 ankesa, dhe zgjidhi 395 nga këto raste nëpërmjet ndërmjetësimi¹¹. Puna dhe vendimet e kësaj zyre kanë luajtur një rol veçanërisht të rëndësishëm në fushën e gazetarisë investigative.

Shkeljet e lirisë së medias dhe të drejtave të gazetarëve në praktikë

Gjatë punës së tyre të përditshme gazetarët ndeshen me disa forma të kufizimit të të drejtave të tyre, si për shembull kërcënime apo dhunë verbale, reduktime të stafit të redaksive, ndërprerje reklamash, si dhe probleme me marrëdhëniet e punësimit. Rethanat në të cilat punojnë gazetarët ndikohen goxha nga varësia ndaj burimeve financiare (nga interesat ekonomike të pronarëve të medias kundrejt politikës si dhe reklamuesve privatë dhe shtetërorë), duke e kthyer vetëcensurën në diçka të zakonshme. Kriza aktuale ekonomike dhe dinamikat e zhvillimit të tregut mediatik ushtrojnë një presion më të madh mbi punën e gazetarëve dhe ndikojnë më shumë ndaj tendencave për vetëcensurë.

Nga sondazhi¹² i zhvilluar me redaktorë dhe gazetarë, 36 përqind e tyre nuk e pranuan se ka patur shkelje të lirisë së medias në organin mediatik ku punonin. Midis atyre që pranuan se ka patur të tilla shkelje, numri më i madh e vuri gishtin mbi ndërhyrjen në politikën editoriale, 18.3 përqind, duke përfshirë edhe ndalimin e publikimit të informacionit, përcaktimin e çështjeve dhe subjekteve që duheshin ndjekur nga gazetarët, përcaktimin e personazheve që duheshin mbështetur dhe personave të padëshirueshëm në raportim, si dhe publikimin e lajmeve të porositura. Sipas të anketuarve, një tjetër shkelje e rëndë e kësaj lirie ka të bëjë me aksesin jo të barabartë në informacion dhe diferencimin midis organeve të ndryshme të medias (15.7 përqind), si dhe ndalimin e gazetarëve nga raportimi i takimeve dhe ngjarjeve publike (12.2 përqind), e ndjekur nga shkelja e të drejtave të punës së gazetarëve (9.6 përqind.) Fakti që pronarë të mediave lokale ishin pjesë e këtij sondazhi, pasi ata bëjnë edhe punën e redaktorit, mund të ketë ndikuar në renditjen e kësaj shkeljeje vetëm në vendin e katërt, duke patur parasysh se raporte të tjera mbi median tregojnë se shkelja e të drejtave të punës është një fenomen shumë i përhapur në redaksitë e lajmeve.

¹⁰ Të dhëna nga sondazhi i zhvilluar për këtë studim.

¹¹ Të dhëna nga raporti vjetor i zyrës së Komisionerit për vitin 2017: http://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/02/RAPORTI_VJETOR_2017.pdf

¹² Të dhëna nga sondazhi i zhvilluar për këtë studim.

Për sa i përket presioneve që ushtrohen mbi median, redaktorët dhe gazetarët mendojnë se presioni më i fortë ushtrohet nga partitë politike (39 përqind), të ndjekur nga organet e pushtetit qendror dhe lokal (27.8 përqind), pronarët e medias (21.7 përqind), kompanitë që paguajnë për reklama (14.8 përqind), si dhe i njëjti nivel presioni që ushtrohet si nga sistemi gjyqësor ashtu dhe nga bota e krimit (me 7.8 përqind secili). Është interesante të përmendet fakti se 24.3 përqind e të anketuarve, grupi i tretë për nga madhësia në këtë sondazh, preferuan të mos i kthejnë përgjigje kësaj pyetjeje, apo thanë se nuk ishin në gjendje të jepnin një vlerësim në lidhje me këtë çështje.

Sipas të dhënave të Unionit të Gazetarëve gjatë vitit 2017 ka patur disa incidente gjatë punës së gazetarëve dhe shkelje të lirisë së medias. Incidenti më i rëndë që u regjistrua gjatë vitit të kaluar ishte dhuna fizike e ushtruar ndaj gazetarit Elvi Fundo, por në 2017 u regjistrua edhe një përplasje fizike e një qytetari me një gazetar të programit investigativ *Stop* gjatë një raportimi, si dhe disa raste të dokumentuara të dhunës verbale dhe kërcënimeve nga autoritete publike dhe qytetarë të thjeshtë.

Ashpërsimi i retorikës politike kundrejt medias arriti kulmin kur kryeministri ofendoi gazetarët në transmetim direkt në televizion, një problem që është vënë re disa herë gjatë viteve të fundit. Ka patur raste kur deputetë të caktuar kanë reaguar në mënyrë negative dhe të pajustificuar ndaj pyetjeve legjitime të bëra nga gazetarët, duke pretenduar se vetëm prokurorët mund të bëjnë pyetje të atilla. Gjithashtu është dokumentuar edhe një rast kërcënimi ndaj një gazetari nga kryetari i bashkisë të një qyteti të vogël.

Kërcënimet e bëra nga qytetarë të thjeshtë nuk janë dokumentuar po aq mirë, por kjo nuk do të thotë se ndodhin më rrallë, sidomos tani me intensifikimin e komunikimit në forumet në internet dhe mediat sociale. Një rast i tillë është kërcënimi i kryer nga një person fundamentalist ndaj gazetares Rudina Xhunga në lidhje me emisionin e saj për heroin tonë kombëtar Skënderbeun. Gazetarja Klodiana Lala u sulmua verbalisht nga militantë partiakë ndërsa po mundohej t'i bënte disa pyetje ish-Ministrit të Punëve të Brendshme.

Një gazetare deklaroi se nuk u lejua të hynte në ambientet e një parku arkeologjik për të raportuar mbi situatën në terren, ndërsa janë shënuar edhe raste të tjera kur gazetarë nuk janë lejuar të ndjekin takime apo ngjarje publike gjatë fushatave elektorale.

Nga ana tjetër, edhe pushimet e pajustificuara nga puna të redaktorëve dhe gazetarëve vazhdojnë të jenë problem serioz. Tedi Blushi, redaktor i portalit Balkanweb, raportoi se ishte pushuar nga puna papritur pa marrë asnjë sqarim, dhe pas shumë vitesh pune në atë media u kërcënua se do të thërrisnin policinë nëse nuk do të largohej me dëshirën tij nga zyrat e redaksisë. Edhe gazetarët Simon Shkreli dhe gruaja e tij u pushuan papritur nga puna në një televizion lokal. Drejtori i televizionit iu tha se do kishte ndryshime strukturore në redaksi, por Shkreli pretendoi se pushimi nga puna erdhi si pasojë e bindjeve të tij politike dhe disa deklaratave që kishte bërë në faqen e tij në Facebook.

Liria për të Kritikuar Zyrtarët Qeveritarë

Treguesi 2 – Ligji nuk duhet të mbrojë zyrtarët shtetërorë nga kritikrat dhe ofendimet në një masë më të madhe se qytetarët e zakonshëm, si për shembull me dispozita që parashikojnë dënime penale më të rënda në të tilla raste. Gazetarët nuk duhet të dënohen me burg, dhe po ashtu organet e medias nuk duhet të mbyllën si pasojë e komenteve dhe opinioneve kritike.

Parimi themelor i këtij treguesi është rrënjësor tashmë në legjislacionin shqiptar nëpërmjet ndryshimeve të vitit 2012 të dispozitave mbi shpifjen. Sidoqoftë, në teori gjykatat mund të vendosin akoma gjopa të larta ndaj gazetarëve dhe mediave, duke i vendosur kështu nën një presion të madh financiar. Nuk ka patur gazetarë të burgosur apo media të mbyllura si pasojë e komenteve negative ndaj politikës. Ndryshimet e bëra në Kodin Penal në vitin 2012 e hoqën dënimin me burg për shpifje dhe fyerje, edhe pse këto dispozita ishin përdorur shumë rrallë në praktikë.

Deri në vitin 2012 legjislacioni shqiptar siguronte mbrojtje të veçantë (nëpërmjet disa dispozitave të veçanta të Kodit Penal) për zyrtarë publikë si pasojë e postit që mbanin. Për më tepër, në rastet kur dyshohej për ofendim apo shpifje kundër një zyrtari publik, legjislacioni shqiptar i jepte të drejtë prokurorisë që të niste hetimet pa prituri për padinë e zyrtarit në fjalë. Kur çështja arrinte në gjykatë, vetëm dispozitat civile janë përdorur kundër medias në shumicën më të madhe të rasteve. Megjithatë thjesht fakti se shpifja dhe fyerja konsideroheshin si krime të ndëshkueshme me burg mund “t’i fuste drithmën” medias. Në vitin 2012 Kodi Penal dhe Kodi Civil u ndryshuan pas një përpjekjeje shtatë vjeçare nga *Justice Initiative* dhe Instituti Shqiptar i Medias. Legjislacioni aktual nuk siguron më mbrojtje të veçantë për zyrtarë publikë, që do të thotë se dispozitat për shpifjen aplikohen në të njëjtin nivel si për çdo qytetar të thjeshtë. Përveç neneve mbi mbrojtjen e veçantë për zyrtarë publikë, u hoqën edhe dispozitat mbi ofendimin dhe përgojimin e personaliteteve të veçanta shtetërore, si Presidenti i Republikës, dhe personaliteteve të huaja.

Sidoqoftë në 2015 u krijua përshtypja se dispozitat e mbrojtjes së veçantë mund të vendoseshin përsëri në Kodin Penal. Në Shkurt 2015 kryeministri Edi Rama përmendi në parlament se po shqyrtonin mundësinë e konsiderimit si shkelje penale të shpifjes, duke sqaruar se po fliste për raste shpifjesh që kanë lidhje me detyrën zyrtare. Pas reagimeve të ashpra ai sqaroi se po i referohej vetëm akuzave të ndërsjellta nga deputetët në parlament. Në tetor 2015 Këshilli i Ministrave propozoi papritur disa ndryshime në Kodin Penal, që kishin për qëllim ta kthenin përsëri shpifjen si subjekt i legjislacionit penal, dhe t’i jepnin zyrtarëve publikë mbrojtje të veçantë ndaj shpifjeve. Projektligji propozonte që shpifja kundër një zyrtari të lartë qeveritar, apo të zgjedhur në votime, të konsiderohej si shkelje penale që dënohej me gjobë apo burgim deri në tre vjet. Hartimi i këtij projektligji pa asnjë paralajmërim apo konsultime shkaktoi një reagim të menjëhershëm nga komuniteti mediatik si dhe thirrje për protesta nga organizatat e gazetarëve. Si rezultat i këtij presioni qeveria e tërhoqi atë propozim, por kryeministri nguli këmbë se kjo drejtohej vetëm ndaj disiplinimit dhe rregullimit të gjuhës së debatit midis deputetëve dhe nuk drejtohej kurrësi kundër lirisë së medias apo lirisë së shprehjes.

Tendencat kryesore e momentit janë paditë për shpifje të politikanëve kundër njëri-tjetrit, dhe këto padi nuk drejtohen aq shumë ndaj medias dhe gazetarëve. Sidoqoftë, si pasojë e prirjes së gjykatave për të anonimizuar të dhënat e proceseve dhe vendimeve gjyqësore, nuk është e mundur që të përftohen statistika të plota mbi numrin total të padive kundër medias. Raporti përdor disa të dhëna nga gjykatat e rretheve, të cilat ende nuk janë anonimizuar tërësisht. Kurse Gjykata e Tiranës iu përgjigj kërkesës sonë për informacion duke thënë se ata nuk bënë dallimin mes gazetarëve dhe personave të tjerë në çështjet gjyqësore për shpifje dhe fyerje¹³.

¹³ Përgjigja e Gjykatës së Rrethit Tiranë ndaj kërkesës për informacion, prill 2018.

Të dhënat online për paditë penale për shpifje¹⁴ dhe fyerje nga Gjykata e Rrethit Tiranë tregojnë se ka pasur 48 çështje të tilla në 2017, 23 prej të cilave ishin për fyerje, ndërsa 25 për shpifje, dhe 30 prej tyre vajtën në seancë gjyqësore, ndërsa 18 nuk vajtën përtej fazës parapërgatitore.¹⁵ Këto shifra duket se kanë shënuar rënie krahasuar me vitin 2016, ku pati 64 padi, 33 prej të cilave për shpifje dhe 31 për fyerje, por vetëm 25 përfunduan në seancë gjyqësore.¹⁶ Megjithatë, pa konfirmim zyrtar të gjykatës nuk është e mundur të dihet se sa nga këto padi ishin kundër gazetarëve dhe medias.

Një raport mbi monitorimin e vendimeve të gjyqësorit në çështjet e shpifjes tregoi se Gjykata e Rrethit Tiranë kishte marrë 42 vendime në çështje që kishin të bënin me median apo gazetarë gjatë periudhës 2013 - qershor 2015.¹⁷ Ky studim tregoi se gjykatat kishin tendencë të mbështesnin median në vendimet e tyre, pasi gazetarët apo mediat ishin deklaruar fajtorë vetëm në tre raste, ndërsa akuzat ishin pranuar pjesërisht në 11 raste të tjera¹⁸. Sidoqoftë prirja kryesore është mbyllja e çështjeve shumë shpejt, si pasojë e tërheqjes nga pala paditëse.

Të dhënat nga gjykatat e rretheve të tjera gjithashtu tregojnë se paditë për shpifje kundër mediave janë të pakta në numër: gjatë periudhës 2012-2018, ka patur 15 vendime gjyqësore nga gjykatat e rretheve të tjera për çështje që kishin të bënin me gazetarë¹⁹. Edhe për rrethet, në ngjashmëri me të dhënat e marra nga gjykata e Tiranës për periudhën 2013-2015, dinamika e këtyre çështjeve nuk të lejon që të arrish në një përfundim të saktë mbi praktikën gjyqësore në lidhje me çështjet e shpifjes, pasi zakonisht këto çështje mbyllen për arsye teknike, dhe jo aq shumë nga arsyetimi apo interpretimi ligjor i gjykatësve mbi akuzat për shpifje dhe fyerje. Shumica e rasteve janë arkivuar si pasojë e mosparaqitjes së palës paditëse, tërheqjes së padisë nga ana e tyre, apo edhe si pasojë e ndonjë amnistie mbi kategori të caktuar shkeljesh penale, duke përfshirë këtu edhe akuzat për shpifje dhe fyerje. Disa raste të tjera në gjykatat e Gjirokastrës dhe Korçës u arkivuan për arsye të tjera²⁰: në një rast nuk ishte e mundur të gjendej adresa e organit të medias online dhe të informohej pala e paditur për çështjen gjyqësore, si dhe një rast kur gjykata e rethit nuk kishte juridiksion mbi vendndodhjen e zyrave qendrore të medias.

Nga rastet që vijnë nga gjykata e rretheve²¹, paditë për fyerje nga politikanët kundër gazetarëve janë të rralla. Nga gjykatat e rretheve një rast i tillë është edhe ai i kryetarit të këshillit të qarkut Berat Petrit Sinaj kundër Namir Lapardhasë, gazetar i organit të partisë opozitare Rilindja Demokratike, pas një artikulli të botuar në atë gazetë. Gjykata vendosi se në këtë rast nuk kishte të bënte me shpifje, dhe për pasojë se gazetari nuk mund të dënohej për këtë akuzë. Një rast tjetër që vuri kundër njëri-tjetrit administratën vendore dhe një gazetar, ishte ai që kishte të bënte me kryetarin e bashkisë së Elbasanit Qazim Sejdi kundër gazetës Telegraf, por gjykata deklaroi se nuk kishte kompetenca të shqyrtonte këtë çështje pasi gazeta i kishte zyrat qendrore në një vendndodhje jashtë juridiksionit të saj. Një rast i ngjashëm u shënuar në Korçë, ku vëllai i një deputeti të zonës hodhi në gjyq portalin e lajmeve Citynews, me qendër në Tiranë, dhe për pasojë edhe kjo çështje nuk u pranua nga gjykata. Të dyja këto çështje u gjykuan më vonë në Tiranë, por kryetari i bashkisë Elbasan u tërhoq, kurse gjykata vendosi se nuk kishte kompetencë për çështjen e Korçës, duke e dërguar sërish për gjykim në Korçë²².

¹⁴ Për shkak të anonimizimit të të dhënave dhe vendimeve të gjykatës, është e pamundur të përcaktohet numri i rasteve kundër gazetarëve në padi për shkaktim dëmi, pasi kjo është një kategori e gjerë që përfshin një gamë të gjerë dëmsh, jo vetëm ato për nderin dhe reputacionin.

¹⁵ Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Tiranë: www.gjykatatirana.gov.al

¹⁶ Po aty.

¹⁷ ISHM, Monitorim për zbatimin e ligjeve për shpifjen dhe fyerjen, 2015.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Të dhëna nga gjykatat e rretheve, www.gjykata.gov.al

²⁰ Po aty.

²¹ Po aty.

²² Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Tiranë: www.gjykatatirana.gov.al

Në këtë kontekst, do të ishte pa vend që të arrihej në përfundimin se gjykatat dhe praktikave gjyqësore ofrojnë një mbrojtje të mjaftueshme në rastet e kritikave mediatike ndaj zyrtarëve qeveritarë. Para së gjithash, të dhënat nga Gjykata e Rrethit Tiranë, që është më e madhja në Shqipëri si dhe qyteti ku ushtrojnë aktivitetin shumica dërrmuese e mediave në vend, nuk mund të merren në analizë pasi identiteti i palëve është mbajtur anonim. Së dyti, meqë shumica e këtyre rasteve janë arkivuar si pasojë e arsyeve teknike, nuk mund të themi se garancitë që ofron legjislacioni në fuqi po ndiqen me përpikmëri nga gjykatat shqiptare në mbrojtjen e medias dhe lirisë së shprehjes, megjithëse në fund të fundit mediat nuk duket të kenë pësuar ndonjë dëm nga vendimet gjyqësore. Një analizë e praktikave gjyqësore mbi çështjet e shpifjes gjatë vitit 2015 tregoi se në përgjithësi vendimet e gjykatave prireshin të favorizonin lirinë e shprehjes, sidomos në rastet kur palët në proces ishin politikanët kundër gazetarëve²³.

Një rast shpresëdhënës për praktikën gjyqësore është përfundimi i çështjes së kompanisë së ndërtimit Edil Al, në pronësinë e pronarëve të Vizion + TV, kundër Artan Ramës, producent i programeve investigative. Kompania hodhi në gjyq Ramën në 2016 pasi ai botoi një postim në profilin e vet në Facebook, ku pretendonte se tenderi që kishte fituar kjo kompani nga Ministria e Kulturës përbënte shkelje të rregullave për konfliktin e interesit, pasi i shoqi i ministres ishte një nga gazetarët kryesorë në Vizion + TV dhe kompania nuk kishte ndonjë përvojë të mëparshme në këtë fushë. Kompania kërkoi dëmshpërblim prej 150 milionë lekësh për dëmtim reputacioni. Një vit më vonë, pasi gjykata shqyrtoi procedurat e tenderit, ajo vendosi në favor të gazetarit dhe e pushoi çështjen, duke dhënë shpresë për një praktikë të mirë në të ardhmen për të gjithë gazetarët investigativë që kanë qëllim të informojnë publikun për tema të ndjeshme në lidhje me (keq) përdorimin e fondeve publike.²⁴

Për momentin një nga çështjet më të rëndësishme në gjykata ka të bëjë me rastin e Gjin Gjonit, gjykatës apeli dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë në Tiranë, dhe gruas së tij Elona Çausi. Në vitin 2017 ata hodhën në gjyq Rrjetin Ballkanik të Gazetarisë Investigative (BIRN - Balkan Investigative Reporting Network) në Shqipëri dhe gazetarët Besar Likmeta dhe Aleksandra Bogdani, si dhe gazetën e përditshme dhe portalin e lajmeve Shqiptarja.com dhe gazetarët Adriatik Doçi dhe Elton Qyno. Pala paditëse pretendoi se artikujt e botuar i përcillnin publikut informacione të pasakta, që patën një ndikim negativ mbi reputacionin, dinjitetin dhe nderin e tyre. Për pasojë ata kërkuan kompensim dëmi nga secili organ mediatik dhe gazetarët, me një shifër totale prej 83,000 eurosh. Unioni i Gazetarëve Shqiptarë doli me një deklaratë në mbështetje të plotë të gazetarëve dhe mediave ku punojnë dhe i bëri thirrje Gjin Gjonit që të japë dorëheqjen nga posti i tij për të shmangur çdo ndikim në vendimin e gjykatës dhe për të lejuar një proces gjyqësor ku të dyja palët të ishin në pozita të barabarta. Në mars 2018 paditësit nuk e vazhduan më çështjen kundër Shqiptarja.com dhe gazetarëve të saj, ndërkohë që çështja tjetër është ende në gjykatë.

²³ Instituti për Studime Publike dhe Ligjore, "Praktika gjyqësore në çështjet e shpifjes," 2015.

²⁴ Respublica, <http://www.respublica.org.al/fitorja-e-gazetarit-artan-rama-triumf-i-guximit-ndaj-frikes/>

Domosdoshmëria dhe Proporcionaliteti i Kufizimeve të Lirisë së Shprehjes

Treguesi 3 – Dispozitat penale kundër nxitjes së urrejtjes apo për mbrojtjen e rendit publik dhe sigurisë kombëtare duhet të respektojnë të drejtën për të gëzuar lirinë e shprehjes. Ndëshkimet dhe penalizimet që mund të vendosen ndaj medias duhet të respektojnë parimet e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit. Nëse vihet re një aplikim i politizuar i ligjeve duke u nisur nga shpeshësia dhe ashpërsia e penalizimeve të vendosura ndaj medias, atëherë legjislacioni mbi median dhe praktikat gjyqësore duhet të ndryshohen.

Kushtetuta shqiptare nuk e lejon kufizimin e lirisë së medias me përjashtim të lëshimit të licensave për radio dhe televizione. Sifoqoftë, Neni 17 i Kushtetutës e pranon mundësinë e kufizimit të të drejtave dhe lirive të parashikuara në kushtetutë “vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve,” duke siguruar që këto kufizime të jenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Ky nen gjithashtu thotë se “këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.” Nga kjo mund të arrihet në përfundimin se edhe e drejta për të gëzuar lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias mund të kufizohet nëse këtë e kërkon interesi publik.

Parimet e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit janë të mbrojtura në raport me ndëshkimet që parashikon Kodi Penal për veprat penale kundër rendit publik dhe sigurisë. Këtu përfshihen edhe thirrjet e bëra publikisht për të kryer vepra të dhunshme kundër rendit kushtetues, që dënohen me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet (Neni 223); përhapja e informatave apo njoftimeve të rreme, me fjalë, me shkrim apo me çdo mënyrë tjetër, me qëllim që të ngjallë një gjendje pasigurie dhe paniku te njerëzit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet (Neni 267). Kodi Penal gjithashtu ka edhe dispozita ligjore kundër gjuhës së urrejtjes dhe thirrjeve publike për të nxitur urrejtje kundër pjesëve të popullsisë. Vënia në rrezik e paqes publike duke bërë thirrje për urrejtje kundër pjesëve të popullsisë dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet. (Neni 266) Kodi Penal gjithashtu dënon edhe nxitjen e urrejtjes dhe grindjeve, për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitjen, përhapjen ose ruajtjen, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tilla, e kryer me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet. (Neni 265)

Po kështu, ligji numër 10221 Për Mbrojtjen nga Diskriminimi që siguron mbrojtjen nga lloje të ndryshme diskriminimi, duke përfshirë një nen mbi publikimin e reklamave diskriminuese (Neni 8). Ligji gjithashtu parashikon krijimin e institucionit të Komisionerit Kundër Diskriminimit, kompetencat e të cilit mbulojnë edhe shkeljet për shkak të detyrës, si dhe marrjen e vendimeve për çështje që lindin nga ankesat e publikut. Ankesat kryesore që bëhen pranë zyrës së komisionerit lidhen me diskriminimin në ambientet e punës apo në shkollë, por ankesat kundër medias janë të rralla. Një rast i tillë ishte një ankesë²⁵ që u regjistrua në vitin 2016 kundër tre faqeve në internet dhe Facebook - Anna Media Group, Jeta osh qef, dhe Lapsi.al - të cilat kishin publikuar një artikull të marrë nga një faqe tjetër në internet (story.al). Ato botuan një intervistë me një person të komunitetit LGBT, dhe nuk kishin marrë masa për të filtruar komentet e përdoruesve që ishin plot urrejtje kundër këtij personi dhe ishin shumë shqetësuese. Komisioneri vendosi se kishte të bënte me një rast diskriminimi dhe se komentet duhet të hiqeshin, duke përmendur këtu rastin Delfi kundër Estonisë, por ato media duket sikur nuk reagojnë ndaj këtij vendimi²⁶.

²⁵ Komisioneri kundër diskriminimit, Vendimi 207, 2016, <http://kmd.al/skedaret/1502717168-Vendim%20207%2030.12.2016.pdf>

²⁶ Po aty.

Rregullimi i veprimtarisë së mediave online dhe veçanërisht materialit që publikohet nga përdoruesit e këtyre faqeve ka qenë në qendër të vëmendjes dhe përpjekjeve për të hartuar legjislacionin mbi këtë pjesë të tregut mediatik. Një projektligj i propozuar nga një deputete u tërhoq më pas prej saj, pasi u gjykua se e mbigarkonte median me tepër përgjegjësi. Edhe qeveria përgatiti një projektligj për të ndryshuar disa elemente në ligjin ekzistues për tregtinë elektronike (e-commerce) pikërisht për të sqaruar çështjen e komenteve online dhe kush mban përgjegjësinë për to, por për momentin diskutimi për të është shtyrë.

Në praktikë dispozitat ligjore që u përmendën më lart nuk janë zbatuar në rastet e gazetarëve. I vetmi shembull që mund të përmendet këtu është rasti i opinionistit Kastriot Myftaraj. Në maj 2017 ai u shoqërua në polici pasi publikoi një artikull në faqen e tij në Facebook kundër ambasadores të Bashkimit Evropian në Shqipëri. Ai i drejtohej asaj me gjuhë vulgare dhe ofenduese. Për më tepër, artikulli mbyllej me fjalinë se vrasja e saj nuk duhej konsideruar si akt terrorist, por si akt anti-terrorizmi. Shoqërimi i Myftarajt nga policia u bazua në dispozitat ligjore të thirrjes publike për akte dhune (Neni 223). Disa orë më pas prokuroria urdhëroi lirim të tij, duke dalë me përfundimin se veprimet e tij nuk mund të konsideroheshin si vepra penale dhe kjo çështje nuk mund të çohet në gjykatë. Myftaraj është një personazh polemik, që shpesh akuzohet për përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe madje edhe ky veprim i fundit e ndau në dy kampe komunitetin e gazetarëve. Unioni i Gazetarëve Shqiptarë e konsideroi shoqërimin e tij në polici si të panevojshëm²⁷, duke deklaruar se fjala nuk duhen ndëshkuar me burg. Në të njëjtën kohë, gazetarë të tjerë²⁸ ishin më pak tolerantë dhe bënë thirrje për refleksion profesional që duhet të sjellë ndalimin e përdorimit të kësaj lloji gjuhe dhe të mbrojtë gazetarët e aftë dhe korrektë.

²⁷ Balkanweb, <http://www.balkanweb.com/site/unioni-i-gazetareve-reagon-per-arrestimin-e-kastriot-myftarajt-burgosja-per-fjalene-e-lire-i-perket-te-shkuares/>

²⁸ Enkel Demi, <http://27.al/zdromsi-qe-na-cenuan-lirine-e-shprehjes/>

Liria për Ushtrimin e Gazetarisë

Treguesi 4 – Shteti nuk duhet të vendosë kushte dhe kritere që duhet të përmbushen nga gazetarët përpara se të kenë mundësi të ushtrojnë këtë profesion.

Gazetaria në Shqipëri është një profesion i hapur që nuk rregullohet apo liçensohet nga shteti, si në rastet e juristëve, doktorëve, farmacistëve, etj. Si legjislacioni ashtu edhe vetë komuniteti mediatik nuk kanë bërë ndonjë lloj përcaktimi apo përkufizimi se çfarë është një gazetar apo të vendosin rregulla për anëtarësim dhe praktikim profesioni.

Puna e gazetarit rregullohet në bazë të legjislacionit të përgjithshëm të punës, kryesisht nga Kodi i Punës, që aplikohet mbi të gjitha marrëdhëniet e punës, duke përfshirë edhe profesionet e parregulluara.

Përveç Kodit të Punës, pjesa profesionale e aktivitetit të gazetarëve vetërregullohet me kode të sjelljes në punë. Një kod i tillë është hartuar dhe aprovuar nga shoqatat profesionale në fillim në vitin 1996, dhe më vonë në vitin 2006 dhe 2018, por zbatimi i tyre është lënë në dorë të vetë gazetarëve. Janë hartuar edhe kode të tjera të sjelljes profesionale që merren kryesisht me anën etike, apo në lidhje me aspekte specifike të punës si për shembull gazetarinë investigative, raportimin për fëmijët dhe minorenët, raportimin mbi viktimat e trafikut njerëzor, raportimi i kronikës së zezë, etj.

Kur flasim për komunitetin mediatik apo punonjësit e medias nuk bëhet fjalë vetëm për gazetarët, por edhe për kameramanët, fotografët, prezantuesit, etj. Megjithatë Unioni i Gazetarëve Shqiptarë dhe shoqata të tjera përqendrohen kryesisht tek puna e gazetarëve, ato i konsiderojnë edhe profesionet e tjera si pjesë të komunitetit mediatik dhe reagojnë në të njëjtën mënyrë në raste shkeljesh ose sulmesh kundër kameramanëve apo personave të tjerë, siç ka ndodhur në disa raste. Gjithashtu këto shoqata nuk bëjnë dallim midis gazetarëve në profesion të lirë (freelance), të punësuarve me kohë të plotë dhe me kohë të pjeshme, apo kontribuesve të herëpashershëm.

Nuk dihet akoma sa është numri total i gazetarëve në Shqipëri dhe nuk ka statistika zyrtare në këtë fushë. E vetmja e dhënë vjen nga Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, që llogarit se ka afër 6,200 punonjës të medias në vend, dhe rreth 2,700 prej tyre janë gazetarë²⁹.

Në Shqipëri ka dy lloj mënyrash arsimimi për gazetarë: shkollimi normal në shkolla të larta, dhe edukimi i vazhdueshëm në punë e sipër. Shkollimi ofrohet nga universitete publike me fakultete në Tiranë, Elbasan, dhe Shkodër. Katedra e parë e gazetarisë, e krijuar sipas modelit sovjetik, u hap në Fakultetin e Shkencave Politiko-Juridike dhe funksionoi për rreth 10 vjet, deri në fillim të viteve 70. Departamenti aktual i Gazetarisë në Tiranë u hap në vitin 1992 si pjesë e Fakultetit Histori-Filologji. Deri në vitin 2010, llogaritet se 1,116 studentë ishin diplomuar nga ky departament, por megjithatë është e vështirë të llogaritet se sa prej këtyre studentëve të diplomuar për gazetari kanë punuar në media³⁰.

Departamenti i Gazetarisë në universitetin publik ka kaluar nëpër ndryshime thelbësore të kurrikulës. Sistemi i shkollimit ndryshoi nga formati katër vjeçar në sistemin me dy nivele duke iu përshtatur procesit të Bolonjës. Të diplomuarit në gazetari në nivelin e parë mund të zgjedhin nga tre profile gazetarie: gazetari sociale/kulturë, gazetari politike, dhe gazetari ekonomike³¹.

²⁹ Të dhëna nga Unioni i Gazetarëve Shqiptarë.

³⁰ Instituti Shqiptar i Medias, "Arsimimi i gazetarëve në Shqipëri," 2010.

³¹ Plani Mësimor i Departamentit të Gazetarisë 2013-2016.

Në nivelin e dytë të shkollimit ofrohet mundësia për t'u specializuar më tej në profilet e dëshiruara të gazetarisë. Profilet që ofrohen këtu janë Marrëdhëniet me Publikun, Marketingu në Media, Administrimi i Medias, Gazetaria Evropiane dhe Ndërkombëtare, dhe Komunikimi Ndërkulturor.

Numri i studentëve që pranohen çdo vit përcaktohet në bazë të mundësive dhe kapaciteteve të universitetit. Kështu për vitin shkollor 2017-2018 kuota e gazetarisë për Tiranën ishte 120 studentë për nivelin e parë (bachelor), ndërsa për universitetet e Shkodrës dhe Elbasanit këto kuota ishin respektivisht 73 dhe 58 studentë³². Departamenti i Gazetarisë në Universitetin e Tiranës ofron gjithashtu edhe studime master dhe gradë doktorature në gazetari dhe komunikim. Disa universitete private tentuan ndër vite të ofronin diploma gazetarie por këto programe janë mbyllur tashmë apo janë transformuar në kurse për shkencat e komunikimit dhe marrëdhëniet me publikun, dhe nuk merren strikt me gazetari.³³ I vetmi universitet privat që ka akoma një program gazetarie është Universiteti Bedër, që ofron diploma në shkenca komunikimi dhe diploma master në komunikim apo gazetari. Përveç shkollimit formal, trajnim i vazhdueshëm profesional ofrohet edhe nga organizata dhe shoqata të ndryshme. Instituti Shqiptar i Medias është qendra kryesore që ofron të tilla mundësi trajnimi, por ka edhe shoqata të tjera vendase apo ndërkombëtare që mundësojnë trajnim për gazetarë, kryesisht në programe të shkurtra dhe kurse trajnimi.

Shteti dhe legjislacioni nuk kanë vendosur kritere për ushtrimin e profesionit të gazetarit. Ama, në mënyrë paradoksale disa nga anëtarët e komunitetit mediatic do të dëshironin që të kishte një ligj që të përcaktonte se kush mund të quhet gazetar dhe të krijohej një mënyrë për të hyrë në rradhët e profesionit. Komuniteti i medias është i ndarë në dy kampe në lidhje me këtë çështje, ku një palë beson se liria që ofrohet me sistemin aktual në profesion është situata ideale, ndërsa pala tjetër kërkon vendosjen e rregullave në profesion si një nga mënyrat për të shpëtuar gazetarinë dhe për të përmirësuar nivelin e profesionalizmit. Një diskutim i tillë u shfaq fillimisht në vitin 2001 kur po hartohej edhe një projektligj për shtypin, që parashikonte krijimin e Urdhërit të Gazetarit duke ndjekur deri diku modelin italian. Pas debatësh të ashpra projektligji nuk kaloi për votim dhe pjesa më liberale e komunitetit të medias doli fitimtare.

Sidoqoftë, duke u gjendur përballë pamundësisë për t'u vetërregulluar si dhe përkeqësimit të cilësisë të raportimit në shumicën e mediave, për një pjesë të këtij komuniteti ideja e vendosjes së rregullave për profesionin e tyre mund të diskutohet sërish. Ata arsyetojnë se një proces i tillë do të shërbente për të nxjerrë në pah profesionistët e vërtetë dhe të mbrojtë dinjitetin e personave që punojnë seriozisht dhe që i janë dedikuar gazetarisë³⁴. Që nga dështimi i përpjekjeve për të miratuar ligjin e shtypit me modelin e Urdhrit të Gazetarit, kjo çështje ka qenë thjesht subjekt i një debati të brendshëm dhe nuk është materializuar në ndonjë iniciativë ligjore.

³² Vendimi i qeverisë mbi kuotat e hyrjes në universitetet publike për vitin 2017-2018: <https://maturashitetore2016.wordpress.com/kuotat-per-universitetet-publike-2017-2018/>

³³ Peace Institute (Instituti për paqen) "Rëndësia e integritetit të medias", Shqipëria, 2014.

³⁴ Intervista të thelluara të zhvilluara për këtë studim.

Aksesi i Partive Politike në Media

Treguesi 5 – Partitë politike dhe kandidatët në zgjedhje duhet të kenë akses të barabartë në media. Gjatë fushatave elektorale organet e medias duhet të mundësojnë më tej komunikimin e partive politike me publikun e gjerë.

Mbulimi mediatik i fushatave zgjedhore është i rregulluar në mënyrë të hollësishme. Megjithëse nuk është vënë re ndonjë diskriminim i dukshëm gjatë fushatave elektorale, gjatë viteve të fundit mediat po ankohen se partitë politike kanë marrë në dorë mbulimin e fushatave të tyre elektorale, duke zëvendësuar punën e gazetarëve, që nganjëherë nuk janë lejuar as të ndjekin takime apo ngjarje publike.

Kodi Elektoral përmban një sërë rregullash për raportimin e fushatës elektorale nga mediat, për një periudhë 30 ditore përpara ditës së zgjedhjeve, duke përfshirë edhe ditën e heshtjes elektorale një ditë para zgjedhjeve. Kodi bën një dallim midis raportimit të aktiviteteve të partive politike nga radio-televizioni publik dhe mediave elektronike private, si dhe diferencimin midis kohës së transmetimit për partitë parlamentare dhe atyre që nuk janë përfaqësuar në parlament.

Radio televizioni publik duhet t'u kushtojë partive parlamentare me më shumë se 20 përqind të vendeve në Kuvend jo më pak se 30 minuta dhe po aq kohë edhe në radion publike, kurse për partitë e tjera parlamentare, kjo kohë është jo më pak se 15 minuta³⁵. Çdo parti joparlamentare, që merr pjesë në zgjedhje, përfiton 10 minuta në televizionin publik dhe 10 minuta në radion publike. Koha që duhet duhet t'i kushtohet fushatës elektorale në edicionet e lajmeve dhe normat e profesionalizmit janë të njëjta si për transmetuesit privatë ashtu edhe për radio televizionin publik. Raportimi i fushatës elektorale duhet të kryhet me objektivitet, duke siguruar transmetimin e plotë të informacionit, dhe pluralizimin në informacion. Për sa i përket edicioneve të lajmeve radio televizionet janë të detyruar të zbatojnë raporte kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvend kanë marrë më shumë se 20 përqind të vendeve, ndërsa partitë që kanë marrë më pak se 20 përqind të vendeve marrin gjysmën e asaj kohe transmetimi³⁶. Propaganda dhe komentet politike të gazetarëve nuk lejohen dhe janë në shkelje të rregullave të kodit elektoral dhe mund të ndëshkohen me gjobë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Për radio televizionin publik këto gjoba mund të shkojnë deri në 20,000 lekë për gazetarët; 30,000 lekë për redaktorët; dhe 60,000 për drejtorin e përgjithshëm. Nëse rregullat e minutazhit për partitë politike shkelen nga stacionet private këto gjoba janë më të larta: 1.5 milionë lekë për transmetuesit lokalë, dhe tre milionë lekë për stacione kombëtare³⁷. Nëse këto shkelje përsëriten, Komisioni mund të urdhërojë mbylljen e televizionit për 48 orë. Radiot dhe televizionet kanë të drejtë të zhvillojnë debate politike, por duhet të sigurojnë ekuilibrin midis partive. Kodi gjithashtu përcakton rregulla për reklamën politike gjatë fushatës. Zbatimi i këtyre rregullave monitorohet nga Bordi i Monitorimit të Medias (BMM), që përgatit raporte të përditshme dhe i propozon masat që duhen marrë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (Neni 85).

Trajtimi i partive politike dhe minutazhi i dedikuar për to rregullohet me ligj vetëm gjatë fushatave elektorale, por edicionet e lajmeve të stacioneve kryesore të radiove dhe televizioneve monitorohen rregullisht nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), që i publikon këto rezultate në faqen e saj të internetit³⁸.

³⁵ Kodi Elektoral, Neni 80.

³⁶ Po aty, Neni 81.

³⁷ Po aty, Neni 84.

³⁸ <http://ama.gov.al/preview/monitorimi-i-permbajtjeve/>

Si pasojë e këtyre rregullave të detajuara dhe strikte, si dhe gjobave që mund të vendosen në raste shkeljesh, raportimi i mediave gjatë fushatave elektorale ka qenë në përgjithësi i balancuar³⁹.

Ndonëse këto rregulla strikte duket se kanë ndikuar në raportimin e ekuilibruar nga ana e medias, zbatimi i tyre në praktikë nuk është edhe aq i lehtë, për arsye që kanë të bëjnë më shumë me partitë politike sesa me gazetarët. Redaktorët thonë se megjithëse ligji kërkon në mënyrë maniake një barazi të kohës së dedikuar ndaj partive politike, në praktikë jo të gjitha partitë ndjekin të njëjtin ritëm aktivitetesh. Sipas redaktorit të një nga televizioneve kryesore në vend, nevoja për të respektuar kërkesat ligjore për balancimin e kohës së trasmetimit “të çojnë në zgjidhje qesharake të problemeve, ku ndonjëherë transmetojmë aktivitete të shkuara të një partie politike, vetëm sa për të balancuar kohën me një parti tjetër që sapo ka organizuar një miting.”⁴⁰ Sipas një drejtuesi të një organi mediatik, “ky numërim sekondash mund të krijojë ekuilibër kohe, por nuk ka shumë kuptim, pasi liria e informacionit nuk është çështje minutazhi, por ka të bëjë më shumë me cilësinë.”⁴¹ Edhe raporti i ODIHR-it për zgjedhjet e fundit elektorale në Qershor 2017 e pranoi vështirësinë që has media në respektimin e Kodit: “Në praktikë, subjektet mediatike e patën të vështirë të siguronin një mbulim proporcional të garuesve për shkak të intensitetit të ndryshëm të aktiviteteve të fushatës nga ana e partive të vogla, gjë e cila u pranua edhe nga BMM-ja.”⁴² Autoriteti zgjedhor duket se është treguar disi më tolerant në këtë drejtim, pasi gjatë zgjedhjeve të fundit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve “votoi kundër të gjitha propozimeve për vendosjen e gjobave, ndërkohë që miratoi gjithmonë kompensimin e minutazhit të mbulimit të partive, duke u kërkuar operatorëve mediatikë që ta korrigjonin minutazhin e mangët të mbulimit brenda 48 orëve” dhe mediat në përgjithësi i zbatuan këto kërkesa.⁴³ Sondazhi i zhvilluar me gazetarë dhe redaktorë tregoi se 74 përqind e tyre mendojnë se partitë politike gëzojnë të njëjtin akses në median e tyre gjatë gjithë kohës, ose të paktën në shumicën e rasteve⁴⁴.

Ndërsa problemi i caktimit të minutazhit për partitë politike është më shumë një problem teknik, detyrimi i mediave për të pranuar materiale të gatshme të përgatitura nga partitë politike krijon një problem në fushën profesionale. Megjithëse kjo praktikë ka disa vite që përdoret, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miratooi një vendim në vitin 2013 që e bënte pothuajse të detyrueshme për operatorët e televizioneve private që të transmetojnë në edicionet e lajmeve dhe programet speciale për fushatat zgjedhore materiale filmike të përgatitura nga subjektet elektorale. Një grup stacionesh televizive ishte ankuar kundër kësaj praktike, madje edhe Avokati i Popullit doli më një rekomandim kundër kësaj praktike pune. Sidoqoftë, praktikisht të gjitha mediat iu nënshtruan kësaj praktike, të detyruara nga presioni i konkurrencës nga stacionet e tjera televizive, ashtu edhe nga presioni i partive politike. Raportet e OSBE/ODIHR kanë theksuar se kjo praktikë pune çënon pavarësinë editoriale dhe e përsëriti këtë deklaratë edhe në raportin e saj mbi zgjedhjet e fundit: “Pavarësisht nga rekomandime të mëparshme të OSBE/ODIHR-it, neni 84.1 i Kodit Zgjedhor lejon ende që filmime të regjistruara më parë që përgatiten nga partitë të transmetohen gjatë edicionit të lajmeve, gjë që çon në zbehjen e ndarjes midis përmbajtjes editoriale dhe reklamës politike. Kjo gjë bie ndesh me angazhimet e OSBE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës.”⁴⁵

³⁹ Raporti i ODIHR për zgjedhjet e 25 qershorit tha se RTSH raportoi në mënyrë të balancuar dhe se toni i pasqyrimit ishte më së shumti neutral ndaj tre partive kryesore. Ndërkohë që një mbulim i ngjashëm i balancuar u vu re te Vizion Plus (ku PD-së iu dha 34 përqind, PS-së 36 përqind dhe LSI-së 17 përqind), ABC News i dha 37 përqind të minutazhit PD-së, 28 përqind PS-së dhe 21 përqind LSI-së; toni i pasqyrimit të fushatës ishte përgjithësisht neutral ose pozitiv. Një mbulim disi më kritik i fushatës u vu re në TV Klan (për të gjitha partitë kryesore), i cili i dha 42 përqind të mbulimit PS-së, 24 përqind PD-së dhe 17 përqind LSI-së. Një pasqyrim i ngjashëm i fushatës u vu re në Top Channel, i cili u dha 42, 33 dhe 16 përqind të minutazhit të mbulimit përkatësisht PS-së, PD-së dhe LSI-së; por toni i mbulimit të PD-së ishte pjesërisht negativ.

⁴⁰ Intervista të thelluara me redaktorë dhe drejtues të mediave kryesore për këtë studim.

⁴¹ Po aty.

⁴² OSCE/ODIHR Raporti përfundimtar për zgjedhjet e 25 qershor 2017.

⁴³ Po aty.

⁴⁴ Të dhëna nga sondazhi i zhvilluar për këtë studim.

⁴⁵ OSCE/ODIHR Raporti përfundimtar për zgjedhjet e 25 qershor 2017.

Edhe redaktorët e stacioneve televizive kryesore mendojnë se ndodhen para një situatë qesharake, ku pasqyrimi i fushatës elektorale “kthehet në një proces mekanik dhe puna e gazetarit shfrytëzohet në minimum.”⁴⁶ Një redaktor tjetër tha se “fushata e fundit elektorale e asgjësoi rolin e medias, pasi fushata u pasqyrua nga partitë politike dhe materialet i përgatitën po vetë.”⁴⁷ Megjithëse në parim gazetarët mund të përgatitin kronikat e tyre pavarësisht nga materialet e partive politike, në disa raste gazetarët nuk u lejuan të filmonin takime apo mitingje elektorale. Ashtu si thotë edhe një redaktor: “Partitë kanë akses të barabartë në media gjatë fushatës. Ajo që më shqetëson më shumë mua është akses i medias tek partitë, që është nën kontroll të fortë dhe selektiv. Raportimi i fushatës drejtohet nga sektori i propagandës të çdo partie dhe është shumë e vështirë për publikun që të orientohet rreth programeve dhe ideve, e të bëjë dallimin midis partive.”⁴⁸

Një tjetër vërejtje dhe autokritikë nga profesionistët e medias në lidhje me pasqyrimin e fushatës ka të bëjë me cilësinë e raportimit, duke theksuar se në shumicën e rasteve media thjesht sa bën përçimin në publik të mesazheve politike dhe fjalimeve partiake, pa kryer asnjë verifikim ndaj bazës dhe vërtetësisë të deklaratave të lëshuara nga politikanët. Kjo lidhet edhe me kërkesat e legjislacionit për evitimin apo kufizimin e komenteve, por ka të bëjë edhe me vetë mënyrën si funksionon politika: “Raportimi i fushatave shpesh transformohet në monolog politik, dhe politikanët nganjëherë i evitojnë debatet si dhe gazetarët që mund të bëjnë pyetje me karakter kritik.”⁴⁹

Problemi i mungesës së raportimit kritik të politikës nuk kufizohet vetëm gjatë fushatës elektorale, por sipas intervistave me redaktorë kjo është një mangësi e përhershme e medias. Pavarësisht problemeve me cilësinë, mendimi i përgjithshëm i punonjësve të medias ishte se nuk ka vend për shqetësim rreth censurimit të ndonjë partie nga mediat, megjithëse disa media mund të jenë të njëanshme në raportim. Nga ana tjetër, publiku po bombardohet gjithmonë e më shumë me raportim politik, politikanë dhe debate politike, dhe kjo tejngopje e publikut është një realitet i krijuar nga media dhe politika, që çon në një ekspozim të ekzagjeruar të publikut ndaj politikanëve⁵⁰.

⁴⁶ Intervista të thelluara me redaktorë dhe drejtues të mediave kryesore për këtë studim.

⁴⁷ Po aty.

⁴⁸ Intervista të thelluara me redaktorë dhe drejtues të mediave kryesore për këtë studim.

⁴⁹ Po aty.

⁵⁰ Po aty.

Mosdiskriminimi i Gazetarëve të Huaj

Treguesi 6 – Gazetarëve të huaj nuk duhet t’u ndalohet hyrja në vend apo lëshimi i vizave të punës nga autoritetet, duke u nisur thjesht nga frika e raportimve me frymë kritike nga ana e mediave të huaja.

Normat dhe procedurat për hyrjen në territorin shqiptar dhe lëshimin e lejeve të punës për qytetarët e huaj në Shqipëri rregullohen me ligjin 108/2013 “Për të huajt.” Ligji përcakton një sërë rrethanash kur mund të ndalohet hyrja në territorin shqiptar dhe të refuzohet dhënia e lejes së punës, por nuk përmban elementë dhe rregulla të veçanta për profesione të caktuara, duke përfshirë këtu edhe gazetarët. Ligji vetëm sa përmend reporterët apo korrespondentët e huaj të akredituar në listën e profesioneve dhe personave që mund të pajisen me certifikatë regjistrimi në punë pa afat kohor.

Rregulla më të detajuara dhe specifike për akreditimin e gazetarëve të huaj në Shqipëri janë përcaktuar që në vitin 1995 me vendimin e Këshillit të Ministrave numër 231 “Për gazetarët dhe korrespondentët e huaj të akredituar në Republikën e Shqipërisë.” Ky vendim i jep kompetenca Ministrisë së Punëve të Jashtme për akreditimin e gazetarëve të huaj, dhe nga ana formale kjo situatë vazhdon edhe sot e kësaj dite, dy dekada më vonë. Ky vendim parashikon dy lloj akreditimesh: të përkohshme dhe të përhershme, në varësi të faktit nëse gazetarët qëndrojnë dhe punojnë në Shqipëri për një periudhë kohore më pak apo më shumë se tre muaj.

Sipas këtij vendimi, korrespondentët e huaj që nuk janë me seli në Shqipëri nuk mund të akreditohen. Teorikisht ky rregull e kufizon shumë veprimtarinë e gazetarëve të huaj, pasi e kushtëzon raportimin nga Shqipëria për mediat e mëdha me hapjen e një selie në Tiranë. Ndonëse kjo gjë mund të dukej me vend dhe normale në 1995, kur u miratua dhe ky vendim për akreditimin e gazetarëve, pa dyshim që tani duhet të ndryshohet dhe të reflektojë ndryshimet në ambientin mediatik dhe kontekstin aktual ku mediat e mëdha ndërkombëtare kanë mbyllur zyrat e tyre në Tiranë, apo e kanë reduktuar ndjeshëm personelin. Sidoqoftë, nuk ka ndonjë të dhënë që ky rregull të ketë shkaktuar ndonjë problem në lidhje me akreditimin e përkohshëm apo të përhershëm të korrespondentëve të huaj në vend.

Një tjetër dispozitë e këtij vendimi për akreditimin e gazetarëve dhe korrespondentëve të huaj i jep të drejtë Ministrisë së Punëve të Jashtme që të bëjnë heqjen e akreditimit apo të refuzojnë akreditimin e një gazetari të huaj në rastet kur puna e tij apo e saj “bie ndesh me ligjin për shtypin, dhe kur në mënyrë të përsëritur dizinformon dhe shpërdoron kartën e akreditimit.” Në të tilla raste gazetari i jepet një paralajmërim nga drejtoria e shtypit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, dhe më pas merret masa e heqjes së akreditimit. Gazetari ka të drejtën të ankohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, vendimi i të cilit është përfundimtar.

Pa dyshim që kjo dispozitë është e paqartë dhe tepër e vjetëruar. Është e paqartë pasi nuk jep një përcaktim të plotë (shtrues) të kriterëve për refuzimin e akreditimit të gazetarëve të huaj. Kjo mund të sjellë abuzime dhe marrjen e vendimeve arbitrare mbi akreditimin e gazetarëve të huaj. Po ashtu edhe referenca e paqartë në lidhje me respektimin e ligjit mbi shtypin është e tejkualuar, pasi ky vendim i referohej atëherë Ligjit për Shtypin në Shqipëri, i cili u miratua në vitin 1993 dhe konsiderohej si tepër i ashpër dhe kufizues. Gazetarët e kundërshtuan me forcë këtë ligj deri në shfuqizimin e tij në vitin 1997, kur u miratua edhe ligji i ri për shtypin që vazhdon edhe sot e kësaj dite, me dy nene që deklarojnë se shtypi është i lirë. E megjithatë vendimi që merret me akreditimin e gazetarëve të huaj nuk është ndryshuar që të pasqyrojë këto ndryshime. Legjislacioni mbi shtypin në Shqipëri është shumë liberal, dhe vendimi i Këshillit të Ministrave mund të ndryshohet që të pasqyrojë situatën aktuale në terren, sidomos tani kur duket se akreditimi i gazetarëve të huaj është thjesht një formalitet.

Sidoqoftë nuk ka patur probleme me akreditimin e gazetarëve të huaj nga Ministria e Punëve të Jashtme apo ndonjë institucion tjetër shtetëror. Aktualisht në Shqipëri punojnë kryesisht korrespondentët e përhershëm të mediave të huaja, kryesisht me kombësi shqiptare, ndërsa gazetarët e huaj zakonisht nuk akreditohen apo punojnë në mënyrë të përhershme në vend, por vijnë në Shqipëri vetëm për raportime dhe ngjarje të veçanta. Sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Jashtme, në 2017 ka patur vetëm një kërkesë për akreditim nga një gazetar i ORF, ndërsa deri në 2017 dy gazetarë kishin aplikuar rregullisht për akreditim, njëri nga Rusia dhe tjetri nga Kina, por në 2017 këto kërkesa nuk janë përsëritur⁵¹.

⁵¹ Përgjigja e Ministrisë së Jashtme ndaj kërkesës për informacion.

Liria për të Zgjedhur Gjuhën e Komunikimit

Treguesi 7 – Media duhet të jetë e lirë që të transmetojë në gjuhën që zgjedh vetë

Aspekti i gjuhës në legjislacionin për median trajtohet në dy plane: në nevojën që media të mbrojë dhe promovojë gjuhën shqipe dhe të shmangë diskriminimin në media në bazë të gjuhës, nga njëra anë, dhe të drejtës së minoriteteve që të shprehin veten në publik në gjuhën amtare.

Shqipëria ka ratifikuar Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të Këshillit të Evropës dhe zbatimin e saj në praktikë monitorohet në mënyrë konstante nga Këshilli i Evropës. Edhe Kushtetuta e Shqipërisë thekson se bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë (Neni 3). Gjithashtu Kushtetuta i njuh të drejtat e pakicave kombëtare në barazi të plotë para ligjit si dhe të të drejtën të mësojnë, të zhvillojnë më tej, dhe të shprehen në gjuhën amtare (Neni 20). Në parim, pakicat kombëtare janë të mbrojtura nga diskriminimi dhe gëzojnë të njëjtat të drejta si shumica shqiptare për mësimin, mbrojtjen, dhe shprehjen në gjuhën e tyre amtare.

Kuvendi miratoi në vitin 2017 Ligjin për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare⁵² për ta përafuar legjislacionin shqiptar me parimet e Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të Këshillit të Evropës. Ky ligj njuh si minoritete kombëtare pakicat greke, maqedonase, arumune, roma, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe, dhe bullgare (Neni 3). Të dhënat dhe shifrat mbi pakicat etnike kanë qenë shpesh objekt diskutimesh dhe spekulimesh dhe janë trajtuar si çështje shumë delikate. Regjistrimi i fundit i popullsisë u zhvillua në vitin 2011 dhe rezultatet e tij u kundërshtuan veçanërisht fort nga minoritetet kombëtare dhe autoritetet fetare. Sipas regjistrimit të popullsisë, 82 përqind e deklaroi veten shqiptare, por 14 përqind e popullatës preferoi të mos jepte informacion për kombësinë, ndërsa 1.58 përqind të tjerë nuk e përcaktuan se cilës kombësi i përkisnin⁵³.

Ligji për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare e njuh të drejtën e minoriteteve për të përdorur shtypin dhe mediat elektronike në gjuhën e tyre amtare, duke zbatuar rregullat e përcaktuara nga legjislacioni mbi median, pa u diskriminuar në bazë të gjuhës së tyre, trashëgimisë etnike dhe kulturore. Gjithashtu, radio dhe televizioni publik duhet të transmetojnë në një nga kanalet e tyre lajme dhe programe kulturore në gjuhën e minoriteteve (Neni 20). Legjislacioni mbi minoritetet u rifreskua së fundmi në vjeshtën e vitit 2017, ndërsa legjislacioni për median nuk i ka pasqyruar akoma të gjitha parametrat që kërkohen nga ligji mbi pakicat kombëtare. Ndërkohë që media e shkruar nuk është subjekt i kontrollit ligjor për sa i përket përmbajtjes, mediat audiovizive e kanë marrë në konsideratë nevojën për të garantuar aksesin e nevojshëm dhe raportimin e pakicave kombëtare në media. Ligji e lejon lëshimin e licensave speciale për stacionet e radios të komuniteteve që mund të përdoren nga minoritetet etnike dhe grupe të tjera, “duke pasqyruar nevojat kulturore, gjuhësore, demografike dhe fetare të një komuniteti” (Neni 57.) Legjislacioni mbi licensimin e mediave të komuniteteve që është hartuar nga enti rregulator, e rendit nevojën për të promovuar kulturën e pakicave kombëtare⁵⁴ si një nga kriteret që duhet të përmbushë media e komunitetit dhe përmbajtja e saj. Gjithashtu, një nga kriteret që duhen marrë në konsideratë nga enti rregulator i mediave audiovizive kur vlerëson aplikimet për licensë duhet të jetë edhe “gatishmëria për të ofruar një shumëllojshmëri shërbimesh në hapësirën e mbulimit për kategoritë e ndryshme shoqërore, përfshirë këtu interesat e pakicave” (Neni 61). Po kështu edhe deklarata e qëllimit

⁵² Ligji 96/2017.

⁵³ Rezultatet e regjistrimit të popullsisë 2011.

⁵⁴ <http://ama.gov.al/preview/wp-content/uploads/2015/03/RREGULLORE-PER-KRITERET-DHE-PROCEDURAT-P-%C3%8BR-DH-%C3%8BNIEN-E-LICENC-%C3%8BS-KOMB-%C3%8BTARE-T-%C3%8B-TRANSMETIMIT-AUDIOVIZIV-DHE-LICENC-%C3%8BS-KOMB-%C3%8BTARE-T-%C3%8B-SH-%C3%8BRBIMIT-T-%C3%8B-PROGRAMIT-AUDIOVIZIV.pdf>

e radio televizionit publik e vë theksin tek fakti që ky institucion duhet t'i shërbejë të gjitha grupeve të shoqërisë, duke përfshirë këtu edhe pakicat kombëtare (Neni 91). Kjo pikë përforcohet edhe nga Statuti i radio televizionit publik, që thotë se të gjitha programet e Radio Televizionit Shqiptar duhet të respektojnë të drejtat kushtetuese të të gjithë qytetarëve shqiptarë, duke përfshirë edhe minoritetet kombëtare (Neni 37).

Në këtë kontekst, media për minoritetet preket pak në ligjin e mediave audiovizive, por në realitet nuk është hartuar apo zbatuar ndonjë politikë shtetërore në lidhje me minoritetet gjatë këtyre viteve të fundit. Sipas ligjit në fuqi për pakicat kombëtare buxheti i shtetit duhet të dedikojë çdo vit një fond special për minoritetet, që duhet të administrohet nga Komiteti i Pakicave Kombëtare. Për momentin është tepër herët për të gjykuar se çfarë ndikimi do të ketë ky fond në krijimin e mediave për minoritetet kombëtare.

Deri tani janë lëshuar katër liçensa për radio komuniteti, por të gjitha ato i përkasin komuniteteve të ndryshme fetare dhe nuk ka patur asnjë aplikim për media elektronike në gjuhë të huaj⁵⁵.

Radio televizioni publik RTSH po transmeton në kanalin e dytë programe në pesë gjuhë të huaja për pakicat kombëtare në vend: minoritetin grek, malazez, maqedonas, rom, dhe vllah⁵⁶. Programet zgjasin 30 minuta në ditë për çdo gjuhë. Megjithatë, disa përfaqësues të minoriteteve shprehën rezerva në lidhje me cilësinë e programeve, duke thënë se ato nuk janë profesionale, ose përmbajnë vetëm pesë minuta lajme dhe pastaj vazhdojnë me muzikë⁵⁷. Edhe transmetuesi publik pranoi që ka shumë punë për të bërë për të përmirësuar këto programe, pasi ato sa kanë filluar dhe mungojnë redaksitë, pasi këto programe nuk ishin parashikuar në buxhet⁵⁸. Ndërkohë edhe tre studiot rajonale të radio televizionit publik prodhojnë programe në gjuhën e minoriteteve më të shumta në numër në atë zonë: maqedonisht dhe romisht për Radio dhe TV Korçën⁵⁹, në gjuhën malaze/serbe për Radio Shkodrën, greqisht dhe arumunçe për RTV Gjirokastrën⁶⁰. Televizioni privat Alpo në Gjirokastrë duket se është i vetmi televizion privat që transmeton një program javor prej një ore në gjuhën greke.⁶¹ Iniciativat private nga minoritetet për të krijuar mediat e tyre kanë qenë projekte të brishta dhe jo stabël që vareshin plotësisht nga donacione dhe sponsorizime, duke patur parasysh edhe tregun e kufizuar dhe mundësitë e pakta për to. Mediat e minoriteteve nuk janë regjistruar nga shteti apo autoritetet përkatëse pasi nuk janë media elektronike që kërkojnë liçensë. Disa raporte monitorimi tregojnë për natyrën e paqëndrueshme të organeve të mediave të minoriteteve përgjatë viteve: në vitin 2005 u raportua se kishte 11 media të pakicave kombëtare, ndërsa në vitin 2009 numri i tyre kishte zbritur në gjashtë⁶². Nga ana tjetër, sipas të dhënave të Unionit të Gazetarëve, këto vitet e fundit ka patur një rritje të numrit të mediave të minoriteteve dhe kjo shifër ka arritur në 17. Këto media private janë shtuar ndjeshëm në numër duke përfutur nga kostot relativisht të ulëta të prodhimit që ofrojnë mediat online⁶³.

⁵⁵ Intervistë me Gentian Salën, kryetar i bordit të AMA-s.

⁵⁶ Intervistë me Thoma Gëllçin, drejtor i përgjithshëm i RTSH-së.

⁵⁷ Intervista me përfaqësuesit e pakicave rome, maqedonase dhe vllahe.

⁵⁸ Intervistë me Thoma Gëllçin, drejtor i përgjithshëm i RTSH-së.

⁵⁹ Intervistë me kryeredaktorin e RTV Korça.

⁶⁰ Intervistë me kryeredaktorin e RTV Gjirokastra.

⁶¹ Intervistë me përfaqësuesin e minoritetit grek në Gjirokastrë.

⁶² Instituti Shqiptar i Medias, Mediat e minoriteteve në Shqipëri, 2005, 2009.

⁶³ Të dhëna nga Unioni Shqiptar i Gazetarëve.

Mbrojtja e Anonimatit për Burimet Konfidenciale të Informacionit

Treguesi 8 – Konfidencialiteti i burimeve të informacionit për gazetarët duhet të mbrohet.

Legjislacioni shqiptar siguron mbrojtjen e anonimatit dhe e njeh nevojën për ruajtjen e konfidencialitetit të burimeve të informacionit të gazetarëve, por në praktikë ka edhe pengesa në respektimin e kësaj të drejte.

Parimi i të drejtës për të ruajtur fshehtësinë e burimit mbrohet me një dispozitë të Kodit të Procedurës Penale, neni 159, që merret posaçërisht me ruajtjen e sekretit profesional. Ky nen rendit një sërë profesioneve që nuk mund të detyrohen të dëshmojnë për sa dinë për shkak të profesionit, duke përfshirë këtu edhe gazetarët. Sipas këtij neni edhe gazetarët nuk mund të detyrohen të tregojnë emrat e personave nga të cilët ata kanë marrë të dhëna gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Megjithatë ligji parashikon edhe disa përjashtime nga ky rregull: kur të dhënat janë të domosdoshme për të provuar veprën penale dhe vërtetësia e këtyre të dhënave mund të dalë vetëm nëpërmjet identifikimit të burimit, gjykata urdhëron gazetarin që të tregojë burimin e informacionit të tij. Gjithashtu, një nga parimet themelore në punën e përditshme të mediave audiovizive është edhe ruajtja e sekretit të burimeve të informacionit, sipas nenit 4 të Ligjit për Mediat Audiovizive.

Megjithëse në pamje të parë këto dy ligje duket sikur garantojnë një mbrojtje të mjaftueshme për burimet e informacionit të gazetarëve, mbrojtja që ofrohet nga Kodi i Procedurës Penale varet nga vullneti dhe llogjika e gjykatës, ndërkohë që ligji e kufizon mbrojtjen e anonimatit vetëm për rastet kur duhet provuar vepra penale dhe vërtetësia e të dhënave në gjyq, dhe nuk e kushtëzon këtë mbrojtje me një listë më shteruese në mbrojtje të interesit publik.

Rastet e proceseve gjyqësore kundër gazetarëve që refuzojnë të tregojnë burimin e informacionit kanë qenë tejet të rralla. Sondazhi i zhvilluar me redaktorë dhe gazetarë në kuadër të këtij studimi tregoi se 14.8 përqind e të anketuarve kanë patur probleme me ruajtjen e konfidencialitetit të burimeve të informacionit, por jo me gjykatat⁶⁴. Gazetarët thanë se nganjëherë redaktorët dhe drejtorët e tyre kanë dashur të dinë identitetin e burimeve të ndonjë informacioni të caktuar, por jo me ndonjë insistim të madh nga ana e tyre. Rasti më i njohur në këtë drejtim ka të bëjë me gazetarin investigativ Artan Hoxha. Ai ishte ftuar në një emision televiziv dhe pas një informacioni që bëri publik, përfaqësues të organit të prokurorisë shkuan në zyrat e televizionit për të marrë vesh burimin nga e kishte marrë informacionin. Për këtë arsye ata vendosën të konfiskonin dy aparatet e celularit që përdorte gazetari, që edhe tani dy vite më pas nuk i janë kthyer. Në përgjithësi, intervistat me redaktorët konfirmuan faktin se ushtrohet shumë pak presion nga shefat e redaksive apo drejtorët, dhe nganjëherë nga zëdhënës institucionesh, por në përgjithësi anonimatit i burimeve konfidenciale ruhet⁶⁵. Nga ana tjetër një redaktor tha se nganjëherë ata kanë vendosur të mos publikojnë ndonjë informacion të marrë nga burime konfidenciale vetëm nga frika se mos detyrohen të nxjerrin emrin e burimit dhe humbasin besueshmërinë e tyre, duke u kthyer kështu në një pengesë në përcjelljen e informacionit ndaj publikut⁶⁶.

⁶⁴ Të dhëna nga sondazhi i zhvilluar për këtë studim.

⁶⁵ Intervista të thelluara me redaktorë dhe pronarë mediash.

⁶⁶ Po aty.

Kufizimi i të Drejtave Ekskluzive të Raportimit

Treguesi 9 – Të drejtat ekskluzive të raportimit të ngjarjeve me interes të madh publik nuk duhet të çenojnë lirinë e informimit të publikut.

Në procesin e gjatë të miratimit të Ligjit për Mediat Audiovizive në parlament një nga parimet bazë ishte nevoja për të përafuar legjislacionin shqiptar me bazën ligjore të Bashkimit Evropian, si dhe nevoja për të hartuar një ligj të përshatshëm për kontekstin shqiptar. Për këtë arsye, ky ligj ka marrë parasysh kushtet dhe standardet e vendosura nga Konventa Evropiane për Televizionin Ndërkufitar që është ratikuar nga Shqipëria, si dhe Direktivën e Bashkimit Evropian për Shërbimet e Mediave Audiovizive. Ky ligj rregullon edhe transmetimin e ngjarjeve të rëndësishme me qëllim që të sigurojë akses sa më të gjerë dhe të padiskriminuar për publikun, edhe në rastet kur një operator mediatik zotëron të drejtat ekskluzive të transmetimit të një ngjarje të caktuar (Kreu XIII i Ligjit për Mediat Audiovizive). Ligji i jep të drejtë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) të luajë rolin e arbitrit në përpilimin e listës të ngjarjeve me rëndësi të madhe për popullatën dhe të vendosë rregulla për mënyrën e transmetimit të tyre. Në marrjen e këtij vendimi AMA këshillohet me Ministrin e Kulturës dhe me Këshillin e Ankesave. Lista e përpiluar i paraqitet për mendim Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik të Kuvendit.

Për përcaktimin e listës, AMA duhet të mbajë parasysh të gjitha rrethanat dhe vlerat e veçanta e të rëndësishme që ngjarja ka për kulturën e të gjithë popullsisë (neni 127). Megjithëse nuk përcaktohet qartësisht, lista duket sikur është krijuar kryesisht për të rregulluar transmetimin e ngjarjeve sportive, pasi përmend pjesëmarrjen e një skuadre kombëtare apo të një individi shqiptar si kriter që duhet vlerësuar nga autoriteti rregulator.

Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk e ka hartuar akoma një listë të tillë, por kjo listë është parashikuar në Planin Strategjik të Punës për periudhën 2017-2019 nga enti rregulator⁶⁷. Lista pritet të plotësohet në verën e vitit 2018 pas konsultimeve me disa ministri, veçanërisht me Ministrinë e Kulturës si dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve⁶⁸. Me pas lista pritet të rifreskohet vit pas viti nga AMA.

Mbetet për t'u parë se çfarë ngjarjesh me rëndësi të madhe do të përfshihen në këtë listë, megjithëse duket se dispozita ligjore i referohet kryesisht ndeshjeve sportive. Në fakt, debati kryesor dhe interesi më i madh gjatë këtyre viteve të fundit është përqëndruar mbi çështjen se cili televizion apo cila platformë digjitale do të transmetojë ngjarje të veçanta sportive, kryesisht në futboll, dhe veçanërisht në lidhje me transmetimin e ndeshjeve të kombëtares shqiptare, si dhe nëse mund të shikohen pa pagesë. Meqë të drejtat e transmetimit të këtyre ngjarjeve sportive i jepen atij që paguan më shumë, ka ndodhur shpesh që radio televizioni publik nuk ka qenë në gjendje që ta përballojë atë shpenzim. Në fakt, radio televizioni publik ka pretenduar disa herë se nuk është lajmëruar fare nga federata e futbollit për zhvillimin e ankandit për të drejtat e transmetimit⁶⁹. Kjo ka sjellë edhe acarimin e publikut, i cili pret që ndeshjet e kombëtares të futbollit të transmetohen pa pagesë. Ndonëse ndeshjet e kombëtarës janë transmetuar pa pagesë edhe nga televizionet e platformat digjitale private, opinioni i përgjithshëm i publikut është që RTSH-ja duhet të transmetojë këto ndeshje edhe si një nga mënyrat për të justifikuar pagesën e taksës së televizionit.

Me kalimin në teknologjinë digjitale, me shtimin e numrit të kanaleve të transmetimit nga radio televizioni publik dhe përmirësimin e cilësisë së sinjalit, RTSH-ja është bërë më aktive në marrjen e të drejtave të transmetimit, duke kërkuar gjithashtu edhe garanci më të mëdha se do të respektohet e drejta e transmetimit. Në lidhje me këtë çështje enti rregulator deklaroi në shkurt 2018 se RTSH-ja zotëronte të drejtat ekskluzive të Lojrave Olimpikë Dimërore si dhe Kupës së Botës në futboll Rusi 2018⁷⁰.

⁶⁷ AMA, Plani Strategjik i Punës 2017-2019.

⁶⁸ Intervistë me Gentian Salën, drejtor i AMA.

⁶⁹ Intervistë me Thoma Gëllçin, Drejtor i Përgjithshëm i RTSH-së.

⁷⁰ AMA, <http://ama.gov.al/preview/njoftim-e-drejta-e-transmetimit-audioviziv-te-dy-eventeve-sportive-nderkombetare-per-vitin-2018/>

Proporcionaliteti i Mbrojtjes së Jetës Private dhe Sekretit Shtetëror

Treguesi 10 – Ligjet për mbrojtjen e jetës private dhe sekretit shtetëror nuk duhet të kufizojnë padrejtësisht lirinë e informacionit.

Mbrojtja ligjore për privatësinë zakonisht vihet në peshore përkundërt mbrojtjes së të drejtës të shprehjes dhe informacionit. Sidoqoftë vihet re një prirje për të përdorur ligjet e sekretit shtetëror, rregullore të ndryshme, dhe rekomandime për mbrojtjen e jetës private me qëllim për të fshehur informacionin nga sytë e publikut.

Mbrojtja e jetës private

Kodi Penal mbron të drejtën e jetës private dhe rendit një sërë rastesh kur shkelja e kësaj të drejte përbën kundërvajtje penale, si inçizimi dhe filmimi i aspekteve të jetës private të personave pa pëlqimin e tyre (Neni 121), përhapja e një sekretit personal pa autorizim paraprak për shkak të detyrës ose për qëllime përfitimi (Neni 122), ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës (Neni 123). Edhe Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale bën përcaktimin e rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale, si detyrimi për të njoftuar dhe për të marrë aprovimin e një individi për përpunimin e të dhënave personale, e drejta e një qytetari për të patur akses në të dhënat e veta personale (Neni 12), si dhe e drejta për të kundërshtuar përpunimin e këtyre të dhënave. Në rast shkelje në përpunimin e të dhënave personale çdo person ka të drejtë të ankohe në rrugë administrative si dhe të hedhë në gjyq duke kërkuar kompensim për dëmin e shkaktuar (Neni 16, 17).

Ligji merret edhe me rolin e medias në këtë drejtim, dhe thotë se përjashtime në përpunimin e të dhënave lejohen deri në atë nivel sa këto përjashtime krijojnë një balancë midis mbrojtjes së të dhënave personale dhe aksesit në informacion. Gjithshatu ligji e ngarkon Komisionerin me detyrën për hartimin e udhëzimeve për përdorimin e të dhënave personale nga ana e gazetarëve, si dhe për qëllime letrare e artistike. Institucioni që atëherë quhej Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave krijoi një listë me udhëzime për këtë qëllim në vitin 2010, që u ndryshua më pas në vitin 2012. Këto udhëzime mundohen të ruajnë një ekulibër midis aksesit në informacion dhe të drejtës për jetë private, duke prekur disa aspekte të punës së gazetarëve, si mbrojtja e minoreneve, mbrojtja e personave në procese penale, inçizimi i personave pa dijeninë e tyre, mbrojtja e të dhënave mjekësore dhe të dhënave të tjera të ngjashme, publikimi i fotografive, dhe e drejta e personave publikë për jetë private përkundër interesit publik. Udhëzimet gjithashtu bëjnë të ditur se shkelja e këtyre rregullave dënohet me gjobë, dhe deri më sot ka patur vetëm një vendim kundër *Gazetës Shqiptare* në vitin 2011, që u gjobit pasi nuk ruajti anonimatën gjatë publikimit të të dhënave personale⁷¹.

Përveç ligjit për mbrojtjen e të dhënave, edhe ligji i mediave audiovizive e përmend rëndësinë e respektimit dhe garantimit të së drejtës të ruajtjes së jetës private si një nga parimet bazë në punën e operatorëve të medias (Neni 4). Një nga rregullat e përcaktuara me ligjin e mediave audiovizive është edhe detyrimi që në programet e transmetuara të mos cenohet e drejta e fshehtësisë së jetës private të personit, si dhe të shmanget përdorimi i mjeteve dhe metodave që e shkelin këtë të drejtë gjatë prodhimit të programit (Neni 34 dhe 46).

E drejta e jetës private është trajtuar më tej edhe nga Autoriteti i Mediave Audiovizive me hartimin dhe ndryshimet e Kodit të Transmetimit, që ka një kapitull të tërë që merret me çështjen e privatësisë. Sipas këtij kodi publikimi i informacioneve apo imazheve të jetës private mund të justifikohet vetëm kur mbrojtja e interesit publik e tejkalon të drejtën për jetë private. Kodi e pranon të drejtën e zyrtarëve publikë për privatësi, por e lejon publikimin e të dhënave mbi jetën e tyre private kur informacionet hedhin dritë mbi çështje që mund të ndikojnë në kryerjen e funksioneve të tyre. Kodi i jep prioritet të drejtës për jetë private veçanërisht për grupet në nevojë apo raste aksidentesh apo fatkeqësish.

⁷¹ Vendimi nr.2 i Komisionit të Mbrojtjes së të Dhënave, 2011.

Kodi i Etikës në media gjithashtu nënvizon edhe detyrimin e gazetarëve për respektimin e jetës private. Disa pjesë të këtij Kodi fokusohen mbi shkeljen e jetës private, duke përfshirë detyrimin për të respektuar dinjitetin e personit, gjetjen e ekuilibrit midis të drejtës së privatësisë të zyrtarëve publikë dhe interesit të shoqërisë, rregullat për raportimin në raste aksidentesh dhe fatkeqësish në mënyrë etike, si dhe trajtimi me kujdes më të madh i grupeve në nevojë, si fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuar.

Megjithëse në letër të gjitha këto ligje dhe rregullore të brendshme duhet ta rregullonin marrëdhënien e medias me privatësinë, opinioni i përgjithshëm i redaktorëve të intervistuar për këtë studim tregoi një nivel të lartë autokritike në lidhje me respektimin e normave etike në gazetari. Rritja e rrafshme e numrit të portaleve të lajmeve, që nuk rregullohen me ligj dhe shumë rrallë krijojnë edhe instrumente vetë-rregullimi, e ka përkeqësuar akoma më tepër situatën në lidhje me shkeljen e rregullave të etikës dhe jetës private në media sipas redaktorëve të mediave tradicionale në vend. “Gazetaria e portaleve ka shkatërruar çdo strukturë raportimi, identiteti, dhe rregulli në gazetari,”⁷² tha botuesi i një gazete të përditshme. Sipas gati të gjithë redaktorëve të marrë në intervistë etika në media po kalon nëpër një prej periudhave më të errëta të saj⁷³.

Mbrojtja e Sekretit Shtetëror

Mbrojtja e sekretit shtetëror rregullohet me Ligjin për Informacionin e Klasifikuar “Sekret Shtetëror,” që u miratua në vitin 1999, i ndryshuar në vitet 2006 dhe 2012. Ky ligj përcakton si sekret shtetëror çdo informacion të klasifikuar, ekspozimi i paautorizuar i të cilit mund të rrezikojë sigurimin kombëtar.⁷⁴ Informacioni i nënshtrohet procesit të klasifikimit kur lidhet me plane ushtarake, armatime ose operacione, informacione mbi sigurinë kombëtare, veprimtari të shërbimeve informative, marrëdhënie me qeveritë e huaja, etj. Ligji i miratuar në vitin 1999 përcaktoi tre nivele klasifikimi të informacionit: i kufizuar, konfidencial, dhe sekret, në varësi të dëmit që mund të sillte publikimi i këtyre informacioneve ndaj sigurisë kombëtare.

Në vitin 2006 ligji u ndryshua dhe u shtua edhe një nivel tjetër sigurie: informacion tepër sekret, publikimi i paautorizuar i të cilit mund të rrezikonte seriozisht sigurinë kombëtare. Në atë kohë ndryshimi u justifikua me kërkesën për shtimin e nivelit të sigurisë në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO. Megjithatë, shtimi i një tjetër niveli sigurie ngjalli shqetësime në lidhje me mundësinë se institucionet shtetërore do ta përdornin këtë ligj për të kufizuar akoma më tej lëshimin e informacionit.

Problemet që has media në këtë fushë ilustrohen edhe nga përballja e rrjetit investigativ BIRN me autoritetet gjatë punës për një artikull mbi metodat e përdorura nga institucionet e spiunazhit të kohës së komunizmit. Gazetarët kërkuan disa dokumente nga SHISH që kreu i shërbimit informativ i konsideroi si informacione të klasifikuara. Komisioneri vendosi që shërbimi informativ duhet t’i lëshonte dokumentet e kërkuara nga gazetarët, por pasi shërbimi informativ refuzoi të bindej, kjo çështje kaloi në gjykatë administrative, që e mbështeti vendimin e Komisionerit. Darian Pavli, një jurist i njohur për punën e tij në fushën e lirisë së shprehjes, tha se “siguria kombëtare nuk mund të përdoret si një mbulesë për të mbajtur larg syve të publikut çdo lloj dokumenti të prodhuar nga institucionet e sigurisë kombëtare. Ka ardhur koha që këto të fundit t’i hapin rrugën studimeve historike mbi të kaluarën dhe përgjegjshmërisë mbi të tashmen.”⁷⁵ Sidoqoftë, një kalvar i gjatë nëpër gjykata mund të dekurajojë median dhe qytetarët nga insistimi për të marrë informacionin e kërkuar. Redaktorët e intervistuar në kuadrin e këtij studimi gjithashtu përmendën raste kur gazetarëve iu ishte mohuar informacioni nga autoritetet, me pretendimin se informacioni mbrohej nga sekretit shtetëror, edhe pse kjo nuk ishte një praktikë dominuese dhe kryesisht varej nga natyra e informacionit të kërkuar.⁷⁶

⁷² Intervista të thelluara me redaktorë.

⁷³ Intervista të thelluara me redaktorë.

⁷⁴ Ligji 8457 për Informacionin e Klasifikuar Sekret Shtetëror, 11.02.1999.

⁷⁵ D. Pavli, i cituar nga BIRN, “Gjykata urdhëron SHISH të deklasifikojë dokumente të arkivës së ish-Sigurimit,” <https://www.reporter.al/gjykata-urdheron-shish-te-deklasifikoje-dokumente-te-arkives-se-ish-sigurimit/>

⁷⁶ Intervista të thelluara me redaktorët dhe pronarët e mediave.

Mbrojtja e të Drejtave të Punës dhe të Drejtave Sociale të Gazetarëve

Treguesi II – Gazetarët duhet të kenë kontrata të rregullta pune që ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme shoqërore, në mënyrë që të mos kompromentohet pavarësia dhe paanshmëria e tyre.

Nuk ka të dhëna zyrtare mbi pozitën ekonomike dhe sociale të gazetarëve. Në bazë të të dhënave të pjesshme dhe informacioneve të mbledhura nga vetë punonjësit e medias është e qartë se gazetarët gjenden në pozitë të vështirë në industrinë e medias. Shpesh u mungon edhe minimumi i mbrojtjes sociale për të luajtur me sukses rolin e tyre në shoqëri. Profesionin e gazetarit konsiderohet shumë stresues, kërkon një volum të lartë pune, me shumë kompromise dhe pak para. Siqoqoftë, edhe ky perceptim nuk mund të përgjithësohet për mbarë tregun mediatik, pasi varet edhe nga organi i medias ku punon, gjendja e saj ekonomike, si dhe vendndodhja gjeografike. Për më tepër, gazetarët më të mirë dhe personalitete të gazetarisë duket se paguhen mjaft mirë, megjithëse edhe ata nuk është se kanë imunitet të plotë nga kompromiset në fushën profesionale.

Gjatë sondazhit të zhvilluar me gazetarë dhe redaktorë, punonjësve të medias iu kërkua që të rendisnin tre problemet kryesore për profesionin e gazetarisë, dhe 61.7 për qind e tyre e vuri theksin mbi kushtet e vështira të punës dhe pasigurinë ekonomike⁷⁷. Nga ana tjetër, 28.7 për qind e tyre tregojnë për korrupsion financiar direkt apo indirekt në media dhe midis gazetarëve; ndërsa 21.7 për qind e tyre mendojnë se një nga problemet kryesore në media është autocensura. Shoqatat e gazetarëve, organizatat që merren me lirinë e medias, dhe veçanërisht sindikata, kanë paralajmëruar vazhdimisht se situata social-ekonomike e gazetarëve në vend ka ardhur duke u përkeqësuar, dhe kjo tregon për deficiet të mëdha në lirinë e medias.

Të drejtat e punës të profesionistëve të medias nuk rregullohen me ndonjë ligj të veçantë përveç Kodit të Punës, që mbron marrëdhëniet e punës për të gjithë qytetarët shqiptarë. Mungesa e një mbrojtjeje të veçantë ligjore për profesionin e tyre nuk i imunizon gazetarët nga problemet sociale me të cilat përballet e gjithë forca punëtore në vend. Sipas statistikave zyrtare, në fund të vitit 2017 niveli i papunësisë për grupmoshën 15-64 vjeç ishte 13.6 për qind⁷⁸. Rroga minimale zyrtare ishte 24,000 lekë, ndërsa rroga mesatare në sektorin shtetëror në fund të vitit 2017 ishte 61,600 lekë⁷⁹. Informaliteti në ekonomi ka qenë një prirje konstante përgjatë periudhës së tranzicionit, gjë që ndikon në mënyrë të pashmangshme në marrëdhëniet e punës, megjithëse ka patur përpjekje për të krijuar të paktën një mbrojtje minimale për punonjësit dhe për të zyrtarizuar marrëdhëniet e punës. Mospagesa e kontributeve shoqërore, vonesat në dhënien e rrogave, orare të tejzgjatura pune, mospagesa e orëve shtesë apo refuzimi i pushimeve të paguara janë disa nga problemet kryesore në marrëdhëniet e punës.

Në këtë kontekst, problemet që ndikojnë negativisht në pozitën social-ekonomike të gazetarëve nuk mund të ndahen nga problemet që vuan pjesa tjetër e popullsisë dhe ato janë konsoliduar në një prirje të qëndrueshme të vënë re dekadën e fundit: marrëdhëniet informale në punë, pasiguria e vendit të punës, rrogat e ulëta, sigurime shoqërore që paguhen vetëm për rroga minimale apo nuk paguhen fare, vonesat e zakonshme në dhënien e rrogave, etj. Sipas informacioneve të dhëna nga Unioni, shumica e gazetarëve punojnë pa kontrata apo kanë kontrata që mund të ndërpriten në mënyrë arbitrare⁸⁰. Një sondazh i zhvilluar nga Unioni në vitin 2012 tregoi se vetëm 42 për qind e gazetarëve punonin me kontratë të rregullt gjatë gjithë periudhës së punësimit, 26 për qind e tyre kishin kontratë vetëm për një periudhë të shkurtër kohe, ndërsa 32 për qind e gazetarëve nuk kishin punuar ndonjëherë me kontratë.⁸¹

⁷⁷ Të dhëna nga sondazhi i zhvilluar për këtë studim.

⁷⁸ INSTAT, të dhëna mbi nivelin e papunësisë, <http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/pun%C3%ABsimi-dhe-papun%C3%ABsia/#tab2>

⁷⁹ INSTAT, të dhëna mbi rrogat mesatare, <http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/pagat/#tab2>

⁸⁰ Instituti i Paqes (Peace Institute), Rëndësia e integritetit të medias (Media Integrity Matters), Shqipëria, 2014.

⁸¹ Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, Praktikant informale të punës në mediat shqiptare, 2012, faqe 38.

Edhe në rastet kur ka kontrata pune ato ishin thjesht dokumente formale, që kompania të mos kishte probleme me autoritetet shtetërore, dhe nuk vinin si rezultat i negociatave dhe marrëveshjeve midis gazetarëve dhe kompanisë mediatike. Kontratat përpilohen në mënyrë të njëanëshme nga drejtuesit e medias⁸² dhe intervistat me gazetarë konfirmojnë faktin se ka probleme serioze me hartimin dhe zbatimin e kontratave. “Gjatë 20 viteve punë në media nuk kam patur kurrë kontratë në duar,”⁸³ tha redaktori i një gazete të përditshme. Shumica e gazetarëve dhe redaktorëve e pranojnë faktin se kontratat janë fiktive, dhe tregojnë se nganjëherë gazetarëve u jepen kontrata të pafirmosura nga ana e kompanisë mediatike që mund të ndërpriten në çdo moment. “Kontratat janë një formalitet, sa për të qenë në rregull në letra që kërkon shteti, por nuk të garantojnë sigurinë e vendit të punës dhe ky status quo vazhdon e pandryshuar në vite.”⁸⁴

Një problem i madh me marrëdhëniet e punës, që ka ardhur duke u përkeqësuar gjatë viteve të fundit, është edhe vonesa në dhënien e rrogave për gazetarët, kryesisht si pasojë e situatës të vështirë ekonomike të organeve të medias. Sipas statistikave të Unionit ka patur vonesa në dhënien e rrogave në më shumë se 85 për qind të organeve të medias, dhe këto vonesa zgjasin nga një deri në katër muaj⁸⁵. Për më tepër duket se situata po përkeqësohet. Për shembull, në shtator 2013, Unioni deklaroi se “gjatë këtyre gjashtë muajve të fundit 75 për qind e organeve të medias në vend i vonuan rrogat e gazetarëve për një periudhë nga dy deri në gjashtë muaj.”⁸⁶ Kanë kaluar rreth pesë vite dhe duket se përqindja e mediave që i shkelin afatet e dhënies së rrogave është rritur, madje edhe mediat e rëndësishme janë bërë pre e këtij fenomeni⁸⁷.

Nuk ka statistika zyrtare edhe për sa i përket nivelit të rrogave në media. Sidoqoftë, unioni thotë se ka tre nivele rrogash për gazetarët në varësi të pozicionit të tyre, nga media ku punojnë, dhe vendndodhjes së saj. Gazetarët me rrogat më të larta paguhen mesatarisht nga 550-600 USD, niveli i dytë paguhet nga 450-500 USD, ndërsa mediat e nivelit më të ulët i paguajnë gazetarët e tyre me një rrogë mesatare prej 300 USD në muaj.⁸⁸ Në të njëjtën kohë, ka një diferencë shumë të madhe midis mediave të Tiranës dhe mediave në rrethe. Rroga mesatare e gazetarëve të mediave lokale shkon nga 150-220 USD, dhe zakonisht punojnë në më shumë se një media, në mënyrë totalisht informale.⁸⁹ Unioni thotë se gazetarët në rrethe përbëjnë 45 për qind të numrit total të gazetarëve, gjë që tregon se ka një nevojë urgjente për të ndërhyrë në këtë fushë⁹⁰.

Në sondazhin e zhvilluar me redaktorë dhe gazetarë, 47 për qind e tyre mendonte se rrogat ishin shumë të ulëta në krahasim me volumin e punës që kryenin, ndërsa 26 për qind e tyre mendonin se rrogat ishin të pamjaftueshme. Vetëm 17 për qind e të anketuarve thanë se rrogat ishin të arsyeshme në raport me ngarkesën e punës.

Intervistat me gazetarë dhe përvoja e Unionit deri më sot tregojnë edhe për një tjetër problem shqetësuese: vitet e punës të humbura nga mospagimi i sigurimeve shoqërore për vite me rradhë. Në një sondazh të zhvilluar në vitin 2012 nga Unioni, 65 për qind e gazetarëve raportuan se vitet e punës me kontratë nuk përkonin me vitet e punës që kishin kaluar realisht në media.⁹¹ Punonjësit e medias gjithashtu kanë qenë viktimat të skemave të mashtrimit, ku pagesat për kontributet e sigurimeve shoqërore ose nuk janë paguar fare ose janë paguar vetëm për disa vite pune.⁹² Për më tepër, si të dhënat e unionit ashtu edhe intervistat me gazetarët tregojnë për një prirje të re në marrëdhëniet e punës: edhe kur paguhen sigurimet shoqërore ato bazohen mbi rrogën minimale dhe jo mbi rrogat reale të punonjësve të medias, duke nxjerrë edhe njëherë në pah problemin e informalitetit. Sipas Unionit, 98 për qind e organeve të medias nuk i deklarojnë rrogat reale të punonjësve të tyre.⁹³

⁸² Po aty.

⁸³ Intervista të thelluara me redaktorë dhe pronarë të mediave.

⁸⁴ Po aty.

⁸⁵ Të dhënat e Unionit të Gazetarëve Shqiptarë.

⁸⁶ Deklaratë e Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, 21 shtator 2013.

⁸⁷ Të dhënat e Unionit të Gazetarëve Shqiptarë.

⁸⁸ Intervistë me Aleksandër Çipën.

⁸⁹ Intervistë me Aleksandër Çipën.

⁹⁰ Po aty.

⁹¹ Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, *Praktikat informale të punës në mediat shqiptare*, 2012, faqe 21.

⁹² Intervistë me Aleksandër Çipën.

⁹³ Po aty.

Liria e Gazetarëve për të Marrë Pjesë në Sindikata

Treguesi 12 – Gazetarëve nuk duhet t'u ndalohej krijimi i organizatave profesionale dhe sindikatave për përfaqësim kolektiv.

Legjislacioni shqiptar e mbron të drejtën e qytetarëve për t'u bashkuar në organizata sindikale. Kushtetuta garanton të drejtën e të punësuarve të bashkohen lirisht në organizata sindikale për mbrojtjen e të drejtave të tyre të punës (Neni 50). Shqipëria ka ratifikuar gjithashtu 54 konventa të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, duke përfshirë edhe konventën për Lirinë e Organizimit dhe Mbrojtjen e të Drejtës së Organizimit. Fryma e këtyre konventave pasqyrohet në shumë aspekte të Kodit të Punës⁹⁴. Mbrojtja e lirisë së organizimit në sindikata përforcohet me këtë Kod, i cili thotë se kjo liri mbrohet me ligj dhe askush nuk ka të drejtë të kushtëzojë, të pushojë ose cenojë punësimin e punëmarrësit si pasojë e anëtarësimit në sindikatë (Neni 10). Parimi i lirisë së sindikatave pasqyrohet gjerësisht në këtë Kod duke përfshirë lirinë nga diskriminimi ndaj përfaqësuesve të sindikatës, dhe nevojën që sindikatata të aprovojë dhe të negociojë kontratat e punës, ndryshimet e kontratave, pushimet nga puna, ndërsa punëdhënësi duhet të krijojë kushte për ushtrimin normalisht të funksioneve të organizatave sindikale në ambienteve e kompanisë (Neni 181). Legjislacioni i medias nuk merret në mënyrë specifike me lirinë sindikale në organet mediatike pasi ato rregullohen gjithësesi nga legjislacioni i marrëdhënieve të punës. I vetmi përjashtim në këtë rast është dokumenti i Parimeve Editoriale i hartuar nga radio televizioni publik RTSH, që thotë se punonjësit e RTSH-së janë të lirë të anëtarësohen ose jo në organizata politike apo sindikata, me kusht që ky aktivitet të mos bjerë ndesh me punën e tyre si gazetarë apo në administratën e RTSH-së⁹⁵. Gjithashtu punonjësit që janë anëtarë të organizatave sindikale nuk mund të ndëshkohen apo të diskriminohen për këtë arsye, për sa kohë që ky angazhim nuk ndërhyt në kryerjen e punës së tyre.

Megjithëse ligji duket sikur krijon mbrojtje dhe të drejta të mjaftueshme për organizimin në sindikata, tani për tani nuk ka asnjë sindikatë në organet mediatike në vend. Gjatë 27 viteve tranzicion nga diktatura në demokraci, e vetmja organizatë sindikale brenda organeve të medias ka qenë sindikata e punonjësve të radio televizionit shqiptar, por që edhe ajo ishte shumë e dobët dhe për momentin nuk është më aktive⁹⁶. Ka shumë arsye që mund të shpjegojnë dobësinë e organizimit sindikal në vend, por fakti që gati asnjë nga mediat që ekzistojnë para viteve 90 nuk funksionojnë më (shiko Treguesin 22) ndryshoi totalisht funksionimin e organeve të medias, dhe duket qartë nga problemet e shumta në marrëdhëniet e punës se mbrojtja sociale nuk ka qenë një prioritet në kontekstin e problemeve të përgjithshme të marrëdhënieve të punës në vend.

E vetmja organizatë që ngre vazhdimisht zërin për marrëdhëniet në punë në media është Unioni i Gazetarëve Shqiptarë. Megjithëse përmirësimi i marrëdhënieve të punës në media është përmendur si problem serioz që duhej parë me prioritet përgjatë dy dekadash, shtysa për të krijuar një organizatë sindikale nuk ka ardhur gati asnjëherë nga rradhët e këtij komuniteti, por nga donatorë të ndryshëm. Përpjekja e parë për të krijuar një sindikatë gazetarësh u shënua në vitin 1999, me mbështetjen e IREX-it, por kjo tentativë dështoi pasi nuk u arrit të mblidhej një numër i mjaftueshëm anëtarësh, mesa duket nga frika e gazetarëve se mos pushoheshin nga puna po të anëtarësoheshin në sindikatë.⁹⁷ Përpjekja e dytë për krijimin e një organizate të tillë, që u mbështet sërish nga IREX, erdhi në vitin 2005 që u kurorëzua me krijimin e unionit që vazhdon edhe sot e kësaj dite.

⁹⁴ Kodi i Punës, Ligji nr.7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 13.03.2006; Ligji nr.9125, datë 29.07.2003; Ligji nr.10 053, datë 29.12.2008; Ligji nr. 136/2015, datë 5.12.2015, që mund të shikohen në <http://www.qbz.gov.al/botime/Kodi%20i%20Punes-2016%20i%20azhurnuar.pdf>

⁹⁵ Parimet Editoriale të RTSH-së.

⁹⁶ Intervistë me Thoma Gëllçin, Drejtor i Përgjithshëm i RTSH-së.

⁹⁷ International Research and Exchanges Board (IREX – Bordi Ndërkombëtar i Kërkimeve dhe Shkëmbimeve), "Kapitulli i Shqipërisë" në *Media Sustainability Index 2003: Development of Sustainable Independent Media in Europe and Eurasia* (Treguesi i Qëndrueshmërisë në Media 2003: Zhvillimi i Mediave të Pavarura dhe të Qëndrueshme në Evropë dhe Euroazi) (Washington: IREX, 2003), f. 10.

Unioni është regjistruar si shoqatë jo fitimprurëse dhe ka në gjirin e saj 786 anëtarë, apo 400 vetë më pak se numri i regjistruar në fillim të viti 2017, para se të rifreskoheshin të dhënat nga reduktimi i anëtarëve jo aktivë⁹⁸. Unioni ka degë në 11 rrethe të vendit si në Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Sarandë, Korçë, Shkodër, Berat, dhe Lezhë, si dhe katër nën-degë në Pogradec, Kurbin, Burrel dhe Lushnjë. Rreth 650 anëtarë, apo 82 përqind e pjesëmarrësve të tij janë gazetarë, ndërsa pjesa tjetër janë kameramanë, fotografë, apo në profesion të lirë⁹⁹. Nuk ka statistika të sakta mbi numrin e përgjithshëm të gazetarëve dhe personave të tjerë të punësuar në media. Shumica e gazetarëve duket se nuk janë anëtarë të Unionit. Sipas të dhënave të kësaj organizate, aktualisht ka rreth 2,700 gazetarë që punojnë në media, ndërsa numri total i punonjësve të medias, duke përfshirë edhe personelin teknik dhe stafin e administratës, është rreth 6,200.¹⁰⁰

Unioni është aktiv në lëshimin e deklaratave publike në rastet e shkeljeve të të drejtave të punës dhe lirisë së medias. Ata mundohen gjithashtu të publikojnë në mënyrë të rregullt të dhëna mbi prirjet kryesore dhe problemet në zbatimin e Kodit të Punës në media, për të tërhequr vëmendjen mbi aspektet problematike të të drejtave të punës, si vonesat në dhënien e rrogave, pushimet nga puna në redaksi, mospagimet e sigurimeve shoqërore për punonjësit e medias, etj. Sidoqoftë Unioni ka burime të kufizuara si nga ana teknike ashtu dhe nga ana financiare. Megjithëse ka një numër të kënaqshëm anëtarësh, pjesëmarrësit në Union nuk paguajnë kuota vjetore për të mbështetur punën e Unionit, por vetëm një tarifë të vogël fillestare anëtarësimi¹⁰¹.

Sfida më e madhe për sa i përket marrëdhënieve të punës, si dhe vetë funksionimit të Unionit, vazhdon të jetë ngritja dhe funksionimi i organizatave sindikale në organet e medias. Për momentin Unioni po punon për të ngritur një organizatë të tillë brenda Radio Televizionit Shqiptar, por mbetet për t'u parë nëse do të jenë të suksesshëm¹⁰². Pronarët e mediave private i kanë bërë shumë rezistencë krijimit të sindikatave në ndërmarrjet e tyre dhe për pasojë gazetarët kanë frikë se mos pushohen nga puna dhe ngurrojnë të mbështetin iniciativat për krijimin e sindikatave pa u siguruar më parë për përfitimet që mund të kenë¹⁰³. Gjithashtu edhe puna mjaft e dobët e institucioneve shtetërore për të siguruar zbatimin e dispozitave të Kodit të Punës i pengon shumë përpjekjet e gazetarëve për t'u organizuar në mbrojtje të të drejtave të tyre të punës.

Një faktor tjetër që ndikon negativisht në krijimin e një lëvizjeje sindikaliste në organet e medias është edhe mungesa e përgjithshme e besimit tek sindikatat, duke u nisur edhe nga eksperiencia e keqe me to gjatë këtyre 20 viteve të fundit. Në vitin 2016 një sondazh në popullatë tregoi se 49 përqind e qytetarëve të anketuar besonin se sindikatat nuk i kërkojnë llogari qeverisë¹⁰⁴. Po kështu, një sondazh i zhvilluar në vitin 2014¹⁰⁵, tregoi se 86 përqind e të anketuarve thanë se nuk ishin në gjendje të përgjigjeshin mbi efikasitetin e sindikatave pasi nuk ishin fare në dijeni se ato ekzistonin.

Edhe situata në komunitetin e medias është pak a shumë e ngjashme me këtë peizazh të përgjithshëm. Një sondazh i zhvilluar me redaktorë dhe gazetarë nga organe të medias anembanë vendit në vitin 2017 tregoi se vetëm 24 përqind e të anketuarve e konsideronin Unionin si një nga institucionet më të rëndësishme për mbrojtjen e lirisë së medias në vend. Një nivel akoma më i ulët besimi u regjistrua për shoqatat profesionale të medias, që përmenden vetëm nga 19 përqind e të anketuarve, dhe shoqatat e shoqërisë civile me 10 përqind. Një pjesë e madhe e të anketuarve, gati 43 përqind e tyre, besonin se vetë media dhe gazetarët janë faktori më i rëndësishëm për sa i përket mbrojtjes së lirisë së medias.

⁹⁸ Të dhëna nga Unioni i Gazetarëve Shqiptarë.

⁹⁹ Po aty.

¹⁰⁰ Po aty.

¹⁰¹ Po aty.

¹⁰² Intervistë me Aleksandër Çipën, kryetar i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë.

¹⁰³ Po aty.

¹⁰⁴ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, "Besimi në Qeveri 2017 - sondazh i opinionit publik," 2018.

¹⁰⁵ <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/11314.pdf>

Mbrojtja e një Politike Editoriale të Pavarur

Treguesi 13 – Redaksitë e lajmeve duhet të kenë pavarësi editoriale nga pronarët e mediave, dhe kjo duhet të realizohet duke hartuar një kod sjelljeje profesionale në bashkëpunim me pronarët e mediave për pavarësinë editoriale, për t'u siguruar se këta pronarë nuk do të ndërhyjnë në punën e përditshme të redaksive apo të kompromentojnë paanshmërinë në punën e gazetarëve.

Parimi i pavarësisë editoriale garantohej në parim nga legjislacioni, por nuk është marrë asnjë masë tjetër për të siguruar zbatimin e këtij koncepti në punën e përditshme të medias. Në praktikë, nuk ka asnjë institucion apo instrument që të mbrojtë gazetarët nga ndërhyrjet e pronarëve të medias. Autonomia dhe pavarësia e gazetarëve është mbase një nga elementët e lëna më pas dore nga legjislacioni, dhe deri në njëfarë pike është injoruar edhe nga opinioni publik. Mediat zakonisht identifikohen me pronarët dhe interesat e tyre, dhe për pasojë mungesa e autonomisë profesionale të gazetarëve merret automatikisht si e mirëqënë, dhe bëhet objekt diskutimi vetëm kur ka ndonjë zhvillim të ri, dhe nuk është objekt i vazhdueshëm shqetësimi në lidhje me mbrojtjen e pavarësisë së medias.

Legjislacioni merret pak dhe në mënyrë të përciptë me pavarësinë editoriale. Kushtetuta garanton parimet e përgjithshme të lirisë së medias dhe ndalon çdo censurë paraprake të mjeteve të komunikimit masiv (Neni 22). Po kështu, edhe ligji për shtypin e garanton këtë liri. Neni 4 i Ligjit për Mediat Audiovizive e konsideron lirinë e shprehjes dhe lirinë e operatorëve të mediave audiovizive si një nga parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audicovizive.¹⁰⁷ Radio televizioni publik ka hartuar Parimet Editoriale, një listë e detajuar rregullash dhe parimesh, që përfshin edhe nevojën e punonjësve të RTSH-së për të mbrojtur dhe përforcuar pavarësinë e tyre profesionale¹⁰⁸. Parimet Editoriale e nënvizojnë rëndësinë dhe vlerën e pavarësisë, por problemi është se kjo shihet si pavarësi vetëm nga ndikimet e jashtme, dhe jo aq nga influenca e strukturave të brendshme. Nga ana tjetër Parimet Editoriale nuk kanë ndonjë dispozitë që kërkon ngritjen e mekanizmave apo instrumenteve që mund ta sigurojnë këtë pavarësi në praktikë.

Në fakt, edhe ato pak dispozita në lidhje me pavarësinë editoriale të kodit të RTSH-së janë të pamjaftueshme, pasi ato nuk parashikojnë ngritjen e mekanizmave në redaksi për mbrojtjen e pavarësisë editoriale. Medias i njihet e drejta e pavarësisë editoriale, por legjislacioni nuk shkon më tej në përshkrimin apo rregullimin e mënyrave se si mund të mbrohet pavarësia editoriale, për shembull nëpërmjet gjobave apo sanksioneve, krijimit e mekanizmave mbrojtës për gazetarët, apo përfshirja e një klauzole ndërgjegjeje në kontrata, etj.

Në praktikë nuk ekziston asnjë kod sjelljesh apo ndonjë kontratë e shkruar që të formalizojë marrëdhënien midis pronarëve të medias dhe gazetarëve dhe të kontribuojë në garantimin e pavarësisë editoriale. Në përgjithësi kontratat e punës përgatiten për të ndihmuar pronarët që të duket sikur respektojnë Kodin e Punës dhe për të evituar ndonjë inspektim nga autoritetet shtetërore, por ato janë thjesht dokumente administrative dhe nuk merren me aspekte të punës gazetareske¹⁰⁹. Për më tepër, duke patur parasysh edhe sistemin aktual të pronësisë së mediave shqiptare, do të ishte kundërproduktive për vetë pronarët e medias që të kufizonin ndikimin e tyre mbi politikën editoriale.

¹⁰⁶ Të dhëna nga sondazhi i kryer për këtë studim.

¹⁰⁷ Ligji për Mediat Audiovizive 97/2013.

¹⁰⁸ RTSH, Parimet editoriale.

¹⁰⁹ Intervista të thelluara me gazetarë dhe redaktorë për këtë studim.

Pjesa më e madhe e pronarëve të medias kanë interesa të tjera ekonomike përveç organeve të medias që zotërojnë, dhe shumica e tyre vijnë nga fusha e biznesit dhe e përdorin median për të promovuar interesat e kompanive të tyre¹¹⁰. Intervistat me redaktorë treguan se lidhjet e pronarëve të medias me politikën, të motivuara nga interesa ekonomike, janë forcat kryesore drejtuese të redaksive.

Një gazetar me eksperiencë tha: “Liria editoriale dhe pavarësia e medias në Shqipëri varet gjithmonë nga burimet financiare që mbushim arkën e medias. Nëse pronari mendon se një parti politike apo ndonjë kompani tjetër po çënon interesat e tij, ato bëhen menjëherë objekt sulmi nga media e tij. Në rast të kundërt, këto subjekte ‘nuk preken’ nga redaksia.”¹¹¹ Kjo mënyrë pune e ka nxjerrë jashtë loje idenë e një politike të pavarur editoriale, duke e transformuar median në një instrument të thjeshtë fitimprurës, dhe ka kufizuar akoma më tepër hapësirat që kanë gazetarët për të manovruar në këtë ambient mediatik. “Në ditët e sotme media është kapur nga lidhjet e krijuara me pronarët e medias që kanë biznese të tjera, dhe gazetarët nuk kanë mundësi të zgjedhin një media që është disi më kritike ndaj qeverisë, dhe për pasojë Facebook-u mbetet e vetmja alternativë shprehje. Nga ana tjetër gazetarëve u bëhen presione edhe për komentet e tyre kritike në faqen e veta në Facebook,”¹¹² tha një redaktor. Një tjetër redaktor i intervistuar për këtë studim tha se “sëmundja më e rëndë për gazetarinë shqiptare është autocensura e gazetarëve dhe kapja e pronarëve të medias. Këto probleme janë të lidhura me njëra-tjetrën. Krimi dhe politika ka kapur pronarët e medias, që me sa duket nuk e kanë problem që të jenë ‘pengjet’ e tyre. Nga ana tjetër, gazetarët e censurojnë veten që të ruajnë vendin e punës.”¹¹³ Qëndrimi unanim i redaktorëve mbi këtë pikë tregon qartë se interesat ekonomike dhe lidhjet e pronarëve të mediave me politikën kanë krijuar një klimë jo të favorshme për hartimin e një politike të pavarur editoriale për mediat, për të mos folur fare për zbatimin e saj në praktikë. Kjo është edhe arsyeja pse disa të intervistuar përmendën rastin e Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Investigative (BIRN) si një shembull i suksesshëm në raportim, duke e lidhur këtë ngushtë me pavarësinë e tyre ekonomike¹¹⁴.

Një sërë studimesh mbi lirinë e medias dhe profesionalizmin në gazetari konfirmojnë se vetëcensura është e ngulitur thellë në mediat shqiptare, që janë më shumë të interesuara të mbrojnë interesat politike apo të biznesit të pronarëve të tyre, se sa interesin publik. Një sondazh në lidhje me prirjet ndaj vetëcensurës tregoi se 73 për qind e të anketuarve besonin se gazetarët shqiptarë e shmangnin raportimin e lajmeve që binin ndesh me interesat e medias së tyre. Punonjësit e medias u pyetën në sondazh rreth eksperiencave personale për këtë fenomen, dhe rezultoi se 48 për qind e tyre kishin evituar raportimin e lajmeve apo ngjarjeve të caktuara shpesh ose disa herë gjatë karrierës së tyre.¹¹⁵ Kur u pyetën në lidhje me strukturën e brendshme të redaksisë së lajmeve dhe elementet që ndikonin më shumë tek autocensura, rezultatet e sondazhit treguan se në 56 për qind të rasteve kjo vinte si rezultat i sinjaleve apo urdhrave direkte të redaktorëve dhe pronarëve të medias.¹¹⁶

Intervistat me redaktorë dhe drejtues mediash për këtë raport konfirmuan se gjetjet e atij studimi vazhdojnë të jenë aktuale edhe tani, dhe se vetëcensura është kthyer në pjesë përbërëse të ADN-së së gazetarit. Një redaktor tha: “Unë besoj se ne vuajmë më shumë nga autocensura, se sa nga mungesa e lirisë. Nuk marim më telefonata nga pronari që të na japë udhëzime, por vetë ne jemi gjithmonë e më të kujdesshëm kur merremi me personazhe të caktuar dhe mundohemi të hamendësojmë marrëdhëniet që kanë me pronarin.”¹¹⁷ Një tjetër redaktor tha se kishte arritur në përfundimin se faktorët që bëjnë të mundur një gazetari të mirë “ose

¹¹⁰ Londo, Shqipëria, në *Rëndësia e integritetit të medias*, 2014.

¹¹¹ Intervista të thelluara me gazetarë dhe redaktorë për këtë studim.

¹¹² Po aty.

¹¹³ Intervista të thelluara me gazetarë dhe redaktorë për këtë studim.

¹¹⁴ Po aty.

¹¹⁵ BIRN Shqipëri, *Të mbyllësh një sy ndaj lajmit: Vetëcensura në median shqiptare*, 2015.

¹¹⁶ Po aty.

¹¹⁷ Intervista të thelluara me gazetarë dhe redaktorë për këtë studim.

nuk ekzistojnë fare ose sa vijjnë e degradojnë, dhe lufta për mbijetesë i ka çuar gazetarët drejt vetëcensurës si ilaçi i vetëm që mund t'i sigurojë jetëgjatësi në tregun e medias. Për pasojë edhe interesat e pronarëve bëhen gjithmonë e më të rëndësishme për gazetarët, pasi ata e shohin se këto interesa kanë rëndësi jetike për vazhdimësinë e medias ku punojnë, dhe rrjedhimisht edhe për vazhdimësinë e vendit të tyre të punës.”¹¹⁸

Përveç interesave të biznesit të pronarëve të medias, një tjetër burim i rëndësishëm financimi, por edhe burim potencial presioni, janë edhe kompanitë private që bëjnë reklama. (Në lidhje me reklamën shtetërore shiko treguesin 19.) Rastet kur kompanitë private kanë tërhequr reklamën, apo kanë bojkotuar media të caktuara si pasojë e politikave të tyre editoriale, nuk është se janë të panjohura për gazetarë dhe redaktorë; madje mund të thuhet se kjo është diçka e zakonshme. Duke patur parasysh se tregu i reklamave dominohet nga telefonia celulare dhe kompani të mëdha, influenca e tyre direkte apo indirekte është goxha e dukshme në punën e përditshme të mediave dhe në përmbajtjen e tyre.

“Burimet e financimit të mediave nuk janë të diversifikuara sa duhet dhe kompanitë e mëdha sponsorizuese, si kompanitë e celularëve, vazhdojnë të kenë rëndësi shumë të madhe për mbijetesën e mediave. Për pasojë, ato janë në gjendje të influencojnë politikën editoriale të mediave, dhe kjo është arsyeja pse nuk shohim kritika rreth këtyre kompanive në media. Edhe nëse ka ndonjë kritikë mbi këto kompani, kjo ndodh se media po mundohet të tërheqë financime prej tyre.”¹¹⁹ Kjo praktikë ka qenë më e dukshme në rastet e diskutueshme kur janë përfshirë reklamuesit më të mëdhenj, kryesisht kompanitë e telekomunikacionit dhe bankat. Kështu kur autoriteti shtetëror i konkurrencës gjobiti në vitin 2007 dy kompanitë kryesore të celularëve, Vodafone dhe AMC, për praktika anti-konkurruese, ky lajm u publikua vetëm nga një numër i vogël organesh mediatike.¹²⁰ Edhe kur i njëjti autoritet shtetëror nisi një hetim kundër kompanisë Vodafone, kaluan disa muaj përpara se artikuj mbi këtë çështje të publikoheshin në një numër të vogël mediash, megjithëse kishim të bënim më një lajm me interes për publikun. “Përkundrazi, autoriteti shtetëror i konkurrencës u sulmua nga mediat me kritika të stilit tabloid në lidhje me hetimin.”¹²¹ E njëjta situatë u përsërit në vitin 2017, kur Autoriteti i Konkurrencës nisi një hetim rreth mbi minimizimin e konkurrencës nga kompanitë celulare në lidhje me paketat e rimbushjes që ofronin në treg. Ky lajm u raportua vetëm nga disa media, gjë që tregoi edhe njëherë lidhjen direkte midis kompanive reklamuese dhe lirisë së medias dhe pavarësisë së tyre. Sipas një pronari mediash, presioni i reklamuesve që kërcënojnë të tërheqin reklamën momentin që ti thua një të vërtetë universale që i dëmton është i prekshëm çdo ditë. “Ka patur raportime për disa raste tragjike dhe reklamuesit na kanë kërcënuar që do i heqin fondet e tyre nga media, duke na dëmtuar pavarësinë editoriale dhe financiare. Në këto raste mungon solidariteti mes mediave dhe bizneset e fuqishme mund t’ia arrijnë kollaj që të heqin lajmet negative nga media të tjera dhe po aq lehtësisht të penalizojnë media që kanë refuzuar të heqin lajmet që dëmtojnë reklamuesit.”¹²²

¹¹⁸ Po aty.

¹¹⁹ IREX, Treguesi i Qëndrueshmërisë së Medias 2012.

¹²⁰ Besar Likmeta, “Reklamuesit e mëdhenj shkatërrojnë lirinë e medias në Shqipëri,” <http://www.balkaninsight.com/en/article/big-advertisers-subvert-albanian-media-freedom>

¹²¹ Po aty.

¹²² Intervista të zgjeruara me gazetarë dhe redaktorë për qëllimin e këtij studimi.

Mbrojtja e Sigurisë së Gazetarëve

Treguesi 14 – Gazetarët duhet të jenë të mbrojtur nga sulmet apo kërcënimet fizike për arsye të punës që bëjnë. Duhet të sigurohet mbrojtje nga ana e policisë kur kjo kërkohet nga gazetarët që ndihen të kërcënuar. Prokurorët dhe gjykatat duhet të reagojnë në kohë dhe në mënyrën e duhur për rastet kur gazetarët janë kërcënuar apo janë sulmuar.

Nuk ka patur gazetarë të vrarë në Shqipëri madje edhe rastet e sulmeve fizike kanë qenë të rralla. Nuk ka dispozita të veçanta ligjore për mbrojtjen e gazetarëve dhe nuk parashikohen dënime specifike për personat që sulmojnë gazetarët. Kodi Penal përmban disa dispozita ligjore në lidhje me goditjet edhe kanosjet e personave për shkak të detyrës (Nenet 237 dhe 238), por këto dispozita janë menduar që të mbrojnë zyrtarë publikë apo persona që kryejnë shërbime publike.

Autoritetet policore zakonisht reagojnë shpejt në raste incidentesh, por shkaktarët rrallë gjenden. Në vitin 2017 pati një sulm të rëndë ndaj Elvi Fundos, pronarit të portalit të lajmeve Citynews dhe drejtori i Radio Best. Ai u rrah në rrugë nga dy persona më 8 Mars në Tiranë, dhe u shtrua për një kohë të shkurtër në spital. Më pas Fundo deklaroi në faqen e tij në Facebook se sulmi ndaj tij “nuk kishte motive politike, por ishte një krim i kryer nga klane mediatike të korrumpuara që kanë lidhje me mafian e drogës.” Pas hetimeve policore një nga personat që goditën gazetarin u kap dhe është momentalisht në burg, por nuk dihet akoma se kush ishte porositësi i këtij akti kriminal.

Në një rast tjetër në vitin 2014, Artur Çani, një gazetar investigativ i televizionit News 24 në atë kohë, shpëtoi pa u dëmtuar nga një tentativë vrasje kundër tij. Pamjet e marra nga kamerat e sigurisë së ndërtesës ku jetonte treguan se një burrë me maskë ishte munduar ta qëllonte, por arma ishte bllokuar dhe gazetari shpëtoi pa e gjetur gjë. Megjithatë ndërhyrjen e shpejtë nga ana e policisë dhe Ministrisë të Punëve të Brendshme, arsyet dhe personat e përfshirë në këtë tentativë vrasje nuk u zbuluan dot.

Një tjetër kategori sulmesh kundër gazetarëve janë edhe rastet e përplasjeve me persona që gazetarët takojnë gjatë punës së tyre, dhe në disa raste këto takime kanë degjeneruar në përballje fizike dhe verbale. Një rast i tillë u regjistrua në vitin 2017 dhe u dokumentua nga programi investigativ Stop në televizionin kombëtar Klan. Gazetari Genci Angjellari po mundohej të intervistonte administratoren e një kompanie që dyshohej se hidhte plehra dhe mbetje të rrezikshme spitalore në një lumë aty pranë. Gruaja në fillim e sulmoi me fjalë dhe e kërcënoi gazetarin, por ai nguli këmbë me pyetjet e tij, dhe më pas ajo u mundua disa herë ta godiste dhe ta qëllonte me shpullë.

Në një tjetër rast të ngjashëm, Eduard Illica, një gazetar sportiv që punonte për televizionin Telesport, u rrah keq nga presidenti i një klubi futbollit si pasojë e komenteve të bëra në lidhje me një ndeshje futbollit, dhe përfundoi në spital. Ministri i Drejtësisë i kërkoi autoriteteve shtetërore që ta merrnin seriozisht këtë krim. Presidenti i klubit të futbollit doli para gjykatës dhe pranoi se kishte marrë pjesë në rrahjen e gazetarit, por më pas çështja u tërhoq pas arritjes së një marrëveshjeje midis palëve, dhe gazetari e tërhoqi padinë.

Fatmirësisht sulmet fizike kundër gazetarëve janë të rralla, por përplasjet verbale janë disa nga vështirësitë me të cilat duhet të përballen gazetarët në Shqipëri. Anonimati që ofrohet nga mediat sociale dhe mediat online duket se e përkeqësojnë akoma më tepër këtë situatë. Në shtator 2017, Rudina Xhunga, një gazetare shumë e njohur që drejtonte programin Dritare në televizionin Vizion Plus, mori kërcënime në faqen e saj në Facebook. Kërcënimet duket se vinin nga persona ekstremistë pas një programi që u përqëndrua mbi polemikat në lidhje me festimet për muajin e Ramazanit dhe statujën e heroit tonë kombëtar Skënderbeut në sheshin kryesor të Tiranës.

Në raste shumë të rralla, që janë konsideruar si veçanërisht serioze, policia ka ofruar edhe mbrojtje të përhershme për personat e prekur. Për shembull, në vitin 2015 Artan Hoxhës, një gazetari investigativ, i patën ardhur disa kërcënime në telefonin celular kundër tij dhe pjesëtarëve të familjes pas publikimit të një raportimi investigativ mbi mbjelljen dhe kultivimin e kanabisit. Policia e vuri Artan Hoxhën nën mbrojtjen e saj për disa ditë, por nuk pati zhvillime të mëtejshme në atë rast.

Sondazhi i zhvilluar me gazetarë dhe redaktorë lajmesh nga disa qytete të vendit tregoi se gjashtë për qind e të anketuarve i konsideronin kërcënimet për dhunë fizike ndaj gazetarëve si një shkelje të lirisë së medias. Raste të tilla zakonisht ndiqen nga deklarata proteste dhe reagime nga Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, shoqata të tjera të shoqërisë civile, apo edhe nga gazetarë individualë. Policia zakonisht reagon shpejt dhe mbështet gazetarët, por në rastet më serioze të përplasjeve dhe dhunimit të gazetarëve e verteta nuk është zbuluar dot. Si rezultat i kësaj, edhe proceset gjyqësore kundër autorëve të këtyre krimeve kundër gazetarëve kanë qenë shumë të rralla.

Paanshmëria dhe Efikasiteti i Autoriteteve Rregullatore

Treguesi 15 – Autoritetet rregullatore të mediave audiovizive duhet të funksionojnë në mënyrë të paanshme dhe efikase, si për shembull në rastet kur japin licencat e transmetimit. Shtypi dhe mediat në internet nuk duhet të kenë nevojë të pajisen me licensë nga autoritetet shtetërore, përveç regjistrimit në listën e bizneseve dhe në drejtorinë e tatimeve.

Ligji për Radion dhe Televizionin, që u miratua në vitin 1998 dhe u shfuqizua në vitin 2013, thoshte se radio televizioni publik RTSH është person juridik që nuk ka nevojë për licensë (Neni 21). Ligji për Mediat Audiovizive në fuqi përmend vetëm se RTSH është radio televizioni publik me statusin e një personi juridik, por nuk e përcakton faktin se RTSH nuk ka nevojë për licensë. Megjithëse ky element nuk përmendet në ligj, në praktikë nuk ka ndryshuar asgjë pas miratimit të legjislacionit të ri dhe licensa e RTSH-së vazhdon të rifreskohet automatikisht si rezultat i të qenit radio televizioni publik. Nga ana tjetër, mediat e shkruara nuk e kanë të detyruara të regjistrohen pranë ndonjë autoriteti rregullator të medias, por funksionojnë thjesht si aktivitete biznesi ose si organizma jo fitimprurëse, dhe duhet të respektojnë legjislacionet respektive. Nuk ka ndonjë licensë të veçantë për organet e medias së shkruar dhe nuk ka detyrim regjistrimi në shtet. E njëjta gjë vlen edhe për mediat online, që janë tërësisht të parregulluara me ligj, madje ato nuk kanë as detyrimin që të regjistrohen si aktivitete biznesi ngaqë mungon legjislacioni në këtë fushë¹²³.

Nga ana tjetër, mediat audiovizive duhet të përmbushin disa kushte dhe kriteret për t'u pajisur me licensë apo autorizim transmetimi nga enti rregullator, Autoriteti i Mediave Audiovizive, nëse duan të fillojnë aktivitetin. Me daljen në skenë të procesit të kalimit në transmetimet digjitale dhe me aprovimin e Ligjit për Mediat Audiovizive, janë shtuar edhe llojet e licensave që lëshohen nga enti rregullator, në varësi të shërbimit të ofruar dhe hapësirës së mbulimit që lejohej nga licensa. Llojet e licensave që lëshohen nga AMA përfshijnë licencat për shërbim programi audio apo audioviziv; licensë për transmetime audio ose audiovizive (që përbëhen nga licensa për shërbim programi, dhe licensë për krijimin dhe funksionimin e një rrjeti transmetimi, i cili mund të jetë analog ose digjital). Licencat mund të jenë kombëtare, rajonale, apo lokale, në varësi të kategorisë të rrjetit të mbulimit tokësor që do të mbështesë punën e operatorit të transmetimit. AMA lëshon gjithashtu licensa për krijimin e rrjeteve digjitale (licensë për multipleks). Një tjetër kategori licensimi janë autorizimet që lëshohen për shërbim programi audio dhe autorizimet për shërbim programi audioviziv, në rastet kur ky shërbim ofrohet nga rrjetet e përmendura më lart. Autorizimi varet nga lloji i sistemit që bën të mundur transmetimin e programit: me satelit; me kabëll; në internet; dhe ofruet shërbimi, duke përfshirë shërbimin e aksesit të kushtëzuar (Neni 55). Si rregull i përgjithshëm, “çaktimi i frekuencave bëhet mbi bazën e objektivitetit, transparencës, mosdiskriminimit, disponueshmërisë së frekuencave të lira dhe, në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave, vetëm në brezat e frekuencave të përcaktuara për t'u administruar nga AMA.” (Neni 54)

Autoriteti i parë rregullator ishte Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT), që u krijua pas miratimit të Ligjit për Radion dhe Televizionin në vitin 1998. Ai u zëvendësua në vitin 2013 nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), pas miratimit të Ligjit për Mediat Audiovizive. Gjatë 18 viteve eksperiencë në krijimin dhe funksionimin e institucioneve rregullatore për mediat audiovizive janë vënë re dy probleme kryesore që akoma nuk janë zgjidhur: sigurimi dhe forcimi i pavarësisë së këtij insitucioni, si dhe efektshmëria në punë e këtij autoriteti përgjegjës për rregullimin e tregut të mediave audiovizive.

Sipas Ligjit për Mediat Audiovizive institucioni që ka për detyrë të lëshojë licencat e transmetimit është Autoriteti i Mediave Audiovizive, institucioni rregullator i pavarur me statusin e personit juridik publik (Neni

¹²³ E vetmja kërkesë për këto media është regjistrimi në platformat e dedikuara të internetit vetëm për rastet kur duan të përdorin domenin .al por kjo kërkesë bëhet ndaj të gjitha faqeve të internetit që duan të përdorin këtë shtojcë adrese, dhe jo vetëm ndaj mediave online.

6). Problemi kryesor përgjatë gjithë historisë së enteve rregullatore audiovizive – në fillim KKRT, dhe më pas AMA – ka qenë funksionimi i tyre në mënyrë të efektshme, të pavarur nga institucione apo faktorë të tjerë, kryesisht nga politika. Formula e zgjedhjes së anëtarëve të këtij enti rregullator ka ndryshuar disa herë me propozimin dhe përfshirjen e politikanëve në këtë proces, dhe kjo është një shenjë që tregon se ky institucion është bërë funksional, por nga ana tjetër është edhe tregues i interesit të politikës rreth këtij institucioni.¹²⁴

Puna dhe funksionimi i AMA-s është ndikuar goxha nga dinamikat e skenës politike. Pikë së pari, dhe vetë procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të AMA-s varet shumë nga situata politike në vend. Në disa raste kur nuk arrihej dot një konsensus politik midis palëve, sidomos kur kishim bojkotim të Kuvendit nga opozita, partitë politike kanë refuzuar të emërojnë kandidatë për këtë institucion, dhe nuk është arritur dot zgjedhja e anëtarëve pasi mungonte numri i mjaftueshëm i deputetëve në sallën e parlamentit. Kjo situatë ka patur një ndikim të drejtpërdrejtë mbi punën e entit rregullator, duke e bërë atë të pazotin që të arrijë një ekuilibër politik apo të ketë edhe numrin e mjaftueshëm të votave për të marrë vendime të rëndësishme. Për shembull, mandati i një prej anëtarëve të AMA-s përfundoi në shtator 2012, por Kuvendi nuk arriti që të zgjidhte anëtarë të rinj deri në vitin 2013, si pasojë e ndryshimit të ligjeve dhe prioriteteve të tjera të parlamentit. Në vitet në vazhdim ka patur probleme me bllokimin e dhënies të licensave digjitale pasi enti nuk kishte numrin e mjaftueshëm të anëtarëve për të votuar (kuorum), si pasojë e mungesës së anëtarëve të këshillit të AMA-s që duhet të emëroheshin nga opozita. Nga ana tjetër, opozita hodhi në gjyq AMA-n në lidhje me rregulloren e saj për lëshimin e licensave digjitale, duke e vonuar akoma më shumë këtë proces. Për disa redaktorë dhe ekspertë të medias edhe vetë formula e përdorur për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit drejtues nuk lejon hapësira për pavarësi dhe krijon një hendek të thellë midis anëtarëve të Këshillit, pasi ata duhet të tregojnë besnikërinë ndaj partive politike që i kanë zgjedhur, të paktën për çështjet e rëndësishme që votohen nga AMA, dhe diçka më pak në vendimet me më pak vlerë¹²⁵. Kryetari aktual i AMA-s thotë se funksionimi i entit rregullator nuk çalon si pasojë e mangësive apo problemeve në legjislacion, sidomos duke patur parasysh se ligji u diskutua gjatë në Kuvend dhe u hartua me asistencën e ekspertëve ndërkombëtarë¹²⁶.

Profili i anëtarëve të AMA-s ka qenë gjithashtu një pikë e nxehtë e debatit politik dhe publik pasi profesioni dhe eksperiencia e tyre ndikon goxha në nivelin e pavarësisë që do të gëzojë enti rregullator. Legjislacioni përcakton një sërë kushtesh për papajtueshmërinë me pozicionin e anëtarëve të AMAs, që nuk mund të jenë: anëtarë të organeve drejtuese të partive dhe shoqatave politike, të kandidojnë për deputet apo të jenë zgjedhur të tillë gjatë dy legjislaturave të fundit, të kenë konkurruar për kryetar të njësisve vendore në zgjedhjet e fundit të organizuara për to apo kanë ushtruar detyrën e kryetarit të bashkisë, anëtarit të Këshillit të Ministrave apo të prefektit gjatë tre vjetëve të fundit, si dhe ata që janë anëtarë të Këshillit të Ankesave, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) apo punonjës të këtij të fundit (Neni 7). Në disa raste, kryetarët e AMA-s janë akuzuar gjithashtu për lidhje të ngushta me partitë politike. Këto dyshime konfirmohen edhe nga vetë fakti se një nga ish-kryetarët e këtij enti u bë deputet pasi i mbaroi mandati, ndërsa tjetri që erdhi pas tij në krye të AMA-s mban sot një post të rëndësishëm në partinë opozitare. Nga ana tjetër, opozita e luftoi me shumë forcë zgjedhjen e kryetarit aktual të AMA-s, me pretendimin se ai ishte i lidhur ngushtë me operatorin më të madh digjital në treg, pasi kishte punuar më parë për një kompani partnere me platformën digjitale Digitalb.

¹²⁴ Deri në vitin 2006, në bazë të meritave dhe përvojave profesionale, Presidenti propozonte një kandidat për AMA-n, ndërsa gjashtë të tjerët propozoheshin nga Komisioni Parlamentar i Medias, dhe më pas zgjidheshin me shumicë të thjeshtë. Në vitin 2006 qeveria propozoi ndryshime në ligj për ta ulur numrin e anëtarëve të KKRT-së në pesë vetë dhe për të përfshirë në procesin e emërimeve edhe shoqërinë civile, shoqatat e medias, përfaqësues të fushës akademike, etj. Ky propozim shkaktoi dyshime se qeveria po mendohej që të vendoste nën kontroll KKRT-në. Ligji u aprovua pa votat e opozitës. Më pas shumica dhe opozita ranë dakord që dy anëtarët e tjerë do të përzgjidheshin nga deputetët e opozitës nga kandidatët e shoqërisë civile; Ilda Londo, "Shqipëria," në *Televisionet anembanë Evropës: Më shumë stacione televizive, më pak pavarësi: Raporti në vazhdim 2008 (Television across Europe: More Channels, Less Independence: Follow-up Reports 2008)*, red. Mark Thompson (Budapest: Instituti Shoqëria e Hapur (OSI); dhe Programi i BE-së për Monitorimin dhe Përkrahjen (EUMAP), 2008).

¹²⁵ Intervista të thelluara të zhvilluara për këtë studim.

¹²⁶ Intervistë me Gentian Salën, kryetar i këshillit të AMA-s.

Këshillat e mëparshëm drejtues të AMA-s janë kritikuar në lidhje me marrjen e vendimeve të motivuara politikisht, ndërsa sfida më e madhe për entin rregullator aktual është që të tregojë se vendimet e marra prej tij nuk favorizojnë asnjë nga operatorët e veçantë mediatikë. Ky institucion ka trashëguar një situatë komplekse dhe një çështje të vështirë që kërkonte zgjidhje: licensimin e operatorëve transmetues në kuadrin e kalimit në teknologjinë e transmetimit digjital, në një kohë kur radio televizionet private janë shumë përpara në këtë aspekt, duke patur një eksperiencë më shumë se 10 vjeçare në tregun e medias. Strategjia e Kalimit në Transmetimet Numerike garanton në parim licensimin në mënyrë transparente, të drejtë dhe jodiskriminuese, por në të njëjtën kohë ajo vendos përdorimin e procedurës së “beauty contest” në lëshimin e licensave, që praktikisht e ngushton rrethin e aplikantëve në ato pak operatorë që janë futur tashmë në treg. Për pasojë, procesi i licensimit ruajti situatën aktuale në treg duke i lëshuar katër nga pesë licensat e mundshme për operatorët ekzistues, megjithëse anëtarët e opozitës u munduan ta pengonin dhe ta kundërshtonin këtë proces. Një vendim i entit rregullator që shkaktoi polemika ishte edhe lëshimi i licensës së pestë dhe të fundit kompanisë ADTN, një operator i krijuar së fundmi, pa eksperiencë, dhe që ishte 100 për qind në pronësi të Digitalb. Ky vendim u pa nga një pjesë e medias si varësi e këshillit drejtues të AMA-s nga operatorët e fuqishëm privatë.

Ky vendim u parapri nga një fushatë një vjeçare nga ana e operatorëve privatë, me ndihmën e politikës, për të ndryshuar kufizimin e pronësisë mbi mediat kombëtare (shiko indikatorin I8). Rregullat e vendosura me ligj mbi pronësinë, si një masë për të promovuar pluralizmin në media, e kufizonin mundësinë e lëshimit të disa licensave kombëtare për kompanitë kryesore në fushën e transmetimeve digjitale. Për të anashkaluar këto kufizime, me ndihmën e deputetëve socialistë, u propozua në Kuvend një projektligj për të hequr kufizimet në pronësi, gjë që u kundërshtua nga opozita dhe u kritikua nga organizatat ndërkombëtare si përpjekje për të minuar pluralizmin mediatik të garantuar me ligj. Pasi projektligji dështoi në Kuvend, operatorët privatë, nën emrin e Shoqatës të Mediave Elektronike, iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese me të njëjtën kërkesë, duke pretenduar se këto kufizime shkelnin të drejtën e tregtisë së lirë, një kërkesë që u pranua nga gjykata, duke lejuar kështu që një operator të zotërojë më shumë se një licensë. Në të gjitha këto përpjekje edhe AMA ishte e përfshirë në këtë proces në krah të operatorëve privatë, gjë që e vuri në pikëpyetje pavarësinë e saj.

Përveç bllokimit të procesit në lëshimin e licensave digjitale, enti rregullator ka qenë goxha i efektshëm në fusha të tjera të veprimtarisë së tij, si ecja përpara në procesin e prapambetur të kalimit në transmetime digjitale, dhe miratimi i akteve dhe rregulloreve në përmbushjen e kërkesave ligjore. Gjithashtu AMA ka stabilizuar situatën e saj ekonomike, falë ndërhyrjeve energjike në mbledhjen e pagesave për tarifën e licensimit, dhe vendimeve kundër operatorëve që refuzonin të paguanin kuotat e tyre, duke iu hequr licensat¹²⁷. Realizimi i planit vjetor në mbledhjen e këtyre tarifave ka shkuar nga 46 për qind që ishte në vitin 2011, në 87 për qind për vitin 2016,¹²⁸ dhe madje është rritur akoma më shumë gjatë vitit 2017¹²⁹. Duke patur parasysh faktin se shteti ka shumë vite që nuk jep fonde për funksionimin e entit rregullator, stabilizimi i situatës ekonomike është i rëndësishëm për mbarëvajtjen e punës së AMA-s.

Përveç mbledhjes së tarifave nga operatorët, enti rregullator ka rishikuar edhe tarifën e licensave të stacioneve të radios dhe i ka rritur, pasi sipas drejtorit të AMA-s tarifën ekzistuese nuk ishte në proporcion të drejtë me mundësitë ekonomike që u ofroreshin operatorëve. “Ne rishikuam tarifën, pasi nuk kishte fare kuptim nga pikëpamja ekonomike që një stacion lokal radioje në Tiranë të paguante vetëm 1,000 euro për tarifën e licensës, ndërkohë që merr reklama për tregun më të pasur në vend.”¹³⁰ Gjithashtu është kushtuar vëmendje më e madhe ndaj çështjeve gjyqësore, duke patur parasysh se ky ent rregullator është i përfshirë

¹²⁷ Intervistë me Gentian Salën, kryetar i AMA-s.

¹²⁸ Raporti vjetor i AMA-s 2017.

¹²⁹ Intervistë me Gentian Salën, kryetar i AMA-s.

¹³⁰ Po aty.

në disa çështje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës, të trashëguara nga administrata pararendëse, që duhet të paguhen.¹³¹

Një problem i përhershëm për entin rregullator ka qenë edhe vendosja e autoritetit të tij mbi operatorët radio televizivë, si në fushën e transmetimit pa licensë ashtu edhe në tejkalimin e kufizimeve zonale të parashikuara në licensa. Kjo vinte si pasojë e mënyrës se si ishte krijuar dhe funksiononte enti rregullator - ndërkohë që operatorë të palicensuar kishin kohë që ishin aktivë në treg - por edhe si pasojë e një prirjeje informaliteti në vend. AMA pretendon se për momentin ky problem nuk ekziston më. “Pas komunikimeve të vazhdueshme që kemi patur, por edhe vendimeve që kemi marrë, në këtë moment nuk ka më transmetues të paautorizuar, dhe nuk ka operatorë që shkelin kufijtë e licensës.”¹³²

¹³¹ Po aty.

¹³² Po aty.

Akses i Barabartë në Rrjetet e Transmetimit dhe Shpërndarjes

Treguesi 16 – Organet e medias duhet të kenë akses të barabartë në mekanizmat e shpërndarjes, si nga ana e teknologjisë (për shembull, frekuencat e radios, transmetimet me kabëll, apo satelit) ashtu edhe nga ana komerciale (agjencitë e shpërndarjes të gazetave, shërbimet postare apo mënyra të tjera të shpërndarjes së shtypit).

Në parim Ligji për Mediat Audiovizive mbron operatorët e transmetimit nga diskriminimi në dhënien e licensave dhe i kërkon entit rregullator që të caktojë frekuencat mbi bazën e “objektivitetit, transparencës, mosdiskriminimit, dhe disponueshmërisë së frekuencave të lira” (Neni 54). Legjislacioni gjithashtu kërkon që licensat për rrjetet digjitale të jepen me konkurrin të hapur duke garantuar trajtim të barabartë, objektiv dhe jo diskriminues (Neni 70). Po kështu edhe ligji dhe rregulloret e hartuara nga AMA i garantojnë operatorët lokalë se do të kenë akses me kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese, në 40 për qind të kapacitetit të rrjetit digjital kombëtar¹³³, një parim që theksohej edhe nga Strategjia e Kalimit nga Transmetimet Analoge në Digjitale¹³⁴.

Megjithëse këto parime përcaktohen qartë në ligj, dinamika e zhvillimeve në median elektronike në vend krijoi një situatë të tillë ku konkurrimi për një pjesë të licensave nuk ishte i hapur për të gjithë operatorët, por vetëm për disa prej tyre. Megjithëse platforma e parë digjitale private filloi të funksiononte pa licensë në vitin 2004, Strategjia për Kalimin në Transmetime Digjitale, dokumenti zyrtar që orienton kalimin në transmetime digjitale, u aprovua vetëm në vitin 2012. Gjatë kësaj kohe, një platformë digjitale private u hap dhe u mbyll, ndërsa dy platforma komerciale të tjera vazhdojnë të funksionojnë. Duke patur parasysh këto zhvillime, dhe e gjendur përballë presionit të platformave digjitale ekzistuese që kërkonin të mbronin investimet e veta, Strategjia përcaktoi se licensat për rrjetet kombëtare digjitale do të shpërndareshin sipas procedurave ‘beauty contest’, që do të thoshte se në konkurrin do të merrnin pjesë platformat ekzistuese dhe ato media elektronike që konsideroheshin si operatorë me përvojë. Megjithëse në praktikë ka shumë mundësi që operatorët që morën pjesë në procedurat e licensimit ishin të vetmet kompani të interesuara dhe të afta për të operuar këto rrjete, vetë aplikimi i procedurave “beauty contest” e kufizoi që në hyrje konkurrencën e hapur.

Nga ana tjetër, sistemi i shpërndarjes së shtypit ka qenë për një kohë shumë të gjatë hallka më e dobët në zinxhirin e mediave kombëtare. Një studim i vitit 2012 mbi median e shkruar arriti në përfundimin se gazetat shpërndareshin vetëm në kryeqytet dhe qytete të tjera të mëdha, apo krahinat afër Tiranës, ndërsa në zonat rurale, ku jetonte gati gjysma e popullsisë, gazetat nuk arrinin kurrë.¹³⁵ Ndonëse numri i popullsisë rurale mund të jetë zvogëluar që atëherë, ky problem vazhdon edhe sot e kësaj dite dhe nuk ka patur ndonjë përmirësim të ndjeshëm në rrjetin e shpërndarjes së shtypit.

Megjithëse ligji nuk e kufizon në asnjë lloj mënyre funksionimin e rrjeteve të shpërndarjes së shtypit, ky lloj aktiviteti nuk është edhe aq pluralist sa duhet. Ka dy agjenci kryesore që kryejnë pjesën më të madhe të shërbimit të shpërndarjes së shtypit. Që të dyja këto agjenci janë në pronësi të dy gazetave të përditshme, gjë që tregon se ka shumë mundësi për konflikt interesi dhe trajtim të padrejtë të gazetave të tjera. Një prej

¹³³ AMA, Rregullore për licensimin e rrjeteve numerike dhe programeve të tyre, nëpërmjet procedurës së beauty contest, http://ama.gov.al/preview/wp-content/uploads/2015/03/Rregullore_BC.pdf

¹³⁴ Strategjia e Kalimit nga Transmetimi Analog në Digjital, http://ama.gov.al/preview/wp-content/uploads/2015/03/9STRATEGJIA_E_KALIMIT_NGA_TRANSMETIMET_ANALOGE_NE_TRANSMETIMET_NUMERIKE.pdf

¹³⁵ Konsulenca e OSBE-së, “Perspektivat e biznesit të mediave të shkruara në Shqipëri,” nga Vibjorn Madsen, prill 2012.

tyre është në pronësi të grupit mediatik që boton gazetën Panorama, ndërsa tjetra i përket grupit që boton gazetën Shekulli, përkatësisht prona të Irfan Hysenbelliut dhe Koço Kokëdhimës, dy nga pronarët e mediave më të rëndësishme në historinë e shtypit shqiptar.

Kompania e tretë shpërndarëse e shtypit është Posta Shqiptare, por ajo ofron vetëm një pjesë të vogël të këtij shërbimi¹³⁶. Ngaqë agjencia e shpërndarjes e Panoramës ka një rrjet më të madh distribucioni, edhe agjencitë e tjera janë të detyruara të bashkëpunojnë me këtë kompani shpërndarëse, çka i bën ato të varura nga kushtet e diktuar nga agjencia më e madhe. Megjithë përqendrimin e shërbimeve në një pikë të vetme, nuk është njoftuar për ndonjë rast kur gazetave u është mohuar shërbimi i shpërndarjes, por duket se ka patur favorizime në shpërndarjen e gazetës që ka në pronësi kompaninë, ngaqë herë pas here ajo shpërndahet më herët në qytetet e mëdha se sa gazetatat konkurrenente.¹³⁷

¹³⁶ Të dhëna nga Unioni i Gazetarëve Shqiptarë.

¹³⁷ Intervista të thelluara me redaktorë dhe gazetarë.

Liria në Përdorimin e Internetit dhe Aksesin në Mediat e Huaja

Treguesi 17 – Shteti nuk duhet të kufizojë aksesin e qytetarëve në mediat e huaja, si në gazeta apo media elektronike, duke përfshirë edhe internetin.

Qytetarët shqiptarë janë të lirë të përdorin internetin, si dhe të lexojnë apo shohin media të huaja.

Shqipëria ratifikoi në vitin 1999 Konventën Evropiane për Televizionin Ndërkufitar, si dhe protokollet shtesë. Kjo do të thotë se Shqipëria ka për detyrë që të respektojë dhe zbatojë kërkesat dhe normat e përcaktuara me nenin 10 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, duke përfshirë edhe lirinë e marrjes së sinjalit dhe ndjekjen e programeve në Shqipëri që respektojnë parimet e kësaj konvente. Legjislacioni shqiptar mbi median është ndikuar goxha nga nevoja për të harmonizuar bazën ligjore me Direktiva e Bashkimit Evropian për Shërbimet e Mediave Audiovizive, në kuadër të përpjekjeve të Shqipërisë për anëtarësim në BE.

Kushtetura shqiptare garanton me nenin 22 lirinë e shtypit, radios dhe televizionit, ndalon censurën, por nga ana tjetër shton se është normale që operatorët audiovizivë të pajisen më parë me licensë për transmetim. Ligji për shtypin dhe ligji për mediat audiovizive, që janë edhe dy ligjet kryesore për rregullimin e aktivitetit mediatik në vend, nuk bëjnë asnjë dallim midis mediave vendase dhe mediave të huaja. Për më tepër, neni 5 i Ligjit të Mediave Audiovizive siguron dhe mbron lirinë e marrjes dhe të ritransmetimit nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe të shteteve të tjera evropiane, palë të Konventës Evropiane për Televizionin Ndërkufitar. Legjislacioni mbi mediat audiovizive vlen edhe për media të huaja që transmetojnë me satelit apo teknologji të tjera të ngjashme nga Shqipëria, që do të thotë se ato gëzojnë të njëjtin status ligjor pavarësisht origjinës së medias dhe shtetit nga ku operon.

Ligji e lejon kufizimin e transmetimeve të mediave të huaja vetën në rastet e parashikuara nga marrëveshjet ndërkombëtare apo në bazë të dispozitave të ligjit të mediave audiovizive. Për shembull, këtu përfshihet edhe transmetimi i programeve të veçanta, veçanërisht sportive, kur një televizion vendas zotëron të drejtat e transmetimit të ndeshjeve sportive apo programeve të tjera të veçanta. Ligji gjithashtu i jep të drejtën çdo organi mediatik nga vendet e Bashkimit Evropian që të kenë “akses me kushte të barabarta në ngjarje me interes të lartë për publikun, të cilat transmetohen mbi baza ekskluzive nga një ofrues shërbimi mediatik audioviziv nën juridiksionin e Shqipërisë,” dhe po e njëjta gjë vlen edhe për mediat shqiptare. Marrëdhëniet midis mediave të huaja dhe mediave shqiptare në lidhje me raportet e lajmeve të shkurtra bazohen mbi kritere të tjera që rregullohen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe ligji mbi marrëdhëniet tregtare, por sidoqoftë parimi bazë në këto marrëdhënie midis mediave vendase dhe atyre të huaja mbetet gjithnjë trajtimi i barabartë nga ana e autoriteteve.

Në Shqipëri nuk ka patur raste të ndalimit të mediave të huaja apo bllokimit të programeve apo faqeve të internetit me origjinë nga vende të huaja, që nga kalimi në demokraci pas rënies së regjimit komunist në fillim të viteve 90. Gazeta dhe revista të huaja mund të blihen në vend, ndërsa disa radio të huaja kanë marrë autorizimin e entit rregullator që të ritransmetojnë programet e tyre, duke përfshirë këtu edhe BBC. Edhe stacione të huaja televizive mund të shikohen lirshëm me antena të thjeshta në sinjal tokësor apo nga paketa të televizionit kabllor që ofrohen nga disa operatorë. Gjatë këtyre viteve nuk ka pengesa në aksesin në internet apo në çdo lloj platforme të mediave të huaja. Nga ana tjetër, një nga problemet kryesore me mediat shqiptare mbetet përdorimi i shpeshtë i materialeve, pamjeve, dhe lajmeve të marra nga media të huaja pa patur të drejtat e publikimit apo transmetimit të këtyre materialeve mediatike, dhe madje në disa raste nuk përmendet as emri i medias nga është marrë ai material.

Nuk ka patur raste të bllokimit apo ndalimit të faqeve në internet të mediave të huaja. Interneti përdoret gjerësisht në vend. Sipas të dhënave të marra nga Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve¹³⁸ 66 përqind e popullatës është përdoruese e internetit. Sipas Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), që është edhe institucioni shtetëror që rregullon komunikimet elektronike, nga fundi i vitit 2017 rreth dy milionë përdorues interneti në Shqipëri kishin akses broadband në internet¹³⁹. Një studim¹⁴⁰ i kryer në vitin 2017 tregoi se interneti po përdoret gjithmonë e më shumë për të marrë informacion, pasi 44 përqind e të intervistuarve tha se marrin informacion nga agjenci lajmesh në internet, ndërsa 56 përqind përdor rrjetet sociale, por megjithatë televizioni mbetet burimi kryesor i informacionit.

¹³⁸ ITU, "Përqindja e popullatës që përdor internetin," 2016, <https://www.itu.int/en/ITU-D/Statistics/Pages/stat/default.aspx>

¹³⁹ AKEP Të dhënat për tremujorin e katërt të vitit 2017.

¹⁴⁰ IDRA "Pandëshkueshmëria - Perceptime dhe eksperiencia të qytetarëve shqiptarë," 2017.

Parandalimi i Monopoleve dhe Zhvillimi i Pluralizmit

Treguesi 18 – Pronësia mbi organet e medias dhe interesat ekonomike në media duhet të jenë transparente dhe publike. Legjislacioni duhet të zbatohet për të luftuar monopolin në media dhe dominimin e tregut mediatik. Gjithashtu duhen ndërmarrë veprime aktive për të nxitur dhe promovuar pluralizmin në media.

Kur vjen puna tek pluralizmi në media dhe masat që duhen marrë për ta promovuar atë, duhet të bëjmë më parë një dallim midis mediave elektronike dhe shtypit. Ndërkohë që sektori i mediave audiovizive është i rregulluar me ligj, për shtypin nuk ka kufizime në legjislacion, pasi ligji për shtypin thotë vetëm se shtypi është i lirë. Nga ana tjetër mediat në internet po përjetojnë një periudhë buri për sa i përket numrit të tyre. Aktiviteti i këtyre mediave nuk kontrollohet me ligj dhe nuk ato nuk kanë nevojë për licensë aktiviteti. Në momentin kur u aprovua ligji i parë për mediat elektronike në vitin 1998, Ligji për Radion dhe Televizionin, peisazhi mediatik ishte goxha i pasur dhe nuk kishte probleme me përqendrimin e medias në pak duar, megjithëse të gjitha mediat elektronike ishin akoma të palicensuara. Ligji i asaj kohe u mundua të garantonte pluralizmin në media nëpërmjet kufizimit të pronësisë së radiove dhe televizioneve të licensuara.

Sipas këtij ligji, një operator trasmetimi mund të zotëronte vetëm dy licensa lokale për të njëjtin territor, pa pasur nevojë që të krijonte një kompani ose të merrte statusin e personit juridik, përveç rasteve kur licensa lejonte mbulimin e një zone me më shumë se 200,000 banorë. Nga ana tjetër, kufizimi me ligj i pronësisë mbi një radio apo televizion me mbulim kombëtar kërkonte që një person apo kompani të mos zotëronin më shumë se 40 përqind të aksioneve, dhe organi i medias duhet të ishte në pronësi të një shoqërie aksionare. Pronarët e radiove apo televizioneve me mbulim kombëtar nuk u lejohej në asnjë lloj mënyre të kishin aksione në kompani të tjera radio apo televizioni me mbulim kombëtar. Ata ndaloheshin gjithashtu që të zotëronin licensë për transmetime lokale. Ligji nuk bënte ndonjë dallim në lidhje me të drejtën e pronësisë mbi baza kombësie, pasi të njëjtat rregulla aplikohen për të gjithë qytetarët, si shqiptarë ashtu dhe të huaj. (Ligji 8410, neni 20.)

Një qëndrim i ngjashëm u mbajt edhe nga Ligji për Mediat Audiovizive, që zëvendësoi Ligjin për Radion dhe Televizionin në vitin 2013. Kufizimi i pronësisë për jo më shumë se 40 përqind të aksioneve për licensat kombëtare u konfirmua nga ky ligj, por ndërkohë u lejua që i njëjti person të mund të zotëronte edhe 20 përqind të aksioneve në një licensë të dytë për transmetime audiovizive kombëtare. Gjithashtu, po ky person mund të kishte në pronësi edhe 10 përqind të aksioneve në një licensë të tretë kombëtarë. Për sa i përket licensave lokale, një person që zotëronte 100 përqind të aksioneve në një kompani audiovizive me licensë lokale apo rajonale, mund të zotëronte vetëm një tjetër licensë radioje lokale apo rajonale. Nga ana tjetër një person mund të kishte në pronësi dy kompani audio apo audiovizive, me licensë lokale apo rajonale në të njëjtën kohë, por me kusht që të mos zotëronte më shumë se 40 përqind të aksioneve të secilës kompani. Përveç kufizimeve në pronësinë e aksioneve, ligji vendoste edhe kufizime në përqindjen e reklamave në raport me tregun, duke vendosur kufirin e 30 përqind të reklamave në tregun e transmetimeve audiovizive. (Ligji 97/2013, neni 62.)

Ndryshimet më të fundit në legjislacion erdhën pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese që shfuqizoi paragrafin 3 të nenit 62, që u përmend më sipër, duke u përqendruar kryesisht mbi kufizimin e pronësisë mbi licensat kombëtare të transmetimit. Shoqata e Mediave Elektronike i kërkoi Gjykatës Kushtetuese në prill 2016, që të hiqet kufizimin mbi pronësinë e licensave kombëtare duke argumentuar se ky kufizim ishte antikushtetues, pasi cënonte parimin e barazisë përpara ligjit dhe të drejtën e pronës. Në këtë proces u përfshinë edhe dy palë të interesuara: Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), që mbështeti kërkesën e operatorëve privatë; dhe përfaqësuesit e Kuvendit nga ana tjetër, që ishin pozicionuar kundër kësaj kërkesë, me arsyetimin se

kufizimi i pronësisë ishte vendosur në ligj për të mbrojtur lirinë e shprehjes, e cila duhet të ketë përparësi. Ky rast tregoi se argumentet ekonomike dhe kërkesat e kompanive private u vlerësuan më shumë se nevoja për të siguruar pluralizmin në media, dhe vuri në pah pasigurinë në lidhje me vendimet e gjykatave mbi lirinë dhe pluralizmin e medias, si dhe nivelin e ulët të njohurive të gjykatave shqiptare mbi rolin që duhet të luajnë ato si instrumente për mbrojtjen e pluralizmit në media.

Këto ndryshime u paraprinë nga një përpjekje e deputetit socialist Taulant Balla, që kërkoi të eliminonte të gjitha kufizimet mbi pronësinë në organet e medias, me fjalë të tjera të shfuqizonte nenin 62 të Ligjit për Mediat Audiovizive. Pas kundërshtimeve të forta nga institucione ndërkombëtare, duke përfshirë BE, OSBE, dhe Këshillin e Evropës, komisioni parlamentar i medias nuk i miratoi ndryshimet e propozuara në ligj. Megjithatë, një vit më pas kufizimi i pronësisë për licensat kombëtare u hoq me vendimin e përmendur më sipër nga Gjykata Kushtetuese. Me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, nuk ishte më e ndaluar që një person fizik apo juridik të zotëronte më shumë se 40 për qind të aksioneve në një kompani që zotëronte licensë kombëtare radioje apo televizioni. Sondazhi i zhvilluar me redaktorë dhe gazetarë tregoi se 61.7 për qind e të anketuarve mendonte se qeveria nuk e mbështeste pluralizmin në media dhe nuk merrte masa për ta mbështetur atë¹⁴¹.

Ligji nuk i detyron organet e medias që të tregohen transparente mbi pronësinë e tyre, apo entin rregullator që të publikojë pronësinë e aksioneve të mediave. Enti rregullator publikon listën e operatorëve të medias dhe kontaktet e tyre, por nuk jep informacione mbi pronësinë e mediave. Sidoqoftë, buletini i parë i botuar në internet nga AMA përmbante disa informacione mbi prirjet dhe zhvillimet në fushën e pronësisë së mediave audiovizive. Nga ana tjetër, asnjë nga kompanitë e medias nuk ka bërë ndonjë përpjekje për të përmirësuar nivelin e transparencës në lidhje me pronësinë e tyre. Në një sondazh me redaktorë dhe gazetarë nga media të ndryshme, 49.6 për qind e tyre tha se pronësia e mediave ku punonin ata ishte e qartë për publikun, 23.5 për qind e tyre mendonte të kundërtën, ndërsa 26.9 për qind tha se nuk kishte informacione në lidhje me këtë çështje¹⁴². Intervista të thëlluara me redaktorë dhe drejtues të medias treguan se megjithëse nuk ka përpjekje për të përmirësuar transparencën mbi pronësinë, nuk ka as tentativa për ta fshehur pronësinë e mediave, dhe publiku është pak a shumë i informuar se kush ka në pronësi media të caktuara, të paktën për mediat kryesore¹⁴³. I vetmi sektor i medias ku pronësia është krejtësisht e panjohur janë mediat online, dhe portalet e lajmeve, ku përveç disa organeve kryesore ku dihet se cilët janë pronarët, nuk ka mundësi të merret vesh se cilët janë pronarët apo aksionerët kryesorë të pjesës më të madhe të këtyre portaleve.

Nga ana tjetër, të gjitha kompanitë, duke përfshirë edhe mediat audiovizive, duhet të regjistrohen tek Qendra Kombëtare e Biznesit dhe të dhënat e këtyre kompanive mund të gjenden online, pa pagesë. Baza e të dhënave kërkohet me lehtësi nëpërmjet disa fjalëve kyçe, si emri i kompanisë, emri i aksionerit, NIPT-in e subjektit tregtar, adresën, etj. Kjo bazë të dhënash jep informacion mbi ekstraktet e biznesit të secilës kompani apo individ të regjistruar në QKB, që bëjnë të mundur një analizë të pronësisë të kompanive të caktuara. Gjithashtu QKB-ja krijon mundësinë e shqyrtimit të dokumenteve që janë dorëzuar nga subjektet e biznesit, si kontratat e kalimit të pasurisë, lista e takimeve të këshillave drejtues, vendime mbi çështje të caktuara, etj. Gjatë viteve të fundit kompanitë janë të detyruara që të dorëzojnë raporte vjetore financiare, dhe këto më pas publikohen në internet. Të gjitha këto masa kanë përmirësuar ndjeshëm aksesin në informacionin mbi pronësisë, ndryshimet në pronësinë e kompanive, si dhe disa të dhënave mbi gjendjen e tyre financiare, megjithëse nuk ka akoma një regjistër të dedikuar për organet e medias.

Legjislacioni shqiptar nuk është marrë kurrë në mënyrë aktive me çështjen e promovimit të pluralizmit në media nëpërmjet marrjes së hapave apo masave konkrete. Ligji vetëm sa e përmend shkurtimisht nevojën për

¹⁴¹ Të dhëna nga sondazhi i kryer për qëllimin e këtij studimi.

¹⁴² Të dhënat e sondazhit të zhvilluar për këtë studim.

¹⁴³ Të dhëna të mbledhura nga intervista të thëlluara me redaktorë dhe drejtues të mediave kryesore.

të siguruar pluralizmin dhe garanton respektimin e këtij parimi në lidhje me gjuhën, minoritetet kombëtare, pozitën sociale, racën, etj. Sidoqoftë, legjislacioni nuk parashikon ndonjë masë konkrete në këtë drejtim, si subvencione apo ndihmë ekonomike për media të veçanta në shërbim të minoriteteve apo interesit publik. Shteti ka mbajtur në masë të madhe të njëjtin qëndrim gjatë 27 viteve të fundit, kur ndihma ekonomike për mediat nuk është aplikuar thuajse fare, as në ligje dhe as në vendime ekzekutive. I vetmi përjashtim që mund të përmendet këtu është lëshimi i licensave për radio komuniteti, që janë subjekte jo fitimprurëse dhe përjashtohen nga pagesa e tarifës së licensës. Sidoqoftë, kjo nuk ka shumë lidhje me pluralizmin në media, por bëhet për të lehtësuar punën dhe për të reduktuar shpenzimet për aktivitete jo fitimprurëse të komuniteteve. Aktualisht ka katër radio komuniteti të licensuara nga enti rregullator¹⁴⁴.

Pluralizmi në media

Ka patur disa studime mbi prirjet dhe ndryshimet në strukturat e pronësisë mbi median në vend dhe dinamikën e këtij procesi në vite, duke u përqendruar kryesisht mbi pronarët e mediave më të mëdha dhe bizneseve të tjera të tyre, duke u munduar që të analizojnë lidhjen e strukturës së pronësisë me përmbajtjen e prodhuar në media. Një studim i vitit 2016 që u publikua nga enti rregullator AMA zbuloi se 62 për qind e televizioneve ishin në pronësi të një aksioneri të vetëm, ndërsa 76 për qind e tyre kanë një aksioner që zotëronte më shumë se 50 për qind të aksioneve të kompanisë¹⁴⁵. Në rastet kur kompania ishte në pronësi të një grupi personash, në 69 për qind të televizioneve grupe të tilla zotëronte 100 për qind të aksioneve, ndërsa në 84 për qind të këtyre rasteve një nga partnerët zotëronte më shumë se 50 për qind të aksioneve. Përqindje të ngjashme kontrolli hasen edhe në strukturën e pronësisë së stacioneve të radios¹⁴⁶.

Numri i organeve të medias në vend është relativisht i lartë në krahasim me numrin e vogël të popullsisë dhe masën e tregut. Aktualisht ka 56 stacione televizive lokale, pesë licensa kombëtare të lëshuara për rrjete digjitale, dy licensa për stacione radio kombëtare, 51 stacione radios lokale, dhe katër radio komuniteti që përfaqësojnë komunitetet fetare më të mëdha në vend¹⁴⁷. Përveç këtyre ka edhe 98 kompani televizive kabllorë¹⁴⁸, dhe 13 subjekte të autorizuara për ofrim shërbimi kabllor apo platforma në internet të licensuara nga AMA¹⁴⁹. Televizioni publik aktualisht transmeton në tetë kanale të rrjetit të tij digjital, ndërsa radioja publike transmeton në pesë programe. Radio televizioni publik gjithashtu transmeton edhe nga katër studio rajonale në qytete të tjera. Nga ana tjetër numri i saktë i mediave të shkruara është i pamundur të gjendet pasi ato nuk kanë nevojë të regjistrohen, dhe asnjë institucion apo organizatë, përfshi këtu edhe Bibliotekën Kombëtare, nuk ka një numër të saktë të listës së botimeve. Ka rreth 19 gazeta të përditshme, duke përfshirë edhe gazetatat sportive. Situata bëhet akoma më e mistershme për sa i përket mediave në internet, si pasojë e mungesës totale të detyrimit për regjistrim pranë ndonjë autoriteti apo institucioni. Unioni i Gazetarëve Shqiptarë thotë se numri i portaleve të lajmeve online ka arritur në 650¹⁵⁰.

Megjithëse numri i mediave në Shqipëri është impresionues, sasia nuk do të thotë domosdoshmërisht se pluralizmi është i garantuar. Në fakt, ekspertët e medias mendojnë se vendimi i Gjykatës Kushtetuese për të shfuqizuar kufizimin e pronësisë të licensave kombëtare i ka hapur rrugën monopolizimit ose të paktën

¹⁴⁴ AMA, Lista e operatorëve të radios, <http://ama.gov.al/preview/mediat/radio/>

¹⁴⁵ AMA, Buletini periodik I.

¹⁴⁶ Stacionet e radios në pronësi të një aksioneri të vetëm: 60 për qind janë në pronësi të një aksioneri të vetëm, ndërsa 73 për qind e tyre kanë një aksioner me më shumë se 50 për qind të aksioneve. Për pronësinë në grupe, në 63 për qind të stacioneve të radios grupi zotëron 100 për qind të aksioneve, ndërsa në 78 për qind të tyre një aksioner ka në pronësi më shumë se 50 për qind të aksioneve.

¹⁴⁷ AMA, Lista e operatorëve të radios, <http://ama.gov.al/preview/mediat/radio/>

¹⁴⁸ AMA, Lista e operatorëve kabllorë, <http://ama.gov.al/preview/category/subjekte-te-autorizuar-per-perseritjen-e-programit-audioviziv/>

¹⁴⁹ AMA, Lista e ofruesve të shërbimit, <http://ama.gov.al/preview/category/subjekte-te-autorizuar-per-ofrimin-e-sherbimit-te-programit-audioviziv/>

¹⁵⁰ Të dhëna nga Unioni i Gazetarëve Shqiptarë.

përqendrimin të tregut mediatik në pak duar. Në situatën aktuale katër nga pesë licensat për rrjete digjitale kombëtare janë në pronësi të dy grupeve kryesore në sektorin e mediave private, gjë që shkakton shqetësime për të ardhmen e pluralizmit në fushën e medias. Një redaktor tha gjatë një interviste se “digjitalizimi ka sjellë përqendrim të medias në pak duar, të paktën për sa i përket platformave digjitale me abonim, përfshi Digitalbin dhe Supersportin, dhe po të llogarisim këtu edhe Top Channel dhe TV Klan [që kanë nga një licensë rrjeti digjital tokësor], këta operatorë zënë një përqindje të madhe të tregut, që i bie të drejtohet praktikisht nga dy-tre persona, dhe për pasojë nuk mund të themi se kemi konkurrencë të hapur në treg, apo pluralizëm.”¹⁵¹ Disa punonjës të tjerë të medias të intervistuar për këtë studim dolën gjithashtu me mendimin se monopoli në tregun e medias është tashmë fakt i kryer. Nga ana tjetër, një grup redaktorësh dhe drejtues mediash thanë se nuk ishin edhe aq të shqetësuar në lidhje me përqendrimin e medias në pak duar, duke pretenduar se kufizimet e mëparshme të pronësisë nuk ishin respektuar në realitet, dhe se këto kushte vetëm sa kishin çuar në daljen e aksionerëve fiktivë dhe familjeve që ndaheshin me gjyq vetëm për të mbajtur një numër sa më të madh aksionesh, duke dështuar që të krijojnë një situatë të shëndetshme në media¹⁵². Një grup tjetër të intervistuarish e pranuan faktin se ka një përqendrim të pronësisë të mediave në një numër të vogël personash, por ngulën këmbë se pluralizmi nuk rrezikohet, pasi praktika ka treguar se kushdo që dëshiron të hapë një media mund ta bëjë lirshëm një gjë të tillë¹⁵³. Kryetari i AMA-s iu përmbajt këtij opinioni, dhe tha se kushdo që dëshironte të merrte një licensë dhe i përmbushte kushtet, e kishte marrë atë, dhe shtoi se pronësia nuk është e vetmja rrugë për të siguruar pluralizmin, por edhe kontrollat mbi të ardhurat nga reklamat, përqindjen e kontrollit në treg, etj., janë vetëm disa nga metodat dhe kriteret që mund të sigurojnë pluralizmin në media¹⁵⁴.

Në fakt, mungesa e të dhënave të besueshme mbi dinamikën e tregut e bën diskutimin shumë të vështirë, megjithëse duket qartë se shfuqizimi i kufizimit të pronësisë është një hap prapa për sa i përket sigurimit të pluralizmit në media. Pas 27 vitesh të liberalizimit të tregut të medias, nuk ka patur ndonjë zhvillim të madh në sigurimin dhe publikimin e të dhënave sistematike dhe të besueshme mbi tregun e medias dhe financat e organeve të medias. Ka dy kompani të mëdha që zhvillojnë studime tregu dhe sondazhe me publikun, por duke parë se rezultatet e tyre ndryshojnë shumë nga njëri-tjetri, metodologjia dhe rezultatet e tyre janë vënë shpesh në pikëpyetje. Në të njëjtën kohë, numri i kopjeve të gazetave të shitura dhe të ardhurat nga reklamat nuk raportohen tek autoritetet tatimore, dhe e njëjta gjë mund të thuhet edhe për mediat online, për të cilat nuk dihet sa përdorues apo vizitorë kanë.

Në vitin 2018, një studim i Reporterëve pa Kufij dhe BIRN Shqipëri tregoi se ka një përqendrim të madh të pronësisë mbi organet e mediave. Sipas të dhënave nga një agjenci e matjes së audiencës, arrihet në përfundimin se kemi të bëjmë me një përqendrim mesatar në tregun televiziv ku katër pronarë të mëdhenj arrijnë 48.93 për qind të publikut. Nga ana tjetër, të dhënat e kompanisë së dytë të audiencës tregojnë për një përqendrim më të madh të tregut në duart e këtyre katër pronarëve që mbulojnë 58.60 për qind të publikut¹⁵⁵. Edhe llogaritë e kryera në lidhje me përqendrimin në tregun e radios dhe gazetave tregojnë një prirje të ngjashme: kemi përqendrim të lartë me 63.96 për qind të publikut për katër pronarë të stacioneve të radios, dhe 43.29 për qind për katër pronarë gazetash¹⁵⁶. Nga ana tjetër matja e përqendrimin në bazë të përqindjes së publikut që ndjek këto media paraqet shifra akoma më alarmante: dy familjet kryesore që kanë në pronësi stacione televizive zotërojnë kontrollojnë më shumë se 70 për qind të tregut televiziv, ndërsa katër pronarët që u përmendën më sipër zënë 89,6 për qind të tregut¹⁵⁷.

¹⁵¹ Intervista të thelluara me redaktorë dhe drejtues të mediave kryesore.

¹⁵² Po aty.

¹⁵³ Po aty.

¹⁵⁴ Intervistë me Gentian Salën, Kryetar i Autoritetit të Mediave Audiovizive.

¹⁵⁵ Monitorimi i pronësisë mbi median në Shqipëri, 2018, <https://albania.mom-rsf.org/en/findings/findings/#!9fed61067e34232006ff7dcd0ed479d0>

¹⁵⁶ Po aty.

¹⁵⁷ Po aty.

Shpërndarja e Drejtë e Fondeve Shtetërore

Treguesi 19 – Nëse mediat marrin subvencione nga qeveria në mënyrë direkte apo indirekte, shteti duhet t'i trajtojë këto media në mënyrë neutrale dhe të ndershme.

Kur flasim për subvencione shtetërore për median, më këtë term i referohemi gati gjithmonë shpenzimit të fondeve publike për reklama shtetërore, fushata publicitare, apo aktivitete publike, si nga organizma shtetërore ashtu edhe nga institucione publike. Megjithëse si pronarët e mediave kryesore ashtu edhe ata të publikimeve të specializuara, përfshi këtu edhe mediat e minoriteteve, i kanë bërë herë pas here thirrje qeverisë për t'i mbështetur financiarisht, legjislacioni shqiptar nuk ka parashikuar kurrë mundësinë e subvencioneve të drejtpërdrejta shtetërore për median. Në këtë aspekt, burimi kryesor i financimit shtetëror për median janë fondet që jepen për publikimin e reklamave apo njoftimeve shtetërore, apo financime për evenimente publike apo fushata publicitare.

Nuk ka të dhëna të sakta mbi tregun e reklamave në vend dhe përqindjen që zënë financimet shtetërore në fondin e përgjithshëm të reklamave. Përqindja që zë reklama shtetërore në tregun shqiptar mendohet të jetë më e ulët në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Sipas një raporti monitorimi¹⁵⁸ të tregut të reklamave për vitin 2017, asnjë nga institucionet shtetërore nuk u rendit në listën e 10 reklamuesve më të mëdhenj në tregun e medias, në një listë që dominohej nga kompanitë e telefonisë, të ndjekura nga bankat. I vetmi përjashtim këtu, ishte Ministria e Drejtësisë, që u rendit në vendin e dhjetë për reklamat që kishte bërë në mediat në internet.

Pavarësisht mungesës së të dhënave mbi sasinë e fondeve të shpenzuara nga shteti për reklama, studimet kanë treguar se praktikrat e përdorura për shpërndarjen e reklamave shtetërore nuk janë gjithmonë të drejta, transparente, dhe jo-diskriminuese. Kjo situatë mundësohet edhe nga dispozita të paqarta ligjore mbi shpërndarjen e reklamave shtetërore, që përkeqësohet edhe nga mungesa e të dhënave të besueshme mbi audiencën apo numrin e lexuesve. Me konkretisht, shpenzimet për reklama nuk rregullohen me legjislacionin për prokurimet publike. Ligji për Prokurimet rendit një sërë kategorish që përjashtohen nga ky ligj, duke përfshirë “blerjen, zhvillimin, prodhimin, bashkëprodhimin e programeve ose të reklamave për transmetimin nga operatorët radiotelevizivë ose botimin në median e shkruar dhe për kontratat për kohë transmetimi.”¹⁵⁹

Si rezultat, të vetmet akte që meren me reklamat shtetërore janë vendimet e Këshillit të Ministrave. Një vendim i Këshillit të Ministrave në vitin 2007 lidhur me reklamat shtetërore përmendte numrin e shikuesve apo të lexuesve si një nga kriteret që duhej patur parasysh për marrjen e vendimit të publikimit.¹⁶⁰ Ky kriter ishte i vështirë për t'u ndjekur për sa kohë që mungonin të dhënat mbi publikun dhe mediat, por të paktën ajo ishte një tentativë për të vendosur disa filtra seleksionimi. Dy vendime të mëvonshme të Këshillit të Ministrave kanë përdorur terma dhe kriterë shumë më të gjera dhe të paqarta, duke përfshirë terma si “organ mediatik” (pa ndonjë sqarim tjetër), ofertën që bëhet, kohën që do të zgjasë në transmetim,¹⁶¹ si dhe eksperiencën në organizimin e aktiviteteve të ngjashme.¹⁶² Këto dy vendime nuk e përmendin fare kriterin e popullaritetit të organit të medias, megjithëse ajo është zakonisht një nga kriteret bazë.

¹⁵⁸ Revista Monitor, <http://www.monitor.al/cilet-jane-reklamuesit-te-medhenj-ne-vend-si-po-ulin-buxhetet-qe-cojne-ne-media/>

¹⁵⁹ Republica, “Përdorimi i fondeve publike për reklama dhe forma të tjera publiciteti,” 2015.

¹⁶⁰ VKM Nr. 6223, “Mbi prokurimet e prodhimit/transmetimit të reklamave dhe spoteve nga organet e administratës shtetërore në media,” 29 shtator 2007.

¹⁶¹ VKM Nr. 1195, 5 gusht 2008.

¹⁶² VKM Nr. 1173, 6 nëntor 2009

Në fakt megjithëse vendimi i fundit “tregoi disa përmirësime nga ana teknike, në thelb ai ka bërë disa hapa prapa, duke i liruar rrugë abuzimeve dhe eliminimit të transparencës.”¹⁶³ Sipas një analize ligjore të rregulloreve aktuale mbi shpërndarjen e reklamave shtetërore, ka disa rregulla që e kanë bërë më të lehtë për autoritetet shtetërore që të shpërndajnë reklamën në një mënyrë më pak transparente dhe më selektive. Për shembull, përveç organeve të medias, në listën e marrësve të reklamave shtetërore është futur edhe një kategori e re: “agjencitë e specializuara,” që i lejon edhe agjencitë e reklamave të përfitojnë nga reklamën shtetërore, duke krijuar mundësinë që këto fonde të rishpërndahen në organet e medias pa ndonjë transparencë publike apo kritere teknike. “Praktikisht kjo ka bërë që një pjesë e mirë e fondeve të shkojnë tek agjencitë, që më pas i përdoren fondet publike duke nënkontraktuar kompani private të medias që duan vetë, në mënyrë selektive dhe aspak transparente.”¹⁶⁴

Një problem tjetër me vendimin aktual që rregullon reklamën shtetërore është edhe përbërja e komisioneve që vlerësojnë ofertat e çdo tenderi publik në organizmat shtetërore. Nuk është më e detyrueshme pjesëmarrja në këto komisione e shefave të drejtorive ligjore dhe ekonomike të institucioneve përkatëse, duke i lejuar kështu drejtuesit e organizmave shtetërore që të shmangin dy nga zyrtarët më të rëndësishëm të institucionit, që zakonisht gëzojnë statusin e punonjësit civil, që do të thotë se ata mendohet të jenë të pavarur dhe nuk preken nga rotacioni i pushtetit apo lëvizja e zyrtarëve me emërimet partiake¹⁶⁵.

Një problem i madh mbetet edhe transparenca në procesin e shpërndarjes së reklamave shtetërore. Rregulloret aktuale jo vetëm që nuk e kanë zgjidhur këtë problem, por kanë hequr madje edhe disa nga kushtet dhe kërkesat që duhet të siguronin këtë transparencë. Më konkretisht, është hequr detyrimi për të publikuar në internet ofertat e kandidatëve, së bashku me praktikën e publikimit në internet të dosjes së tenderit nga Agjencia e Prokurimeve Publike. “Ky ndryshim e ka ulur ndjeshëm transparencën e procedurave, gjë që çon në mungesën e informimit publik në lidhje me përdorimin e fondeve publike nga reklamën shtetërore.”¹⁶⁶ Kjo krijon më shumë hapësira për shpërndarjen selektive të reklamave shtetërore. Në fakt, përgjatë viteve “organet e medias janë ankuar se ftesat i janë dërguar vetëm disa mediave të veçanta dhe nuk botohen në faqen e internetit, apo janë publikuar vetëm një ditë përpara afatit të fundit.”¹⁶⁷

Me ndërrimin e pushtetit në vitin 2013 qeveria aktuale e drejtuar nga Partia Socialiste përfshiu ndërmjet objektivave të saj edhe eliminimin e praktikave që çonin në shpërndarje të padrejtë dhe jo-transparente të reklamave shtetërore në media. Sidoqoftë, edhe gjatë mandatit të saj të dytë në pushtet, qeveria nuk ka bërë akoma ndonjë përpjekje për të ndryshuar rregullat aktuale për dhënien e reklamave shtetërore, apo të miratojë legjislacion të ri; dhe ndërkohë fondet publike për reklama shtetërore po shpërndahen duke përdorur të njëjtat rregulla si më parë. Një studim i vitit 2014 e konfirmoi më tej prirjen për të favorizuar disa media të veçanta në kurriz të të tjerave¹⁶⁸.

Ndërkohë, fondet publike për median nuk kalojnë vetëm nëpërmjet reklamave, por edhe në forma të tjera. Në vitin 2009, qeveria doli me një vendim të ri në lidhje me reklamën qeveritare në media, që përfshinte edhe dhënien e fondeve shtetërore për organizimin e fushatave dhe aktiviteteve publike. Kjo është kthyer në një metodë të volitshme për mediat për të thithur fonde publike, mjafton që të krijojnë kompani për organizimin e aktiviteteve dhe fushatave publike. Kështu, po të marrim parasysh shkrimin investigativ të viti 2013 mbi shpërndarjen e fondeve publike drejt kompanive të lidhura me Aleksandër Frangajn, vihet re qartë se këto

¹⁶³ D. Matlija për Këshillin e Evropës, Tiranë, “Prokurimet publike të reklamave dhe fushatave publicitare në Shqipëri, praktikatat Evropiane,” 2014.

¹⁶⁴ Po aty.

¹⁶⁵ Po aty.

¹⁶⁶ Po aty.

¹⁶⁷ Instituti për Paqen (Peace Institute), “Çështje të integritetit të medias” (Media Integrity Matters) Kapitulli për Shqipërinë.

¹⁶⁸ ISHM, Reklamën shtetërore dhe private në median shqiptare, 2014.

kompani mediatike kanë marrë vetëm një përqindje të vogël nga totali i fondeve për të gjitha kompanitë partnere: 55,800 euro nga shuma totale 780,000 euro të dhëna për të gjitha kompanitë nën pronësinë apo kontrollin e Frangaj, që do të thotë se shumica e fondeve nuk u ndanë si reklamë, por për aktivitete të tjera.¹⁶⁹ Aludime të ngjashme janë bërë edhe për kompani të tjera¹⁷⁰, si kompanitë pranë Carlo Bollino, kompania EAG nën pronësinë e vëllait të ish-Ministrit të Punëve Sociale, apo përdorimin e fondacioneve apo institucioneve për të transferuar fonde për reklama apo fonde të tjera shtetërore.

Një tjetër burim shqetësimi në lidhje me marrëdhëniet klienteliste midis medias dhe mbështetësve të saj financiarë ka të bëjë kryesisht me reklamat që jepen nga bashkitë për mediat nëpër rrethe. Ky është një problem akoma më shqetësues duke patur parasysh varfërinë e tregut të reklamave për mediat lokale. Një sondazh i kryer në vitin 2014¹⁷¹ tregoi se pusheti lokal preferonte të kishte një marrëdhënie thujse ekskluzive me një organ mediatik për të lëshuar të gjithë fondin e reklamave. “Të dhëna nga thesari i shtetit tregojnë se në shumicën e rasteve fondet për reklama shpenzohen vetëm tek një stacion televiziv apo radio, edhe në rastet kur ka më shumë se pesë organe mediatike në atë rreth.”¹⁷² Mbështetja financiare për mediat lokale mund të vijë nga publikimi i reklamave apo njoftimeve nga bashkitë apo institucione të tjera shtetërore, dhe ndonjëherë edhe në formën e abonimeve¹⁷³. Kjo prirje konfirmohet nga palët e interesuara në këtë proces që thonë se “lidhjet politike dhe marrëdhëniet e mira më kryetarin e bashkisë apo zyrtarë të tjerë të pushtetit lokal janë faktorë kyç për marrjen e këtyre fondeve.”¹⁷⁴

Së fundmi, rregullat aktuale mbi shpërndarjen e reklamave i lejojnë agjencitë publicitare që të thithin fonde publike, ashtu siç e përmendëm më sipër në këtë raport. Kjo nuk vlen vetëm për reklamat, por edhe për organizimin e panairëve, fushatave të ndërgjegjësimit publik, dhe aktiviteteve promovionale për qeverinë. Sidoqoftë, në shumicën e rasteve këto aktivitete varen shumë nga mbështetja mediatike për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe në këtë aspekt duhet të konsiderohen si pjesë e marrëdhënieve financiare shtet-media. Gjithashtu ka pasur aludime të vazhdueshme për trajtim preferencial të agjencive të reklamave sipas lidhjeve të tyre politike¹⁷⁵. Nga ana tjetër, si pasojë e mungesës së transparencës nga agjencitë publicitare mbi kriteret e kalimit të fondeve drejt organeve të medias, është e vështirë që të krijojmë një ide më të qartë dhe më të saktë në këtë drejtim.

¹⁶⁹ Likmeta, “Reklamuesit e mëdhenj shkatërrojnë lirinë e medias në Shqipëri,” *Balkan Insight*, 20 dhjetor 2013. Mund të lexohet në: <http://www.balkaninsight.com/en/article/big-advertisers-subvert-albanian-media-freedom>.

¹⁷⁰ Londo, I, “Fuqizimi i praktikave klienteliste në media,” 2016.

¹⁷¹ ISHM, Reklamat shtetërore dhe private në median shqiptare, 2014.

¹⁷² Po aty.

¹⁷³ Rasti më i dukshëm në këtë drejtim është Gazeta Korça, e përjavshme, që nëpërmjet abonimeve të institucioneve publike në rrethin e Korçës përfitoi 914 Euro në vitin 2015; 2,932 Euro për vitin 2014, dhe 4,643 Euro për vitin 2012-2013.

¹⁷⁴ Intervistë me Shkëlqim Bylykbashin, kryetari i Klubit Shqiptar të Medias, janar 2015, cituar nga: Observatori i Medias në Evropën Juglindore, Raportim Flash mbi Mediat Lokale, Shqipëri, 2015

¹⁷⁵ Londo, I, “Fuqizimi i praktikave klienteliste në media,” 2016.

Pavarësia e Transmetuesit Publik

Treguesi 20 –Radio televizioni publik duhet të jetë i mbrojtur nga ndërhyrjet politike gjatë punës së përditshme dhe politikës editoriale. Postet drejtuese nuk duhet t’u jepen personave që kanë lidhje me politikën.

Aprovimi i Ligjit për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në vitin 1998 shënoi edhe transformimin zyrtar të RTSH-së nga institucion shtetëror në radio televizion publik. Që nga ai moment RTSH-ja është munduar që të shkëputet nga influenca e qeverisë dhe të përmirësojë reputacionin që ka në publik për objektivitet, si dhe të përmirësojë cilësinë e programeve. Fuqizimi i radiove dhe televizioneve private si dhe lënia deri diku pas dore e RTSH-së nga politika e ka penguar përmirësimin e imazhit dhe statusit të RTSH-së.

Përveç disa kritereve dhe kërkesave të vakëta në ligj dhe në statutin e RTSH-së nuk ka instrumente të tjera që të kontrollojnë pavarësinë e RTSH-së. Enti rregullator AMA firmos dhe monitoron kontratën e shërbimit publik të RTSH-së, por kjo nuk do të thotë gjë në lidhje me pavarësinë e radio televizionit publik.

Mbrojtja e radio televizionit publik nga ndërhyrja ekonomike dhe politike e faktorëve të jashtëm garantohej nëpërmjet pavarësisë financiare, administrimit të pavarur, dhe sigurimit të një politike të pavarur editoriale.

Pavarësia financiare

Ligji për Mediat Audiovizive rendit një sërë burimesh financiare për radio televizionin publik, që duhet të siguronin pavarësinë financiare nga buxheti i shtetit, duke përfshirë taksën e televizorit, reklamën, si dhe burime të tjera financiare si kontrata me palë të treta, shitje e programeve, emisioneve dhe spektakle publike, reklamave, sponsorizimeve dhe donacioneve, si dhe fonde nga buxheti i shtetit.¹⁷⁶ Megjithatë, stabiliteti financiar i radio televizionit publik është një objektiv që nuk është arritur akoma, ndërkohë që edhe kalimi në sistemin digjital po e vë RTSH-në në vështirësi akoma më të mëdha financiare.

Ligji për mediat audiovizive nuk e detyron radio televizionin publik të publikojë online të dhëna financiare apo raporte vjetore, por nga ana tjetër ligji mbi të drejtën e informimit i udhëzon të gjitha institucionet publike që të hedhin sa më shumë nga të dhënat e tyre financiare në internet. Statuti i RTSH-së gjithashtu e detyron këtë institucion që të përmirësojë transparencën duke publikuar raporte vjetore online. Publikimet online në faqen e RTSH-së përfshijnë raportet vjetore për vitet 2014 dhe 2015, kryesisht për pjesën financiare, por mungojnë të dhënat për vitin 2016¹⁷⁷.

Gjatë tre viteve të fundit buxheti i RTSH-së ka qenë pak a shumë i qëndrueshëm. Buxheti i shtetit duhet të financojë: shërbimin e transmetimeve audio për shqiptarët jashtë kufijve të Shqipërisë, shërbimin e transmetimeve radio në gjuhë të huaja, orkestrën simfonike të RTSH-së, projekte investimi për futjen e teknologjive të reja për prodhim dhe transmetim; projekte prodhimi filmik.¹⁷⁸ Sasia e fondeve që kalon nga buxheti i shtetit vendoset vit pas viti nga miratimi i buxhetit vjetor. Për 2017 shuma e mbledhur nga pagesa e taksës së televizorit plotësoi 52 përqind të buxhetit total të RTSH-së, ndërsa 38 përqind erdhi nga buxheti i shtetit, duke shënuar përqindjen më të lartë të fondeve me origjinë nga buxheti i shtetit gjatë këtyre viteve të fundit¹⁷⁹. Kjo rritje në përqindje nga buxheti i shtetit ka shkuar kryesisht për të paguar shpenzimet e

¹⁷⁶ Ligji Nr. 97/2013, neni 113.

¹⁷⁷ Faqja e RTSH në internet, <https://www.rtsh.al/raporti-vjetor-ekonomiko-financiar/>

¹⁷⁸ Ligji nr. 97/2013, neni 116.

¹⁷⁹ Intervistë me Thoma Gëllçin, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së.

orkestrës, investime në teknologji dhe pagesat për kontratën e mirëmbajtjes për rrjetin digjital të ndërtuar nga RTSH-ja¹⁸⁰. Në vitet e kaluara përqindja e fondeve nga buxheti i shtetit për RTSH-në kanë qenë më të ulëta: në vitin 2014 ishte 15 përqind; 14 përqind në 2015, dhe 21 përqind për vitin 2016¹⁸¹. Situata financiare e RTSH-së duket më pak e sigurtë për këtë vit, pasi megjithëse RTSH-ja ka kërkuar financim për projekte të caktuara, buxheti i shtetit duket se nuk i ka përfshirë këto kërkesa në fondet e planifikurara për këtë vit.¹⁸²

Pjesa më e madhe e financimit të RTSH-së vjen nga taksa e televizorit që paguhet nëpërmjet faturës së dritave. Falë përmirësimit të pagesave të elektricitetit nga popullata edhe situata financiare e RTSH-së është përmirësuar ndjeshëm. Për vitin 2016, plani i mbledhjes së taksës së televizorit u realizua me 106 përqind¹⁸³. Sidoqftë kjo taksë mbetet akoma më e ulëta në Evropë, me 1,200 lekë në vit për familje, dhe e parafundit në listën e shteteve anëtare të Unionit të Transmetuesve Evropianë, duke lënë pas vetëm Algjerinë¹⁸⁴. Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së e shikon rritjen e taksës së televizorit si të vetmen rrugë për të siguruar pavarësinë e RTSH-së nga buxheti i shtetit dhe përmirësimin e situatës financiare, si dhe garantimin e pavarësisë editoriale¹⁸⁵. RTSH-ja ka hartuar një strategji pesë vjeçare që ka për qëllim ta bëjë radio televizionin publik tërësisht të pavarur nga buxheti i shtetit në pesë vjet¹⁸⁶. Drejtuesit e RTSH-së mendojnë se do të jetë e vështirë për ta arritur këtë objektiv nëse diferenca e fondeve nga buxheti i shtetit nuk do të kompensohet nga rritja e taksës së televizorit. Sidoqftë, RTSH-ja ka hezitur të kërkojë rritjen e taksës, pasi kjo do të rriste ngarkesën e taksave mbi shqiptarët, dhe do të rriste rezistencën e popullatës, një pjesë e të cilës është që tani e pakënaqur nga pagesa e taksës ekzistuese, pasi thonë se nuk e shohin fare RTSH-në¹⁸⁷. Nga ana tjetër drejtori i RTSH-së paralajmëron se edhe pse qeveria nuk ka ndërhyrë në pavarësinë editoriale deri më sot, nëse varësia e RTSH-së nga buxheti i shtetit vazhdon apo edhe rritet, teorikisht mund të kemi një radio televizion publik që ndikohet më shumë nga influenca e qeverisë¹⁸⁸.

Kalimi në trasmetimin digjital në Shqipëri është në zbatim e sipër dhe Strategjia e Kalimit në Teknologji Digjitale i ka caktuar radio televizionin publik detyrën që të ndërtojë dy platforma digjitale kombëtare, një pjesë e së cilës do të shërbejë për radio televizionet private. Sidoqftë, duke se llogaritjet financiare të Strategjisë kanë qenë tepër optimiste asokohe, dhe kanë harruar të përfshijnë një sërë shpenzimesh në kontratën me kompaninë gjermane që do të ndërtonte rrjetin, si dhe nuk parashikuan për rritje buxheti që do shkonte për prodhimin e programeve dhe materialeve të reja që duhen për të mbushur kanalet e reja tematike të platformës së re të RTSH-së¹⁸⁹. Më konkretisht, procesi i ndërtimit dhe mirëmbajtjes të rrjetit nxorri në pah faktin se ka edhe kosto shtesë që nuk ishin parashikuar nga kontrata fillestare, si kontrata e mirëmbajtjes së rrjetit që llogaritet të shkojë deri në 2.2 milionë Euro shtesë për vit deri në 2020, që duhen të paguhet nga RTSH-ja. Buxheti i shtetit ka premtuar se do të paguajë 1.5 milionë Euro për vit në mbulimin e këtyre kostove, por RTSH-ja duhet të kontribuojë me pjesën që mbetet¹⁹⁰. Një tjetër problem kontraktual me firmën gjermane Rohde & Schwarz ka të bëjë me pajisjet konvertuese, që duket se duhet të paguhet nga RTSH-ja, duke i shtuar kështu edhe 1.6 milionë Euro shumës totale¹⁹¹. Për më tepër, Strategjia parashikonte që pagesat e operatorëve vendas për përdorimin e rrjetit të ndërtuar nga RTSH-ja do të ndihmonin radio

¹⁸⁰ Po aty.

¹⁸¹ Raportet vjetore të RTSH-së 2014, 2015, 2016.

¹⁸² Intervistë me Thoma Gëllçin, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së.

¹⁸³ Raporti vjetor i RTSH-së 2016.

¹⁸⁴ D. Pavli, "RTSH në epokën digjitale," OSBE, 2017.

¹⁸⁵ Intervistë me Thoma Gëllçin, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së.

¹⁸⁶ Po aty.

¹⁸⁷ Intervistë me Thoma Gëllçin, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së.

¹⁸⁸ Po aty.

¹⁸⁹ D. Pavli, "RTSH në epokën digjitale," OSBE, 2017.

¹⁹⁰ Po aty.

¹⁹¹ Po aty.

televizionin publik që të mbulonte një pjesë të kostove për mirëmbajtjen e rrjetit. Sidoqoftë, pas ankesave nga stacionet private dhe insistimit të AMA-s për të caktuar një tarifë të përballueshme nga këta operatorë, pagesa u reduktua ndjeshëm, duke lënë edhe një gropë tjetër që duhet mbushur nga RTSH-ja për kostot e digjitalizimit¹⁹². Së fundmi edhe vonesat në procesin e digjitalizimit sollën një tejzgjatje të periudhës kur duhej trasmetuar edhe me teknologjinë analoge edhe atë digjitale njëkohësisht, duke i shtuar akoma më tepër harxhimet e RTSH-së, si dhe paqartësinë e kostove totale të të gjithë procesit, pasi nuk dihej afati përfundimtar për mbylljen e transmetimit analog¹⁹³.

Produktiviteti i ulët dhe administrimi i dobët i forcës punëtore të RTSH-së është një tjetër problem që nuk ka si të mos e dëmtojë situatën financiare të radio televizionit publik. Ajo që është më e rëndësishme është fakti se struktura aktuale e forcës punëtore nuk lë shumë hapësira për riorganizim dhe investim në përmirësimin e përmbajtjes së RTSH-së. Aktualisht RTSH ka një staf total prej 960 personash, nga të cilët 100 punojnë në degët e rretheve¹⁹⁴. “Një grup tjetër me 300 persona janë rojet e antenave, plus që kemi personelin e orkestrës dhe punëtorët e mirëmbajtjes, dhe e gjithë kjo nuk lë hapësira të mjaftueshme për gazetarë dhe staf krijues. Ky nuk është fare një raport optimal i forcave të punës, por i kemi duart e lidhura në këtë drejtim,”¹⁹⁵ thotë Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së. Një tjetër problem madhor, që është ngritur disa herë nga drejtorët e RTSH-së ndër vite, është edhe mosha mesatare shumë e lartë e personelit të RTSH-së, deri në atë masë sa nuk ia vlen të investohet në trajnimin e tyre pasi janë pranë moshës së pensionit, por nga ana tjetër zëvendësimi i tyre nga staf më i ri në moshë mund të krijonte një problem ekonomik dhe social¹⁹⁶.

Roli i RTSH-së në tregun e medias duket se ka ardhur duke u dobësuar në vite edhe si pasojë e rolit të radiove dhe televizioneve private, që janë bërë më agresive dhe kanë zënë një pjesë të mirë të tregut. Sipas drejtuesve të RTSH-së, ka një tendencë që të trajtohen në mënyrë preferenciale radiot dhe televizionet private në krahasim me radio televizionin publik. Kjo vjen kryesisht si pasojë e dështimit të shtetit në monitorimin e zbatimit të ligjeve mbi të drejtat e autorit nga radiot dhe televizionet private, ndërsa radio televizioni publik i respekton të gjitha kushtet ligjore në këtë drejtim, dhe kjo ha më shumë fonde nga buxheti i RTSH-së, ndërkohë që radiot dhe televizionet private i përdorin këto para për programe dhe spektakle të mëdha¹⁹⁷. Një pikë tjetër problematike ka të bëjë me zbatimin e Kodit të Punës, që RTSH-ja duhet ta respektojë me rigorozitet, ndërkohë që problemet me marrëdhëniet e punës janë mjaft të dukshme në mediat komerciale, por nuk ndërmerret asnjë veprim në lidhje me këtë problem¹⁹⁸. Së fundmi, qeveria vendosi të kalojë fonde për tre kategori radio dhe televizioneve private si nxitje për lirim të frekuencave që do të përdoren për Dividentin Digjital, që do të jetë minimalisht pesë milionë euro, që është 10 përqind e të ardhurave nga përdorimin e frekuencave të Dividentit Digjital¹⁹⁹. Në të njëjtën kohë ky vendim nuk parashikon ndonjë kontribut për financat e RTSH-së në këtë drejtim.

Pavarësia në administrim

Ligji për Mediat Audiovizive parashikon një mbrojtje të dyfishtë të strukturave drejtuese të radio televizionit publik nga influenca e politikës. Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së zgjidhet nga një numër kandidatësh nga Këshilli Drejtues, i cili zgjidhet nga Kuvendi. Këshilli Drejtues ka 10 anëtarë dhe një kryetar, dhe ka personalitete me eksperiencë në media, teknologji, ekonomi, art, fusha akademike, sfera ligjore, grupet në

¹⁹² Po aty.

¹⁹³ Intervistë me Thoma Gëllçin, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së.

¹⁹⁴ Intervistë me Thoma Gëllçin, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së.

¹⁹⁵ Po aty.

¹⁹⁶ Po aty.

¹⁹⁷ Po aty.

¹⁹⁸ Po aty.

¹⁹⁹ D. Pavli, “RTSH ne epoken dixhitale,” OSCE, 2017.

nevojë, etj, duke u munduar që të sigurojë një përfaqësim sa më të gjerë dhe të shumëllojshëm eksperiencash. Anëtarët e Këshillit Drejtues nuk mund të jenë anëtarë të partive politike, nuk duhet të kandidojnë për deputet apo të jenë zgjedhur të tillë gjatë 2 legjislaturave të fundit. Ata që kanë ushtruar detyrën e kryetarit të bashkisë, anëtarit të Këshillit të Ministrave apo të prefektit gjatë 3 viteve të fundit përjashtohen nga kjo detyrë, së bashku me ata që janë anëtarë të Këshillit të Ankesave apo Autortitetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Nuk duhet të jenë të lidhur me persona që kanë, por edhe ata vetë nuk duhet të kenë, në pronësi pjesë kapitali apo aksione të shoqërive tregtare, si dhe të drejta të tjera në fushën e transmetimeve audiovizive, reklamës, prodhimeve të përmbajtjes së transmetimeve audiovizive, rrjeteve të komunikimit elektronik apo persona të punësuar, anëtarë të organeve drejtuese apo këshilluese të këtyre subjekteve apo të lidhur me ndonjë licencë me këto subjekte. (Neni 97)

Kandidatët propozohen nga organizata të shoqërisë civile, intervistohen nga anëtarët e komisionit të medias në Kuvend dhe zgjidhen nga deputetët. Përfshirja në proces e shoqërisë civile në emërimin e kandidaturave është bërë për të ftuar përfaqësimin nga fusha të ndryshme të jetës dhe për të shmangur zgjedhjen e anëtarëve të politizuar në Këshillin Drejtues të RTSH-së. Nga ana tjetër, mënyra se si përzgjidhen kandidaturat për votimin final hedh shumë hije dyshimi mbi eliminimin e ndikimit politik në procesin e seleksionimit. Pas analizimit të gjithë kandidatëve në komisionin parlamentar, i nënshtrohen përjashtimit një nga një, dhe procedura e përjashtimit zbatohet sipas radhës: një nga përfaqësuesit e opozitës dhe një nga përfaqësuesit e shumicës në parlament, duke mbajtur parasysh ruajtjen e balancës, pesë kandidatë të mbështetur nga maxhoranca, pesë të mbështetur nga opozita (Neni 94). Kryetari i Këshillit Drejtues zgjidhet më pas po nga komisioni parlamentar, që aplikon një procedurë të ngjashme: identifikon në fillim katër kandidatët që kanë marrë mbështetjen më të madhe në komision, dhe më pas përfaqësuesit e opozitës përjashtojnë dy nga katër kandidatët e përzgjedhur, dhe kryetari zgjidhet nga Kuvendi me më shumë se gjysmën e votave (Neni 95). Të njëjtat probleme vihen re edhe për zgjedhjen e drejtorit të përgjithshëm (Neni 104).

Megjithëse sistemin është ngritur për të siguruar paanësi, shqetësimi dhe hijet e dyshimit rreth ndikimit politik dhe lidhjeve të anëtarëve të këshillit drejtues me politikën nuk janë eliminuar dot. Ligji kërkon një eksperiencë të gjatë pune në media apo fusha të tjera, ku kemi përfaqësues nga grupe të ndryshme në Këshillin Drejtues, duke përfshirë edhe OJQ dhe grupe interesi, por vazhdon akoma të mbizotërojë opinioni se shumica e anëtarëve të këshillit ndikohen nga politika dhe janë të njëanshëm. Procesi i votimit për drejtorin aktual të RTSH-së në Këshillin Drejtues e konfirmoi këtë opinion. Pas votimit në tre runde për të zgjedhur drejtorin e përgjithshëm në verën e viti 2015, votat e Këshillit Drejtues ndaheshin në mënyrë të vazhdueshme në rezultatin 6 me 5 vota për secilin nga dy kandidatët, duke lënë të kuptohet se kishim dy grupe me preferenca të theksuara qartazi, një ndarje që me shumë mundësi ishte ngritur mbi linja partiake. Sipas Drejtorit të Përgjithshëm “anëtarët e Këshillit Drejtues ishin ndarë në dy kampe ushtarake që po ndesheshin me njëri-tjetrin.”²⁰⁰ Edhe anëtarët e Këshillit Drejtues duket se e konfirmojnë këtë përshtypje: “Këshilli nuk është fare i mbrojtur nga influenca e politikës, megjithë ndryshimet në ligj dhe faktin se anëtarët e tij nuk janë militantë të partive politike. Në përgjithësi ata vazhdojnë të funksionojnë si përfaqësues politikë.”²⁰¹ Bllokimi i këtij procesi çoi në marrjen e iniciativës ligjore nga shumica qeverisëse për ta ndryshuar formulën e zgjedhjes: nëse 3/5 e votave të nevojshme të Këshillit Drejtues nuk mblidhen dot gjatë tre votimeve të para, atëherë drejtori zgjidhet me shumicë të thjeshtë (Neni 102). Ky ndryshim formule u votua vetëm nga shumica qeverisëse dhe Thoma Gëllçi u zgjodh si Drejtor i Përgjithshëm. Opozita pretendoi se zgjedhja e drejtorit të ri në këtë mënyrë shkeli kriterin e konsensusit për të cilin kishin rënë dakord opozita dhe shumica, dhe akuzuan se ishte zgjedhur si drejtor një person i afërt me shumicën qeverisëse, duke krijuar hapësira për kapjen politike të medias. Nga sondazhi i zhvilluar me gazetarë dhe redaktorë për këtë studim doli se 57 përqind e tyre nuk e besonte se persona të lidhur me politikën nuk mund të mbanin poste drejtuese në RTSH, dhe vetëm 9.6

²⁰⁰ Intervistë me Thoma Gëllçin, Drejtorin e Përgjithshëm të RTSH-së.

²⁰¹ Intervista të zhvilluara për këtë studim.

përçind e tyre e besonte këtë si të vërtetë. Pjesa tjetër prej 33 përçind tha se nuk kishte informacionin e duhur për këtë.²⁰²

Përveç pavarësisë nga ndikimet politike, roli i Këshillit Drejtues të RTSH-së është vënë në pikëpyetje edhe për aftësitë e tij që të mbikqyrë, influencojë, dhe të udhëheqë punën e RTSH-së në mënyrë të pavarur dhe profesionale. Transparenca e punës së Këshillit Drejtues çalon dhe vendimet e tyre bëhen publike vetëm kur ka kronika apo shkrime në lidhje me to. Vendimet nuk publikohen online dhe faqja e RTSH-së në internet nuk përmban as listën e emrave të Këshillit Drejtues, dhe nuk përmban as anëtarët e stafit editorial të RTSH-së. Pas diskutimesh të gjata dhe debatesh të ndezura për zgjedhjen e tyre, dhe votimit për Drejtorin e Përgjithshëm, anëtarët e Këshillit Drejtues janë bërë gati të padukshëm për publikun. Drejtori i Përgjithshëm tha se ata janë sjellë si profesionistë të vërtetë dhe kanë bashkëpunuar në mënyrë të frytshme në mbledhje dhe diskutime, edhe pas bllokimit të procesit të zgjedhjes së drejtorit²⁰³. Sidoqoftë, disa anëtarë të Këshillit thanë se vendimet që merren prej tyre lidhen kryesisht me gjëra të vogla dhe se detyra parësore e këtij këshilli është të mbështesë drejtuesit e RTSH-së²⁰⁴. “Si anëtar i Këshillit Drejtues shpesh e shoh veten të pafuqishëm të ndryshoj ndonjë gjë në atë institucion, përveçse të votoj kundër ndonjë propozimi të caktuar.”²⁰⁵

²⁰² Të dhëna nga sondazhi i zhvilluar për këtë studim.

²⁰³ Intervistë me Thoma Gëllçin, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së.

²⁰⁴ Intervista të zhvilluara për këtë studim.

²⁰⁵ Po aty.

Mbrojtja e Autonomisë Editoriale të Transmetuesit Publik

Treguesi 21 – Radio televizioni publik duhet të hartojë kodin e vet të sjelljes për aktivitetin gazetaresk dhe pavarësinë editoriale nga politika.

Koncepti i radio televizionit publik u fut për herë të parë në Shqipëri me miratimin e ligjit 8410 në vitin 1998, që përcaktonte detyrat dhe funksionet e Radio Televizionit Shqiptar (RTSH). Dispozitat ligjore të këtij ligji i referoheshin në mënyrë të përgjithshme misionit dhe shërbimit publik të RTSH-së, por nuk hynin në detaje mbi pavarësinë e këtij institucioni dhe mënyrën si do të arrihej ajo. Ligji tjetër që u miratua shumë vite më vonë, Ligji për Mediat Audiovizive, megjithëse u debatua për vite me rradhë në Kuvend, ruajti në mënyrë identike po ato nene mbi misionin dhe rolin e RTSH-së, duke përcaktuar parimet dhe “idealet më të larta të transmetimit të shërbimit publik kombëtar”, si mbulimi i paanshëm i lajmeve (Neni 91.) Ky nen nuk përmend fare pavarësinë editoriale të këtij institucioni.

Statuti i radio televizionit publik RTSH ka zgjedhur të njëjtën përjasje, duke e vënë theksin mbi përkushtimin e RTSH-së ndaj idealeve më të larta të transmetimit të shërbimit publik kombëtar, si gjithëpërfshirja, paanshmëria, përsosmëria, diversiteti, llogaridhënia dhe inovacioni (Neni 2). Statuti përcakton strukturën dhe organet drejtuese të RTSH-së dhe thekson se “anëtarët e organeve drejtuese ushtrojnë funksionet e tyre vetëm në interes të RTSH-së dhe nuk marrin mandate apo udhëzime nga ndonjë person apo organ i jashtëm” (Neni 8). Kjo deklaratë i referohet të gjitha drejtorive dhe departamenteve të radio televizionit publik, dhe është më tepër një përpjekje për të theksuar nevojën që ka RTSH-ja për t’u distancuar nga çdo influencë e jashtme, në kuadër të përshtypjeve dhe opinionit të publikut se RTSH-ja funksionon thjesht si zgjatim i qeverisë dhe gjendet nën presion të vazhdueshëm.

Në vitin 2016 radio televizioni publik (RTSH) miratoi kodin apo rregulloren e parë të brendshme të punës, Parimet Editoriale të RTSH. Para miratimit të këtij kodi u zhvilluan konsultime të brendshme, dhe u morën mendimet e palëve të interesuara si dhe organizatave të shoqërisë civile për median, ndërsa OSBE bëri të mundur ndihmën dhe asistencën teknike të Unionit të Transmetuesve Evropianë. Udhëzimet e kodit u bazuan mbi rregullat e sjelljes të BBC-së dhe rregullat editoriale të radio televizionit publik të Sllovenisë. Udhëzimet nuk merren vetëm me radion dhe televizionin, por edhe me median online dhe praninë në internet të RTSH-së. Një nga qëllimet kryesore të udhëzimeve të Parimeve ishte edhe pavarësia editoriale “për të krijuar një mburojë ndaj presioneve të jashtme.”²⁰⁶

Parimet Editoriale janë munduar të krijojnë një listë sa më ezauruese të jetë e mundur mbi dilemat etike në punën e RTSH-së, madje hartuesit e tij janë marrë deri në detaje dhe me raste që nuk mbulohej nga Kodi e Etikës. Udhëzimet e Parimeve mbulojnë disa fusha si: standardet editoriale dhe profesionale, diversitetin dhe raportimin e ekuilibruar, fushatat elektorale, raportimin mbi politikën dhe Kuvendin, standardet e prodhimit, marrëdhëniet me autoritetet shtetërore, imitimi dhe sjelljet antishoqërore, raportimi investigativ, shpjegimi dhe qartësimi i informacionit, respektimi i vlerave dhe ndjenjave të publikut, programet me interes të veçantë për grupe të caktuara, paraqitja e grupeve të veçanta sociale, fëmijët dhe minorenët në programet e RTSH-së, etj.

Udhëzimet mundohen gjithashtu që të vendosin rregulla të detajuara për marrëdhëniet dhe sjelljen e stafit brenda redaksisë, sidomos përsa i përket censurës dhe vetëcensurës, konfliktit të interesit, dhe zinxhirin e përgjegjësisë. Parimet Editoriale merren gjithashtu edhe me problemet që lidhen me ndërhyrjet në punë, të drejtën e replikës, rolin e Këshillit të Dëgjuesve dhe Shikuesve, referencat e detyrueshme, asistencën ligjore për gazetarët dhe redaktorët, kodin e veshjes, konfliktin e interesit, reagimet e publikut dhe rolin e mediave online dhe mediave sociale në këtë drejtim.

²⁰⁶ Parimet Editoriale të RTSH, <https://www.rtsh.al/parimet-editoriale-te-rtsh-se/>

Parimet editoriale merren në mënyrë të veçantë edhe me pavarësinë editoriale dhe thonë se “gazetarët duhet t’i përmbahen, në çdo situatë, parimit të autonomisë dhe të pavarësisë së programeve të RTSH-së.”²⁰⁷ Ky parim përmendet edhe më tej në kapitullin që merret me raportimin e veprimtarive të partive politike duke thënë se “RTSH-ja vendos se cili zyrtar partiak do të marrë pjesë në emision, duke u munduar të ruajë ekuilibrin.”²⁰⁸ Ky paragraf merret me shqetësimin dhe ankesat e medias se partitë politike e vendosin vetë se cili zyrtar do të marrë pjesë në emisione politike, dhe përzgjedhjen e përfaqësuesve politikë në emisione nuk e ka më në dorë media. Kodi i Parimeve Editoriale ka edhe një kapitull të veçantë mbi marrëdhëniet e personelit të RTSH-së me autoritetet shtetërore ku thuhet se “redaktorët dhe gazetarët duhet të mbajnë distancë profesionale nga të gjitha instrumentet e pushtetit, përndryshe mund të rrezikojnë integritetin e institucionit për të cilin punojnë.”²⁰⁹

Duke patur parasysh edhe rëndësinë e çështjes, Parimet i kanë dedikuar një kapitull të veçantë ndërhyrjeve në punën e RTSH-së, duke theksuar përsëri se personeli i RTSH-së nuk duhet të ekspozohet ndaj presionit të pjesëmarrësve në emisione. Parimet e ndalojnë absolutisht censurën dhe vetëcensurën: “Redaktorët dhe gazetarët e RTSH-së nuk duhet të dorëzohen para çdo lloj presioni, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për të censuruar programet e tyre. Për më tepër, ata nuk duhet të bien në vetëcensurë, sepse konformizmi nuk ka asgjë të përbashkët me gazetarinë e pavarur.”²¹⁰

Kjo rregullore e detajuar mbulon shumë aspekte dhe probleme të punës së përditshme, duke analizuar situata dhe dilema të ndryshme por duke theksuar gjithmonë se pavarësia editoriale dhe imazhi profesional i RTSH-së duhet të jetë i vetmi prioritet i stafit të radio televizionit publik. Sidoqoftë këto udhëzime nuk shpjegojnë se si do të sigurohet kjo. E vetmja dispozitë e parimeve editoriale që mundohet ta sqarojë këtë çështje lidhet me vlerësimin dhe ruajtjen e standardeve editoriale dhe profesionale, duke e lënë të hapur mundësinë e krijimit të Këshillit të Etikës, që duhet të mbikqyrë zbatimin dhe ruajtjen e standardeve profesionale dhe çështjeve të ndryshme etike²¹¹. Parimet Editoriale gjithashtu parashikojnë edhe krijimin e një organizmi të ngjashëm që do të kryejë funksionet të përafërta me Avokatin e Popullit, duke luajtur rolin e ndërmjetësit midis publikut dhe personelit të RTSH-së. Sidoqoftë, deri më sot këto instrumente nuk janë krijuar akoma.

Mbetet akoma e paqartë se si do të garantohet respektimi i parimeve editoriale në punën e përditshme nga personeli i RTSH-së. Nga ana tjetër, radio televizioni publik duket se është munduar seriozisht që t’i japë drejtim problemit të njëanshmërisë politike që e ka ndjekur gjithmonë nga pas. Raporti i publikuar nga OSBE/ODIHR për zgjedhjet e qershorit 2017 vuri në dukje faktin se radio televizioni publik kishte deklaruar se nuk do të pranonte materiale filmike të prodhuara nga partitë politike, dhe doli me përfundimin se lajmet dhe emisionet informative të RTSH-së treguan qartazi një raportim të ekuilibruar të fushatës elektorale, duke i dedikuar 25 përqind të kohës PD-së, 24 përqind për PS-në, dhe 19 përqind për LSI-së; si dhe toni i raportimit ishte më së shumti neutral apo pozitiv²¹². Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së tha se nuk ushtrohet ndonjë farë presioni ndaj radio televizionit publik, as nga jashtë e as nga brenda, por pranoi faktin se raportimi çalonte shumë. “Gjithçka varet nga ndërgjegjja profesionale e gazetarit. Shpesh vetë gazetarët luajnë rolin e zëdhënësit të shtypit, dhe herë të tjera janë thjesht përtacë. Kam dhënë urdhër që të ketë më pak politikë në emisione, më pak aktivitete politikanësh. Problemi është se disa gazetarë i bien për shkurt dhe nuk e kryejnë gjithmonë si duhet punën e tyre.”²¹³

²⁰⁷ Parimet Editoriale të RTSH, www.rtsh.al/parimet-editoriale-te-rtsh-se/.

²⁰⁸ Po aty.

²⁰⁹ Po aty.

²¹⁰ Po aty.

²¹¹ Parimet Editoriale të RTSH, <https://www.rtsh.al/parimet-editoriale-te-rtsh-se/>.

²¹² OSBE/ODIHR, Reporti mbi zgjedhjet e 25 qershorit 2017 në Shqipëri.

²¹³ Intervistë me Thoma Gëllçin, drejtor i RTSH-së.

Dukuria e Padëshiruar e Pronësisë së Fshehtë të Shtetit në Media

Treguesi 22 – Mediat “private” nuk duhet të drejtohen dhe të zotërohen nga shteti apo kompani shtetërore.

Pronësia shtetërore mbi mediat private është një fenomen gati i panjohur për tregun mediatik shqiptar, dhe si pasojë nuk është parë ndonjëherë e aq aqarshme që të hartohet dhe miratohet ndonjë paketë ligjore që të merret posaçërisht me këtë aspekt. Pas kalimit nga komunizmi në pluralizëm politik tregu mediatik në vend u zhvillua në një mënyrë të tillë që nuk lejoi shumë hapësira që privatizimi në media të bëhej pjesë e debatit publik. Si televizioni shtetëror ashtu dhe shtypi i shkruar para viteve 90 ishin nën një kontroll të rreptë të përmbajtjes mediatike, dhe mbaheshin me fondet e shtetit. Ndër organet e shtypit të shkruar ishte edhe gazeta zyrtare e partisë së vetme në vend Partisë së Punës të Shqipërisë, si dhe shumë gazeta të tjera të organizatave dhe grupeve të ndryshme të shoqërisë, si bashkimet profesionale, rinia, artistët, mësuesit, ushtarakët, si dhe publikime të tjera për sektorë të veçantë të popullatës.

Ndryshimi i regjimit u ndoq nga një valë e madhe emigracioni, ndryshime të ndjeshme sociale dhe një realitet të ri ekonomik, që u shoqëruan me shkrirjen e shumë organizatave që publikonin këto gazeta e revista. Si rezultat pjesa dërrmuese e këtyre botimeve nuk i rezistuan dot ndryshimeve të viteve 90 dhe thjesht u zhdukën nga tregu mediatik pa patur mundësi që të kalonin në process privatizimi. *Zëri i Popullit* vazhdoi të botohej si gazeta e Partisë Socialiste, së bashku me ato pak publikime që mbetën nga regjimi komunist. Shumica e gazetave dhe revistave nga koha e diktaturës u mbyllën pasi u përballën me vështirësi të mëdha ekonomike dhe e patën shumë të vështirë që të gjenin vendin e tyre në tregun e ri mediatik. Radio televizioni shtetëror vazhdoi të funksiononte dhe ishte e vetmja media elektronike në vend deri në vitin 1995.

Mbyllja e gazetave dhe revistave të vjetra u shoqërua me daljen e organeve të reja të shtypit, dhe si rezultat nuk lindi nevoja e privatizimit të këtyre organeve mediatike nga shteti, organizatat që merrshin me publikimin e tyre, apo nga vetë stafi që punonte në to. Për pasojë edhe çështja e privatizimit të mediave shtetërore nuk është bërë ndonjëherë objekt diskutimi në ambientin mediatik shqiptar, në ndryshim nga vende të tjera të rajonit ku debati mbi këtë pikë pati rëndësi të veçantë dhe ndikoi goxha mbi tregun mediatik.

Mëgjithëse çështja e pronësisë shtetërore mbi median nuk është konsideruar ndonjëherë problem për kontekstin mediatik shqiptar, ky element u prek pak nga Ligji për Radion dhe Televizionin, dhe në një masë më të vogël nga legjislacioni aktual mbi mediat audiovizive. Ligji për Radion dhe Televizionin, që u aprovua në vitin 1998, ndalonte marrjen e licensave të trasmetimit nga institucionet shtetërore të të gjitha niveleve (Neni 26), duke përfshirë edhe organet e qeverisë lokale. Partitë, organizatat politike dhe fetare, institucionet publike të fushës së ekonomisë, si dhe bankat apo institucionet e kreditit nuk lejoheshin që të zotëronin një licensë trasmetimi. Po në këtë kohë edhe Radio Televizioni Shqiptar e ndryshoi statusin e tij nga trasmetues shtetëror në radio televizion publik.

Legjislacioni aktual, apo Ligji për Mediat Audiovizive, nuk merret direkt me papajtueshmërinë e pronësisë të një licensë trasmetimi nga autoritetet shtetërore, por kjo lihet të nënkuptohet. Ligji thotë vetëm se licenca kombëtare e trasmetimit audio dhe licenca kombëtare e trasmetimit audioviziv u jepen vetëm shoqërive aksionare të regjistruara në Shqipëri, të cilat kanë si objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive. (neni 62) Megjithatë ligji është disi i paqartë në këtë pikë, lihet të nënkuptohet në mënyrë indirekte se vetëm kompanitë mediatike mund të pajisen me licensë kombëtare, duke përjashtuar kështu autoritetet shtetërore. Është e paqartë përse legjislacioni i ri mjaftohet vetëm me përcaktimin e lëshimit të licensave ndaj personave fizikë apo ligjorë që merren posaçërisht me trasmetimin audioviziv, ndërkohë që ligji pararendës kishte shumë më tepër të dhëna mbi kriteret që duheshin përmbushur për të marrë një licensë trasmetimi. Sidoqoftë, në Shqipëri nuk ka patur ndonjë problem në lidhje me pronësi shtetërore të kamufluar në mediat private.

Papajtueshmëria midis Postit Publik dhe Angazhimit Profesional në Media

Treguesi 23 – Zyrtarët qeveritarë nuk duhet të angazhohen në aktivitete profesionale mediatike për sa kohë janë në detyrë

Ligji i ndalon zyrtarët e administratës publike që të mbajnë poste të tjera. Legjislacioni mbi parandalimin e konfliktit të interesit nuk kufizohet vetëm tek zyrtarët e lartë të qeverisë, por ka të bëjë edhe me persona që mbajnë poste publike në nivel qendror dhe lokal. Këto kufizime ligjore prekin një shtresë të gjerë zyrtarësh, duke përfshirë ata që kanë të drejtën të vendosin mbi akte administrative dhe kontrata shtetërore, gjykata dhe akte noteriale, si dhe akte normative. Kjo paketë ligjore mbulon gjithashtu dhe kompanitë e biznesit ku shteti zotëron shumicën e aksioneve, si në nivel qendror dhe lokal, si dhe organizatat joqeveritare apo persona të tjerë juridikë që kontrollohen nga institucionet që u përmendën më lart. Legjislacioni mbi konfliktin e interesit nuk e përmend ekzaktësisht angazhimin në biznesin mediatik nga zyrtarë qeveritarë për aq kohë sa mbajnë atë post. Megjithatë, disa nga kriteret e përmendura në ligjin për shmangjen e konfliktit të interesave privatë me postin publik përfshijnë edhe pjesëmarrjen e tyre në aktivitete komerciale, si dhe angazhimin në shoqata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse. Këto raste rregullohen për çdo rast me vetëdeklarim nga zyrtarët, por mund të shqyrtohen edhe nga institucioni ku punon zyrtari në fjalë.

Duke parë këtë trajtim ligjor për konfliktin e interesit nga zyrtarët publikë mund të arrihet në përfundimin se anëtarëve të qeverisë dhe zyrtarëve të tjerë nuk u lejonet të punojnë në media ndërkohë që mbajnë postin e tyre, edhe pse kjo nuk përmendet shprehimisht në ligj. Po kështu kryeministri aktual Edi Rama aprovoi gjatë një mbledhje të këshillit të ministrave në shtator 2013 Kodin Etik Ministror. Kodi e lejon anëtarin e Këshillit të Ministrave që të botojë mendime, komente, opinione në media të ndryshme, por me kusht që përmbajtja e tyre të mos bjerë ndesh me parimin e besueshmërisë dhe solidaritetit brenda qeverisë (Neni 16). Sipas Kodit shpërblimet nga këto botime u kalojnë organizatave sociale apo institucioneve që merren me zhvillimin e programeve të ndihmës dhe përkrahjes, ose institucioneve të ndryshme arsimore. Ndërkohë anëtari i Këshillit të Ministrave nuk duhet të pranojë asnjë formë pagese për fjalimet, komentet ose artikujt e natyrës zyrtare apo që lidhen drejtpërdrejt me përgjegjësitë apo përvojën e tij si anëtar i qeverisë, të cilat botohen në media të ndryshme. (Neni 17)

Legjislacioni mbi median nuk merret fare me aspektin e punësimit në media të zyrtarëve qeveritarë. E vetmja referencë në lidhje me këtë pikë haset në listën e kriterëve që duhet të përmbushin anëtarët e këshillit drejtues të radio televizionit publik RTSH, drejtori i përgjithshëm i radio televizionit publik, dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Ligji për mediat audiovizive thotë se anëtarë të AMA-s nuk mund të jenë anëtarë të partive politike, kandidatë për deputet gjatë dy legjislaturave të fundit, kandidatë për kryetar të njërive vendore në komuna, bashki, këshilla rrethi, prefektura, gjatë tre viteve të fundit. (Neni 7, 97, dhe 104.) Megjithëse ky ligj nuk e lejon këtë kategori politikanësh që të zgjidhen anëtarë të institucioneve drejtuese të mediave publike apo në postin e drejtorit të përgjithshëm të RTSH-së, ai nuk parmban ndonjë referencë në lidhje me zyrtarët qeveritarë dhe angazhime profesionale në media.

Nga ana tjetër, Parimet Editoriale të RTSH-së që u miratuan në vitin 2016, thonë punonjësit e RTSH-së janë të lirë që t'u bashkohen organizatave politike apo sindikaliste, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj apo nga statuti i RTSH-së. Gjithashtu ky kod etike thotë se angazhimi politik nuk duhet të ndërhyjë në përgjegjësitë dhe proceset e punës (Neni 21.6). Gjithashtu nëse punonjësit e RTSH-së do të kandidojnë në zgjedhje për post publik duhet të informojnë eprorin e tyre në kohën e duhur dhe nuk lejohen të punojnë si redaktorë, gazetarë apo prezantues gjatë fushatës elektorale. Në rast se punonjësi fiton në zgjedhje apo në një post qeveritar atëherë ndryshimet në kontratat e punësimit janë të përcaktuara me ligje të tjera, që përfshijnë ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave që nuk i lejon zyrtarët e qeverisë të angazhohen si profesionistë në media.

Nuk ka patur raste të zyrtarëve qeveritarë që kanë punuar në të njëjtën kohë edhe në media. Po kështu, nuk është shënuar ndonjë rast shkelje të normave të Kodit Etik Ministror nga anëtarë të kabinetit qeveritar.

Hapja e Institucioneve ndaj të Gjitha Mediave

Treguesi 24 – Qeveria, parlamenti dhe gjykatat duhet të jenë të hapura për të gjitha mediat në mënyrë të barabartë dhe të drejtë.

Legjislacioni kërkon që autoritetet shtetërore të jenë të hapura ndaj publikut duke respektuar kështu një të drejtë themelore të njeriut. Kushtetuta i garanton një qytetari të drejtën e informimit nga organet shtetërore dhe personat që ushtrojnë funksione shtetërore, si dhe të drejtën të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive (Neni 23). Po kështu Ligji për të Drejtën e Informimit që u miratua në vitin 2014, rregullon në mënyrë më të detajuar procesin e aksesit në informacion. Ligji aplikohet njëloj për të gjithë qytetarët dhe nuk është hartuar në mënyrë të veçantë për të mundësuar aksesin e medias në informacion. Parimi kryesor që aplikohet në legjislacionin për aksesin në informacion është përpjekja për të arritur maksimumin në publikimin e informacionit, duke i ngarkuar si detyrë autoriteteve që të publikojnë informacionet përpara se të kërkohen nga publiku, në faqet e tyre të internetit ku mund të gjenden me lehtësi nga qytetarët. Rregullat për transparencën e të dhënave që duhet të publikohen nga të gjitha institucionet shtetërore janë prezantuar në mënyrë më të detajuar në programin model të transparencës të hartuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Legjislacioni mbi të drejtën e informimit u rendit në vitin 2017 në vendin e gjashtë në klasifikimin e ligjeve më të mira në botë për informimin²¹⁴. Ky ligj mbulon të gjitha autoritetet publike, në nivel qeverie dhe pushteti lokal, institucionet legjislative dhe gjyqësore, institucionet dhe agjencitë që varen nga qeveria dhe pushteti lokal, si dhe kompanitë private ku shteti ka shumicën e aksioneve apo kompanitë që kryejnë funksione publike. Gjithashtu Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik përcakton procedurat që duhet të garantojnë transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në aprovimin e projektligjeve, dokumenteve strategjike dhe politikave me interes publik.

Në praktikë ka probleme në zbatimin e këtyre ligjeve dhe aksesit në informacion nuk garantohej as nga të gjitha autoritetet publike, dhe as për të gjitha mediat. Sipas të dhënave të sondazhit rreth 61 përqind e redaktorëve dhe gazetarëve mendonin se autoritetet publike nuk ofronin akses të barabartë dhe të drejtë për të gjitha mediat në shumicën e rasteve, për të mos thënë gjithmonë²¹⁵. Intervista të thelluara me redaktorë dhe drejtorë lajmesh konfirmuan faktin se ka patur shumë raste kur janë dhënë dokumente, materiale, apo intervista në mënyrë selektive vetëm për një apo disa media të caktuara. Shembuj që ilustronë këtë prirje janë edhe ankesat nga disa organe të medias se filmimet e policisë gjatë operacioneve të saj shpërndahen në fillim në një apo disa media të caktuara, dhe nuk i jepen të gjithë stacioneve njëkohësisht.

Pushteti legjislativ duket se është më transparenti dhe i hapuri nga të tre degët e pushtetit. Seancat plenare të Kuvendit transmetohen direkt nga radio televizini shqiptar dhe shumica e televizioneve të lajmeve 24 orë, ndërsa rregullorja e parlamentit e lejon pjesëmarrjen e qytetarëve në takime apo seanca, duke aplikuar për hyrje të përkohshme apo duke marrë akreditim. Gazetarët e akredituar ndjekin rregullisht takimet e komisioneve parlamentare dhe seancat plenare. Deklaratat për shtyp nga aktivitete të Kuvendit, kalendari i aktiviteteve, dhe çdo ngjarje tjetër në jetën e Kuvendit publikohen në mënyrë të rregullt dhe zakonisht pa vonesë. Dokumente si projektligje, procesverbalet e takimeve dhe seancat plenare, si dhe raporte mbi aktivitete të tjera mund të gjenden në internet.

²¹⁴ <http://www.rti-rating.org/>

²¹⁵ Sondazh i zhvilluar për këtë raport.

Nga ana tjetër gjyqësori është pushteti më i mbyllur. Niveli i transparencës së gjyqësorit u përkeqësua akoma më tej në vitin 2016, kur Ministri i Drejtësisë lëshoi udhëzime për zbatimin e dy rekomandimeve të vitit 2011 dhe 2012 nga Komisioneri i Mbrojtjes së të Dhënave për të mbrojtur privatësinë e personave të përfshirë në çështje gjyqësore. Si rezultat i këtyre ndryshimeve dobishmëria e bazave të të dhënave online të gjykatave u reduktua në mënyrë dramatike, pasi këto të dhëna kaluan në nivel anonimati. Aksesit i publikut dhe medias në vendime gjyqësore apo të dhëna të tjera është kufizuar dhe ngadalësuar ndjeshëm. Po kështu, ka probleme të vazhdueshme edhe me transparencën e organeve të prokurorisë, gjë që ka nxitur Komisionerin për Informimin të marrë shumë vendime që i kërkojnë prokurorisë të lejojë aksesin në informacion. Gjatë dy viteve të fundit Komisioneri ka marrë më shumë se 500 ankesa në lidhje me aksesin në informacion. Vihet re se përqindja e ankesave nga qytetarë të thjeshtë është rritur në raport me ankesat e bëra nga shoqëria civile, çka tregon se është rritur dhe ndërgjegjësimi i publikut në lidhje me të drejtat e tyre për informacion²¹⁶.

Sondazhi i zhvilluar me gazetarë dhe redaktorë tregoi se në bazë të eksperiencave të tyre, procesi i aksesit në informacion ka qenë i ngadaltë, jo shumë i thjeshtë, dhe i lodhshëm për 57 përqind të të anketuarve; dhe shumë i ngadaltë, i komplikuar, dhe i mundimshëm për 25 përqind të të anketuarve²¹⁷. Disa testimet kryera nga shoqëria civile identifikuan probleme të shumëllojshme që hasen nga media dhe qytetarët në lidhje me aksesin në informacion. Shumë gazetarë thonë se ndonëse aksesit në informacion është përmirësuar, informacioni për çështje delikate, kryesisht mbi kontratat e biznesit apo kontrata prokurimi, është i pamundur të arrihet²¹⁸. Testimi i ligjit të aksesit në informacion nga Instituti Shqiptar i Medias gjatë katër viteve, në institucionet qeveritare dhe të pushtetit lokal, ka përfunduar me sukses në 60 përqind të rasteve, por media është natyrisht më e favorizuar se qytetarët e thjeshtë²¹⁹. Një studim i treguesve të transparencës për pushtetin lokal në vitin 2017 tregoi se 61 bashki plotësonin vetëm 43 përqind të treguesve²²⁰.

²¹⁶ Raporti vjetor i Komisionerit për informimin, 2017.

²¹⁷ Po aty.

²¹⁸ Intervista me gazetarë.

²¹⁹ Testi i ligjit të aksesit në informacion nga Instituti Shqiptar i Medias.

²²⁰ BIRN, "Pushteti vendor nën lentin e të drejtës për informim," 2017.

Preferenca për Vetërregullim në Media

Treguesi 25 – Media duhet të funksionojë si një sistem vetërregullues ku të ekzistojnë hapësira të mjaftueshme për të drejtën e replikës dhe botimin vullnetar të përgënjeshtimeve nga gazetarët. Mediat duhet krijojnë organizmat e tyre vetërregulluese si komisione ankesash apo zyra kontakti për publikun, dhe vendimet e këtyre organizmave duhet të zbatohen. Këto masa duhet të gëzojnë njohje ligjore nga gjykatat.

Procesi i vetërregullimit të profesionit të gazetarisë në Shqipëri është shumë larg standardeve ndërkombëtare të mbrojtjes të lirive dhe të drejtave të gazetarëve. Megjithatë ekziston Kodi i Etikës, si dhe kode apo rregullore të tjera profesionale, zbatimi i tyre në praktikë lihet në dorë të gazetarëve dhe ndërgjegjes së tyre. Ka patur disa përpjekje gjatë këtyre 25 vjetëve për të krijuar instrumente vetërregulluese por ato nuk kanë patur sukses. E drejta e replikës dhe korrigjimit të gabimeve (përgënjeshtimet) garantohet me ligj dhe është gjithashtu pjesë e Kodit të Etikës, por duket se përdoren shumë rrallë nga media.

Herë pas here qarqet e gazetarisë angazhohen në refleksione dhe diskutime mbi çështjet e etikës, dhe kjo zakonisht ndodh në raste krizash apo raportimesh problematike. Kjo tregon se gazetarët janë të vetëdijshëm dhe të shqetësuar në lidhje me respektimin e rregullave etike në media, por megjithatë komuniteti mediatik nuk ka arritur akoma që të bashkojë forcat dhe të hartojë një paketë rregullash të etikës profesionale, të kujdeset për zbatimin e tyre, dhe të dorëzojë një pjesë të “sovrانيتit” të vet dhe t’i bindet këtyre mekanizmave vetërregulluese. Mbështetja e dobët për iniciativat vetërregulluese duhet të gjykohet duke patur parasysh edhe situatën e vështirë ekonomike të gazetarëve, frikën e heqjes nga puna, si dhe vënien e interesave të biznesit mbi profesionalizmin në gazetari në shumicën e mediave në vend.

Kodi i Etikës u hartua për herë të parë në vitin 1996 nga Instituti Shqiptar i Medias në bashkëpunim me dy shoqatat më të mëdha të gazetarisë në atë kohë, por nuk pati ndonjë miratim apo adoptim zyrtar të këtij Kodi. Në një përpjekje tjetër në vitin 2006 Kodi i Etikës u pëmirësua dhe u rifreskua me përpjekjet e përbashkëta të Institutit Shqiptar të Medias dhe një grup ekspertësh ligjorë dhe të medias. Gjithashtu u analizua edhe mundësia e krijimit të një instrumenti apo institucioni vetërregullues, bazuar dhe në modelet e përdorura nga vende të tjera. Asokohe u mor mendimi i pronarëve të mediave kryesore në vend, redaktorëve, ekspertëve të medias, dhe gazetarëve. Megjithatë shumica ishte dakord në parim, aktorët kryesorë të medias në vend hezituan që të mbështesnin krijimin e mekanizmave vetërregulluese që duhet të mbikqyrnin zbatimin e rregullave të Kodit dhe të merrnin vendime që do të respektoheshin nga të gjitha organet e medias. Kodi i Etikës u rishikua sërish në 2018 nga një grup ekspertësh nën udhëheqjen e Institutit Shqiptar të Medias, si dhe u hartuan disa udhëzime për të mbuluar sjelljen etike në median online.

Për momentin, i vetmi grup mediatik që ka kodin e vet të etikës, përveç parimeve editoriale të radio televizionit shqiptar, është Free and Fair Media Group, që boton gazetën e përditshme Shqiptarja.com, faqen në internet me të njëjtin emër, dhe që ka në pronësi stacionin televiziv Report TV. Ky grup ka hartuar kodin e vet të etikës që përmban parimet kryesore të sjelljes profesionale, si dhe merret deri në detaje me analizimin e situatave të veçanta si kodin e veshjes, asistencën ligjore për gazetarët, si dhe raportimet mbi minorenët, orientimet seksuale, personat e moshuar, zgjedhjet, terrorizmin, mitingjet, etj. Rregullat e kodit janë të detyrueshme për të gjithë punonjësit e organeve të medias të këtij grupi, por kjo rregullore nuk parashikon ngritjen e ndonjë strukture vetërregulluese brenda këtij grupi mediatik dhe nuk sqaron se çfarë mund të ndodhë nëse një gazetar shkel rregullat. Edhe vetë një nga bashkëthemeluesit e këtij grupi mediatik kishte dyshime në lidhje me zbatimin e këtij kodi në praktikë duke patur parasysh problemet e shumta që ka media shqiptare. “Shumica e gazetarëve janë tepër të rinj dhe shpesh vijnë nga bankat e fakulteteve të gazetarisë dhe u mungon edhe

minimumi i njohurive në lidhje me raportimin. Atyre u vjen çudi kur i thua se nuk duhet të tregojnë identitetin e minorenëve, të grave të dhunuara, apo të dhëna që shkelin jetën private.”²²¹

Në Shqipëri, i vetmi organizëm vetërregullues në redaksitë e lajmeve ka funksionuar në gazetën Shekulli dhe u krijua në vitin 1998. Gazeta kishte kodin e saj të etikës dhe këshillin e etikës, “i cili nuk priste që të vinin ankesa nga lexuesit, por kryente një analizë javore të punës së gazetarëve nga pikëpamja etike.” Sidoqoftë kjo risi nuk erdhi nga redaksia por nga pronari i gazetës²²². Probleme financiare dhe mungesa e interesit çoi në mbylljen e këtij këshilli disa vite më pas. Për momentin nuk ka asnjë “avokat të popullit” në media që të luajë rolin e ndërmjetësit midis gazetarëve dhe publikut. Për sa kohë që mediat kanë prirje të reduktojnë numrin e personelit të redaksive deri në minimumin e mundshëm, marrja në punë e një personi që merret me etikën do të ishte luks i tepërt.

Një nga zhvillimet e fundit është edhe krijimi i Këshillit të Medias në vitin 2015 nga një grup gazetarësh i cili u mbështet nga Këshilli i Evropës. Qëllimi i tij ishte që të ndikonte në përmirësimin e standardeve profesionale në gazetari nëpërmjet respektimit të rregullave të Kodit të Etikës²²³. Deri tani ky këshill ka hapur zyrën e vet dhe ka zgjedhur një këshill ankesash me mbështetjen e donatorëve të huaj. Sidoqoftë, është akoma tepër herët për të gjykuar se çfarë efekti do të ketë ky këshill në vetërregullimin e medias në vend.

Përveç këtyre nismave, Këshilli i Ankesave funksionon pranë rregullatorit, Autoritetit të Mediave Audiovizive, duke shqyrtuar kërkesa nga publiku apo institucione publike në lidhje me përmbajtje mediatike që mund të jetë fyese për dinjitetin njerëzor dhe në shkelje të të drejtave të njeriut. Këshilli ka filluar punën prej dy vitesh dhe përbëhet nga tre anëtarë, të zgjedhur nga Bordi i AMA. Në gjysmën e parë të 2017, Këshilli shqyrtoi 22 ankesa nga institucione publike, OJQ dhe qytetarë, kryesisht në lidhje me raportimin e të miturve dhe shkeljen e dinjitetit njerëzor²²⁴.

Në Shqipëri, e drejta e replikës dhe botimit të përgënjeshtimeve janë të parashikuara me ligj dhe përmenden edhe nga Kodi i Etikës. Neni 43 i Kodit Penal thotë se gjykatat mund të urdhërojnë një të dënuar që me shpenzimet e veta të publikojë në një apo disa gazeta ose stacione radiotelevizive vendimin gjyqësor, sipas urdhërimit të bërë nga gjykata. Gjithashtu, nëni 617 i Kodit Civil merret me publikimin e informacioneve të pasakta ose mashtruese, dhe thotë se gjykata me kërkesën e personit të dëmtuar, detyron personin fajtor për publikimin e të dhënave të pasakta, jo të plota ose mashtruese që të publikojë një përgënjeshtim. Edhe ligji i mediave audiovizive merret deri në detaje me të drejtën e replikës (Neni 53) ndërsa Autoriteti i Mediave Audiovizive ka miratuar një rregullore dhe procedurat për përmbushjen e të drejtës së replikës në median audiovizive.²²⁵ E drejta e replikës është gjithashtu e përfshirë në Kodin e Etikës. Ka patur disa çështje gjyqësore ku e drejta e replikës dhe përgënjeshtimit është përdorur të ndrequr dëmtimin e reputacionit dhe nderit të individëve, por nuk ka të dhëna mbi përdorimin e tyre në mënyrë vullnetare nga media pas ankesave të publikut. Mendohet se këto raste duhet të jenë të pakta në numër duke patur parasysh se pothuajse nuk ekzistojnë fare instrumentet që mundësojnë dialogun midis medias dhe publikut.

²²¹ Intervista të thelluara të zhvilluara për këtë studim.

²²² I. Londo në SEENPM “*Labor relations and media: Analyzing patterns of labor relations in the media of SEENPM member countries*,” (Marrëdhëniet e punës në media: Analiza e zhvillimit të marrëdhënieve të punës në vendet anëtare të SEENPM) 2008.

²²³ Deklaratë shtypi me rastin e krijimit të Këshillit të Medias, <http://www.javanews.al/fomohet-keshilli-i-medias/>

²²⁴ AMA, “Buletini i Këshillit të Ankesave” 2017.

²²⁵ AMA, “Rregullore mbi procedurat për trajtimin e ankesave dhe ushtrimin e të drejtës së përgjigjes,” <http://ama.gov.al/preview/wp-content/uploads/2015/03/RREGULLORE-MBI-PROCEDURAT-P%C3%8BR-TRAJTIMIN-E-ANKESAVE-DHE-P%C3%8BR-USHTRIMIN-E-S%C3%8B-DREJT%C3%8BS-S%C3%8B-P%C3%8BRGJIGJES.pdf>

Respektimi i Kodit të Sjelljes për Gazetarët

Treguesi 26 – Mediat duhet ta hartojnë vetë kodin e sjelljes profesionale për gazetarët dhe duhet t'i respektojnë këto rregulla në punën e përditshme. Gazetarët nuk duhet të fshehin nga lexuesit apo shikuesit interesat e tyre politike dhe financiare, si dhe çdo bashkëpunim të ngushtë me institucione shtetërore, si për shembull kur raportojnë si gazetarë të atashuar pranë ushtrisë apo policisë.

Shqipëria nuk ka traditë në vetërregullimin e gazetarisë, pasi media dhe shtypi para viteve 90 nuk gëzonin lirinë e mjaftueshme për të hartuar dhe respektuar rregullat e veta etike, duke patur parasysh edhe kontrollin e fortë që ushtrohej nga shteti në çdo aspekt të jetës dhe shoqërisë.

Kodi i Etikës u hartua për herë të parë në vitin 1996 nga Instituti Shqiptar i Medias në bashkëpunim me dy organizatat kryesore të gazetarisë të asaj kohe, Lidhja e Gazetarëve Shqiptarë dhe Shoqata e Gazetarëve Profesionistë. Kodi duhej të funksiononte si instrument vetërregullues për komunitetin e gazetarëve dhe të ndihmonte në zgjidhjen e dilemave etike. Kodi u shpërnda tek mediat dhe institucione të tjera, si dhe u zhvilluan kurse trajnimi për rregullat e etikës, por organet e medias nuk e adoptuan zyrtarisht Kodin e Etikës.

Në kuadër të përpjekjeve për të hequr shpifjen dhe fyerjen nga lista e shkeljeve penale, në vitin 2006 u zhvillua një fushatë paralele për rishikimin dhe rirregullimin e Kodit të Etikës. Qëllimi i kësaj iniciative ishte hartimi i një sërë rregullash që duhet të ndiqeshin nga gazetarët, për të kontribuar për një gazetari më etike dhe për t'u kujdesur që liria më e madhe pas ndryshimeve ligjore në depenalizimin e shpifjes dhe fyerjes të mos keqpërdorej nga gazetarët. Iniciativa u ndërmor nga Instituti Shqiptar i Medias në bashkëpunim me një grup ekspertësh të medias dhe ligjit, si dhe duke marrë në shqyrtim kode etike nga vende të ndryshme për t'i përshtatur masat e tyre me kontekstin shqiptar. Përveç rishikimit të Kodit, kjo iniciativë konsideroi edhe mundësinë e krijimit të një organizmi vetërregullues. I gjithë ky proces kaloi nëpër disa faza konsultimi dhe takimesh me grupe të ndryshme interesi, duke përfshirë gazetarët, pronarët e mediave, akademikë, etj. Kodi u aprovua gjatë një takimi zyrtar nga organizatat kryesore të gazetarisë në atë kohë, Lidhja e Gazetarëve Shqiptarë, Shoqata e Gazetarëve Profesionistë, dhe Forumi i Medias së Lirë.

Kodi i Etikës përcakton të drejtat dhe detyrimet e gazetarëve gjatë punës së tyre të përditshme dhe paraqet këndvështrimin e tij mbi rolin që duhet të luajë shtypi dhe gazetaria e lirë në shoqëri. Ky kod ka një përqsasje të ngjashme me rregulloret etike të vendeve të tjera për sa i përket çështjeve që merr në shqyrtim, si saktësia në raportim, ndarja e faktit nga opinionet, respekti për minorenët, viktimat dhe personat në nevojë, mbrojtja e pavarësisë redaksionale, shërbimi ndaj interesit publik, respektimi i parimit të pafajësisë pa u shpallur fajtor, e drejta e replikës dhe përgënjeshtimit, ndarja e qartë e përmbytjes redaksionale nga reklamat, respektimi për jetën private, respektimi i të drejtës së autorit, etj.

Kodi i Etikës merret gjithashtu edhe me konfliktin e interesit, megjithëse e prek këtë çështje shkurtimisht. Ndër të tjera Kodi nënvizon se lajmet nuk duhet të përdoren për përfitim personal, dhe se gazetarët duhet të shmangin raportimin e tematikave apo sektorëve nga ku mund të kenë drejtpërsëdrejti përfitim personal.

Në vitin 2017 Instituti Shqiptar i Medias mbledhi së bashku një grup ekspertësh për rishikimin e Kodit dhe hartimin e Udhëzimeve Etike për Gazetarinë Online. Të dyja këto dokumente kaluan në proces konsultimi me komunitetin mediatik. Ky Kod u zgjerua akoma më shumë duke trajtuar çështje dhe probleme që nuk ishin përfshirë në versionet e mëparshme të Kodit dhe ky proces përfundoi në mars 2018.

Përveç Kodit të Etikës janë hartuar edhe rregullore apo udhëzime për sektorë të veçantë të gazetarisë, si gazetaria investigative, raportimi mbi viktimat e trafikut, raportimi mbi minorenët, raportimi mbi grupet në nevojë, raportimi mbi zgjedhjet, etj. Edhe në këto raste zbatimi i rregullave etike i lihet në dorë gazetarëve dhe ndërgjegjes së tyre, dhe nuk vendosen penalizime për shkelje.

Mediat e vetme që kanë miratuar kodin e tyre të etikës janë radio televizioni shqiptar dhe grupi mediatik Free and Fair Media, ndërsa për mediat e tjera duket se kjo çështje nuk është bërë ende objekt diskutimi. Ndërsa kontratat e punës janë administrative dhe nuk merren me përmbajtjen mediatike

Duke patur parasysh problemet e mëdha që hasin gazetarët në fushën ekonomike dhe sociale, si dhe shkallën e ulët të autonomisë së tyre brenda strukturës së medias, nuk është ndonjë surprizë e madhe që etika nuk është prioritet për ta. Sipas intervistave me redaktorë dhe gazetarë, zakonisht mediat nuk kanë ndonjë stimul për të ndërmarrë iniciativa në lidhje me etikën. “Vetërregullimi nënkupton se ti dëshiron që të përmirësosh nivelin profesional apo etik. Por mediat tona nuk kanë stimul që të vetë-kontrollohen, pasi standardet etike nuk konsiderohen të rëndësishme për suksesin e tyre në treg.”²²⁶ Çdo vlerësim i përpjekjeve për vetërregullim duhet të gjykohet në raport me kontekstin profesional dhe social të tregut mediatik. “Nuk mund të flitet për vetërregullim midis personave që nuk marrin rrogën, nuk ka pikë kuptimi.”²²⁷

Sipas të intervistuarve pjesa më problematike në lidhje me shkeljen e normave etike në media ka të bëjë me kronikën e zezë, si paraqitja e planeve dhe fotografive të njerëzve të vrarë, apo dëshmitë e fëmijëve të abuzuar. Megjithëse duhet theksuar se etika në raportim është përmirësuar në krahasim me 20 vite më parë, perspektivat e vetërregullimit në media duken shumë të zymta, nëse më parë nuk zgjidhem problemet me të drejtat e gazetarëve.

²²⁶ Intervista të thelluara me redaktorë.

²²⁷ Po aty.

Kujdesi i Kuvendit ndaj Zhvillimit të Lirisë së Medias

Treguesi 27 – Parlamentet duhet të hartojnë raporte periodike mbi lirinë e medias në vendet e tyre në lidhje me treguesit e renditur më lart dhe t'i diskutojnë problemet e hasura në nivel mbarëevropian.

Kuvendi i Shqipërisë nuk ka bërë asnjëherë ndonjë analizë të plotë mbi gjendjen e lirisë së medias në vend. Nga ana tjetër komisioni parlamentar i medias ka analizuar shumë raste dhe fenomene që lidhen me lirinë e medias. Komisioni gjithashtu ka bashkëpunuar vazhdimisht ose ka kërkuar mendimin e organizatave të shoqërisë civile apo shoqatave të gazetarëve mbi projektligje të ndryshme që mund të ndikojnë në lirinë e medias apo lirinë e shprehjes në përgjithësi.

Kompetencat e Komisionit për Arsimin dhe Mjetet e Informimit Publik përfshijnë analizimin dhe diskutimin e projektligjeve, propozimeve legjislative dhe dokumenteve të tjera që kalojnë nëpër procedurat parlamentare, ndjekjen e zbatimit të ligjeve, monitorimin e aktivitetit të ministrive dhe institucioneve të tjera qeveritare, propozimin dhe hartimin e projektligjeve, resolutave, apo deklaratave. Ky komision nuk mbulon vetëm median por merret gjithashtu edhe me arsimin në të gjitha nivelet, kulturën, rininë, dhe sportet. Që nga shtatori 2017 ky komision është i përbërë nga 18 anëtarë. Një nga kompetencat e komisionit është edhe kryerja e studimeve për efikasitetin e legjislacionit aktual, por sidoqoftë një studim i tillë nuk është kryer ndonjëherë nga ky komision.

Një nga pjesët më të rëndësishme të punës së komisionit është rishikimi dhe diskutimi i raporteve vjetore të entit rregullator të mediave elektronike Autoriteti i Mediave Audiovizive, dhe Radio Televizionit Shqiptar. Përfaqësuesit e këtyre institucioneve ftohen nga komisioni që të paraqesin një tablo të punës së tyre gjatë vitit të kaluar, dhe më pas komisioni harton një resolutë për vlerësimin e punës të bërë nga enti rregullator dhe radio televizioni publik. Këto raporte vjetore diskutohen edhe në Kuvend në seanca plenare. Në legjislacionet e kaluara, deri në vitin 2013, komisioni kishte mundësinë që të aprovonte apo të hidhte poshtë raportet vjetore të ish-Këshillit Kombëtar të Radio Televizioneve, dhe RTSH-së. Nëse raportet hidheshin poshtë për dy vite rresht atëherë komiteti drejtues i entit rregullator apo këshilli drejtues i radio televizionit shqiptar mund të shkriheshin. Ligji aktual nuk ia lejon më këto kompetenca komisionit parlamentar të medias. Komisioni gjithashtu komunikon dhe diskuton publikisht në fund të çdo viti me institucionet qeveritare të fushave që mbulon lidhur me planet dhe pritshmëritë nga buxheti i shtetit për vitin në vijim, dhe më pas lëshon rekomandimet përkatëse.

Një nga instrumentet më të përdorura nga komisioni parlamentar është organizimi i interpelancave me individë apo organizata me kërkesën e tyre apo me iniciativën e vetë komisionit. Këto seanca pyetjesh kanë të bëjnë zakonisht me ngjarje të veçanta apo fenomene që lidhen me lirinë e medias. Një nga rastet e fundit të këtij lloji ishte edhe interpelanca me përfaqësues të radio televizionit publik në lidhje me vendimin e drejtuesve të RTSH-së për të hequr nga puna një gazetarë; interpelanca mbi Alida Totën, që pretendoi se ishte pushuar nga puna pasi raportoi mbi vdekjen e një minoreni në pikën e mbledhjes të mbeturinave në periferi të Tiranës; apo interpelanca me Telnis Skuqin, që i tha deputetëve se ishte kërcënuar për arsye se raportonte mbi trafikun e drogës. Ka patur edhe raste kur organizata të caktuara kanë kërkuar të flasin përpara komisionit për të prezantuar rezultatet e një studimi mbi lirinë e medias, apo t'i paraqesin komisionit një tablo të situatës në lidhje me aspekte të veçanta të medias. Për shembull, BIRN ka prezantuar një studim mbi vetëcensurën në media, ndërsa Unioni i Gazetarëve Shqiptarë kërkoi të zhvillohej një seancë dëgjimore për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me situatën e marrëdhënieve të punës në media, problemet me zbatimin e dispozitave të Kodit të Punës, dhe i bëri disa kërkesa komisionit në këtë drejtim.

Komisioni parlamentar i medias ka qenë zakonisht i hapur përgjatë gjithë këtyre viteve dhe ka patur vullnetin e mirë të dëgjojë opinionet e palëve të interesuara, por nga ana tjetër këto interpelanca jo rallë janë kthyer në debate politike midis anëtarëve të komisionit, duke e transferuar luftën politike në diskutimet mbi çështjet që analizohen në interpelanca.

Analizë e situatës të medias në Shqipëri

Nga analiza e situatës së medias në Shqipëri, bazuar në shqyrtimin e 27 parimeve të Këshillit të Evropës, arrihet në përfundimin se vetëm disa nga këto tregues respektohen rregullisht në Shqipëri. Më gjithëse legjislacioni shqiptar është përshtatur në një masë të madhe me bazën ligjore evropiane, zbatimimi i këtyre parimeve në praktikë nuk i përmbush kriteret dhe standardet e tyre, si pasojë e mangësive apo problemeve në legjislacion, institucioneve të dobëta në zbatimin e ligjit, ndikimit të faktorëve të tjerë politikë dhe ekonomikë, si dhe gjendjes së vështirë ekonomike dhe statusit social të gazetarëve.

Më konkretisht, nga 27 parime, sigurohet mbrojtje e plotë për shtatë standarde evropiane të lirisë së medias: liria për të ushtruar profesionin e gazetarit (4), aksesimi në media të partive politike (5), mosdiskriminimi i gazetarëve të huaj (6), liria për të zgjedhur gjuhën e komunikimit (7), kufizimi i të drejtave ekskluzive të raportimit (9), evitimi i pronësisë së fshehtë të shtetit në media (22), dhe ndalimi i angazhimit të njëkohshëm midis punës në institucione qeveritare dhe aktivitetit profesional në media (23).

Më konkretisht, shteti apo faktorë të tjerë nuk kanë vendosur kufizime të asnjë lloji për arsimimin në gazetari dhe praktikimin e profesionit të gazetarit. Madje është krejt e kundërta, një pjesë e komunitetit të medias mendojnë se hyrja në gazetari dhe ushtrimi i profesionit të gazetarit kryhet mbi baza tepër liberale. Po kështu, edhe akreditimi dhe aktiviteti i gazetarëve të huaj në vend nuk është penguar në asnjë lloj mënyre, megjithëse ata janë të paktë në numër dhe punojnë kalimthi në Shqipëri.

Nuk ka pengesa për median në varësi të gjuhës që duan të përdorin, duke krijuar kështu një atmosferë ku mediat në gjuhën shqipe dhe ato në gjuhë të huaj gëzojnë të njëjtën mbrojtje ligjore, dhe njëkohësisht vuajnë nga të njëjtat probleme ekonomike, pasi legjislacioni nuk parashikon subvencione për asnjë media. Në të njëjtën kohë, edhe legjislacioni mbi kufizimin e të drejtave ekskluzive të raportimit siguron një mbrojtje të arsyeshme të aksesit të publikut në transmetimin e aktiviteteve të veçanta, por enti rregullator pritet të hartojë së shpejti një rregullore në lidhje me zbatimin e këtyre ligjeve dhe mbetet për t'u parë nëse do të ketë ndonjë ndryshim në këtë drejtim.

Po kështu, aksesimi i partive politike në media nuk paraqet ndonjë problem, pjesërisht si rrjedhojë e numrit të madh të emisioneve politike në stacionet kryesore televizive, gati për çdo ditë të javës, por edhe falë ligjeve strikte mbi raportimin në media gjatë fushatave elektorale. Për më tepër, edhe ekuilibri politik në panelet e debateve televizive është bërë normë pune për shumicën e emisioneve politike. Nga ana tjetër, ka patur kufizime të aksesit të medias në aktivitete politike dhe gazetarët nuk kanë patur mundësi të raportojnë vetë mbi këto aktivitete, pasi partitë duan t'i prodhojnë vetë kronikat e fushatës. Kjo situatë është kthyer në një burim shqetësimi për mediat, ka shkaktuar një mungesë motivimi për gazetarët, dhe ka shkaktuar kritika edhe nga vetë media për raportimin e aktiviteteve politike .

Ndërkohë që struktura e pronësisë së medias në vend është parë gjatë këtyre viteve si një karakteristikë e veçantë që ka shoqëruar proceset e zhvillimit të saj, pronësia e fshehtë e shtetit në media nuk ka qenë ndonjëherë pjesë e problemeve të medias. Por ama, kjo nuk do të thotë se marrëdhënia e shtetit me pronësinë e medias nuk ka ndikuar në peisazhin mediatik, vetëm se jo në kuptimin e pronësisë direkte apo indirekte të aksioneve në kompanitë e medias. Në të njëjtën kohë, dhe ndarja e angazhimit të njëkohshëm në institucione qeveritare dhe aktivitetit profesional në media si pjesë e ligjeve mbi papajtueshmërinë me rolin e zyrtarit publik, si dhe legjislacionit mbi konfliktin e interesit.

Gati të gjitha parimet e Këshillit të Evropës janë relativisht të garantuara me ligj, por në praktikë zbatimimi i këtyre ligjeve çalon disi. Ka shumë arsye komplekse për këto mangësi në respektimin e ligjeve që lidhen me dinamikën dhe zhvillimin e sistemit mediatik, si dhe kontekstin më të gjerë politik dhe social në vend.

Për disa nga treguesit e analizuar në këtë studim problemi kryesor ishte legjislacioni i mangët, që nuk ishte harmonizuar plotësisht me ligjet evropiane, si në rastin e gjetjes të një raporti të drejtë midis mbrojtjes të sekretit shtetëror dhe lirisë së informimit (treguesi 10), mbrojtjes të anonimatit të burimeve konfidenciale të informacionit (8), sigurimin e aksesit të barabartë të mediave në kanalet e transmetimit dhe shpërndarjes (16). Në disa raste legjislacioni nuk parashikon krijimin e mekanizmave të nevojshme për të siguruar zbatimin e ligjeve, në forma gjobash apo sanksionesh, si në rastin e sigurimit të aksesit në informacion për të gjitha mediat nga ana e autoriteteve (24).

Legjislacioni shqiptar e njeh të drejtën e respektimit të konfidencialitetit të burimeve të informacionit për gazetarët, dhe në praktikë nuk ka patur raste problematike në gjykata. Sidoqoftë mbrojtja e anonimatit të burimeve të informacionit nuk është garantuar në bazë të kritereve ezauruese të udhëhequra nga parimet e interesit publik, por është lënë në dorë të vullnetit dhe dëshirës së mirë të gjykatave, që nuk përbën një mekanizëm të shëndoshë mbrojtës.

Po kështu edhe mbrojtja ligjore e jetës private vihet zakonisht në peshore kundrejt mbrojtjes të së drejtës të shprehjes dhe informimit, dhe krijimi i institucionit të Komisionerit të Lirisë së Informimit dhe Mbrojtjes të të Dhënave Personale është një përpjekje për të gjetur një ekuilibër të kënaqshëm midis këtyre dy të drejtave themelore. Sidoqoftë, si pasojë e rezistencës së institucioneve dhe degradimit të etikës gazetareske, që është veçanërisht e dukshme në mediat online, ka një prirje për të vënë më shumë në përdorim ligjet e sekretit shtetëror, rregullore, madje edhe rekomandime të vjetra mbi mbrojtjen e privatësisë për ta fshehur informacionin nga sytë e publikut, duke krijuar kështu hapësira dhe mundësi që pretendimet për mbrojtjen e sekreteve shtetërore dhe jetës private të kufizojnë ndjeshëm lirinë e informimit.

Legjislacioni garanton parimisht një akses të lirë dhe të drejtë në kanalet e shpërndarjes dhe transmetimit nëpërmjet infrastrukturës teknike. Në praktikë, platformat digjitale private ishin krijuar dhe konsoliduar shumë përpara miratimit të ligjeve për trasmetimet digjitale, dhe për rrjedhojë u krijua një situatë ku aplikimet për licensa kombëtare digjitale ishin të kufizuara vetëm për disa media të caktuara, megjithëse ligji garantonte parimin e aksesit të barabartë dhe të padiskriminuar të mediave që do të transmetonin në këto platforma. Nga ana tjetër, në fushën e mediave të shkruara, megjithëse kemi dy rrjete private distribucioni që kryejnë shpërndarjen e shtypit të shkruar, nuk janë regjistruar probleme serioze të aksesit të mediave në këtë shërbim.

Ndonëse legjislacioni shqiptar për lirinë e informimit është cilësuar si një nga më të mirët në botë, ka akoma pengesa për zbatimin e tij në praktikë. Ka gjithashtu diferenca në zbatimin e tij ndërmjet institucioneve të ndryshme të qeverisë, parlamentit, dhe gjyqësorit, ndërsa aksesit në informacion nuk është gjithmonë i hapur për të gjitha mediat në mënyrë të barabartë dhe të ndershme, në varësi të politikave të tyre editoriale, por edhe në bazë të zotësisë së gazetarëve për të krijuar dhe mbajtur kontaktet me burimet e informacionit. Në të njëjtën kohë, numri i ankesave mbi aksesin në informacion, të drejtuara nga mediat dhe qytetarët ndaj Komisionerit për të Drejtën e Informimit, janë shtuar, por legjislacioni nuk është shumë i qartë në lidhje me dënimet për zyrtarët publikë që refuzojnë të japin informacion dhe zbatimin e tyre duket se nuk ka patur shumë efekt.

Në grupin e tretë të treguesve që u shqyrtuan në këtë studim, legjislacioni nuk është zbatuar plotësisht, apo është zbatuar në mënyrë selektive dhe shpeshherë duke rënë ndesh me frymën e ligjit. Edhe në këtë pikë është e vështirë të bëhen përgjithësime mbi një situatë kaq komplekse, por arsyeja kryesore duket të jetë vlerësimi me prioritet më të madh i interesave të faktorëve të veçantë, si politika apo biznesi, në vend që t'i kushtohet më shumë rëndësi zbatimit të përpiktë të legjislacionit në fuqi. Një pjesë e fajit për këtë rast i mbetet sistemit gjyqësor, që për momentin është institucioni më pak i besueshëm nga populli, i cili nuk tregon gjithmonë vazhdimësi në vendimet e veta, dhe nuk respekton krejtësisht standardet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me parimet e mbrojtjes ligjore për të drejtën e lirisë së shprehjes (1), dhe lirisë për të kritikuar zyrtarët shtetërorë (2). Kjo përzierje e mangësive në ligj, institucioneve të dobëta, mungesës së traditës, si dhe ndikimeve të jashtme ekonomike dhe politike, shpjegon dhe problemet që hasen

në arritjen e standardeve evropiane në lidhje me pavarësinë dhe efikasitetin e entit rregullator (15), si dhe pavarësinë e radio televizionit publik (20 dhe 21).

Shpifja dhe fyerja vazhdojnë të konsiderohen si kundërvajtje penale në ligj, megjithëse është hequr dënimi me burg. Sidoqoftë, problemi më i madh në këtë pikë nuk është aq shumë ndryshimi i ligjit se sa paqartësia dhe paqëndrueshmëria në vendosjen e gjobave për dëmtimin e nderit dhe reputacionit. Megjithëse në përgjithësi gjykatat kanë favorizuar lirinë e shprehjes, dhe politikanët apo persona të tjerë kanë tërhequr paditë kundër medias, praktika tregon se nuk ka garanci për paanshmërinë e gjykatave dhe njohurive e tyre mbi rolin parësor që ka liria e shprehjes në standardet dhe praktikën evropiane.

Radio televizioni publik ka vuajtur gjithmonë nga përshtypja negative e publikut në lidhje me pavarësinë e tij, objektivitetin, dhe cilësinë e programeve. Kjo ka ardhur si rezultat i konkurrencës agresive nga operatorët privatë, por edhe si pasojë e një amullie shumëvjeçare në këtë institucion, dhe harresës apo lënies pas dore të radio televizionit publik nga politika. Sidoqoftë, situata financiare e RTSH-së është përmirësuar ndjeshëm këto vitet e fundit falë mbledhjes me efikase të taksës së televizorit nëpërmjet faturës së dritave. Nga ana tjetër, barra fiskale e RTSH-së është rritur si pasojë e ndërtimit të dy rrjeteve publike digjitale kombëtare, dhe duket se as ligji dhe as ndonjë vendim qeverie nuk e mbrojnë qëndrueshmërinë dhe autonominë e RTSH-shë në këtë drejtim, megjithëse qeveria deri tani ka dhënë ndihmën e saj për ta zgjidhur pjesërisht këtë problem.

Një nga pikat e dobëta është edhe vetë mënyra e zgjedhjes të organizmave drejtuese të radio televizionit publik, pasi kjo duket se përforcon përshtypjen e publikut se ndikimi i politikës mbi këtë institucion është akoma shumë i fortë. E njëjta situatë ndeshet edhe në raport me entin rregullator, AMA, ku aplikohet një formulë dhe proces i ngjashëm në përzgjedhjen e anëtarëve të bordit drejtues. Po kështu, edhe përvoja e kaluar me angazhimet politike të ish-drejtimesve të entit rregullator, veçanërisht pas largimit të tyre nga AMA, përforcon përshtypjen se megjithë emërimet nga shoqëria civile, zgjedhja e këtyre personave nga partitë politike e kompromenton plotësisht këtë proces.

AMA ka avancuar në aprovimin e legjislacionit dhe rregulloreve të reja, ka çuar përpara procesin e kalimit në trasmetimet digjitale, që në fillim ishte menduar të përfundonte në korrik 2015, si dhe është munduar të përforcojë autoritetin e saj mbi operatorët audiovizivë dhe t'i detyrojë ata që të respektojnë detyrimet e tyre. Sidoqoftë, puna e këtij institucioni u pengua për një kohë të gjatë nga ndarjet brenda bordit drejtues, mungesës së anëtarëve për të arritur kuorumin për votime, si dhe nga procese gjyqësore. Po kështu, objektiviteti dhe paanshmëria e anëtarëve të AMA-s u vu në provë në lëshimin e licensave digjitale kombëtare, ku katër nga pesë licensat private janë në përonësi të dy grupeve kryesore mediatike në vend.

Sistemi i medias në Shqipëri ka ngelur shumë prapa në krahasim me standardet evropiane në lidhje me modelet ekonomike që përdor, mungesën e garancive në mbrojtjen e pavarësisë editoriale përballë presioneve ekonomike, si dhe organizimin e dobët nga ana e gazetarëve për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Këto probleme vijnë pjesërisht nga legjislacioni i mangët, si në rastin e transparencës së pronësisë dhe parandalimin e monopoleve në media (18), neutralitetin e ndihmës ekonomike nga buxheti i shtetit (19), si dhe dështimi në gjetjen e zgjidhjeve ligjore dhe ndërtimit të një tregu mediatik që favorizon pavarësinë në politikën editoriale (13). Në këtë kontekst legjislacioni është i mangët, i vështirë për t'u zbatuar në praktikë, dhe nganjëherë i kundërvihet edhe frymës së përgjithshme të garantimit të lirisë së medias dhe pluralizmit.

Ndryshimi më i fundit në dispozitat ligjore mbi pronësinë e mediave audiovizive ishte një goditje e fortë ndaj garancive ligjore për pluralizmin në media, ndërkohë që edhe rregullimi i reklamave shtetërore ka ngecur në vend për shumë vite me radhë, megjithëse të gjithë e pranojnë se ato rregulla janë të paqarta dhe i lënë rrugë të lirë shpërndarjes të padrejtë të parave publike. Në rastin e sigurimit të pavarësisë të politikave editoriale ligji përmban vetëm një deklaratë të thjeshtë për garantimin e saj, por kjo është fare e pamjaftueshme për zbatimin e saj në praktikë.

Nga ana tjetër, do të ishte gabim po t'i prisnim të gjitha zgjidhjet nga legjislacioni, pasi ai nuk mund të jetë zgjidhja magjike për të gjitha problemet e trashëguara nga sistemi shqiptar, që kanë kontribuar në degjenerimin e sistemit aktual të medias në një treg kaotik, jofunksional, jo transparent, ku mbizotërojnë interesat ekonomike të operatorëve të medias, me nivel të ulët të vlerësimit të misionit të gazetarisë nga individët që e ushtrojnë këtë profesion, lidhje shumë të ngushta dhe ndërvarësi midis medias dhe biznesit, dhe ndikimi i fortë që kanë ndaj njëri-tjetrit. Këto 25 vitet e fundit të historisë të mediave shqiptare kanë treguar se ndërveprimi i influencave politike dhe ekonomike ka ndikuar goxha në formëzimin e legjislacionit, por edhe në shkallën e zbatimit apo injorimit të ligjit, ashtu si ka ndodhur edhe në fusha të tjera të jetës së vendit, në kuadër të përpjekjeve të të gjithë shoqërisë për të përmirësuar zbatimin e ligjit.

Në këtë kontekst, pavarësia editoriale dhe mbrojtja e profesionit të gazetarit janë padyshim viktima të prioriteteve ekonomike dhe politike që janë të ndërthurura me sistemin e medias. Gazetarët e gjejnë shpesh veten nën presionin e biznesit dhe politikës dhe për pasojë bien prapa në mënyrë rutinë e vetëcensurës, duke preferuar më mirë që të ruajnë vendin e punës, në vend që të sakrifikojnë interesat personale për ato publike. Zbatimi i dobët apo selektiv i Kodit të Punës dhe kushtet e pafavorshme të punës në media janë një tjetër faktor dekurajues. Gjithashtu edhe mbrojtja e pamjaftueshme që ofrohet nga ato pak organizata profesionale, si pasojë e organizimit të dobët të gazetarëve në këto struktura, mungesës e solidaritetit dhe traditës, nuk janë garanci e mjaftueshme për të nxitur rritjen e nivelit të profesionalizmit në rradhët e gazetarëve.

Rekomandime

Situata aktuale në media është pasojë direkte e problemeve të lidhura ngushtë me qëndrimin e politikës kundrejt medias, prirjeve të tregut dhe dinamikave në media, evoluimin e profesionit të gazetarit, zbatimin si duhet të legjislacionit, si dhe problemin e ngritjes të institucioneve publike të pavarura dhe të besueshme. Të gjendur përballë këtij realiteti kompleks do të ishte naivitet që të pretendohet se mund të ofrohen rekomandime si çelës magjik për të zgjidhur çdo problem në situatën aktuale të mediave shqiptare. Sidoqoftë, ky raport mundohet të rrisë nivelin e ndërgjegjësimit të palëve të interesuara mbi këto probleme, të ofrojë një monitorim të peisazhit mediatik shqiptar, dhe të tërheqë vëmendjen në disa fusha ku ka mundësi për përmirësime.

Politikat në media

- Politikëbërësit duhet të zgjidhin problemet ekzistuese me standardet ligjore në lidhje me lirinë e shprehjes dhe dhe gjetjen e ekuilibrit përkundër të drejtave të tjera, dhe veçanërisht mekanizmave që mbikqyrin dhe garantojnë zbatimin e tyre në mënyrë të drejtë, transparente, dhe të barabartë.
- Trajnimi i gjykatësve mbi aplikimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe standardeve të lirisë së shprehjes në gjykime duhet të jetë pjesë e rregullt e trajnimeve të tyre profesionale.
- Institucionet e pavarura si komisioneri i informimit dhe mbrojtjes së të dhënave, kundër diskriminimit, i konkurrencës, etj. duhet të mbështeten më shumë me njohuri teknike, trajnime dhe mbështetje për përmirësimin e mekanizmave të monitorimit ligjor dhe sistemit të mbledhjes të ankesave nga publiku.
- Pavarësia dhe autoriteti i enteve rregullatore duhet të përforcohet nëpërmjet aprovimit të procedurave të reja që kufizojnë ndërhyrjet dhe presionet politike ndaj tyre, si dhe duke shtuar nivelin e transparencës dhe dhënies së llogarisë ndaj publikut.
- Ndryshimet ligjore dhe adoptimet e politikave të reja për median duhet t'u nënshtrohen procesit të konsultimit me një bazë të gjerë të aktorëve të angazhuar në fushën e medias, por kjo nuk duhet të kthehet në një formalitet të thjeshtë. Gjithashtu, vendimet mbi politikat në media duhet të bazohen mbi rezultatet dhe gjetjet e studimeve, punës kërkimore ne terren, dhe të dhënave të mbledhura në fushat respektive.

Ekonomia e medias

- Duhet të inkurajohen dhe promovohen iniciativa të përbashkëta të kompanive mediatike për të përmirësuar transparencën në tregun e reklamave për median, dhe për të realizuar studime dhe zondazhe për të marrë të dhëna dhe shifra të sakta mbi audiencën dhe lexuesit e mediave.
- Shpërndarja e fondeve shtetërore për median nëpërmjet reklamave apo mënyrave të tjera duhet të rregullohet në rrugë ligjore në mënyrë të qartë dhe të drejtë, duke lejuar që të kryhet edhe monitorimi i procesit të shpërndarjes së fondeve.

- Duhet të inkurajohen iniciativat që kanë për qëllim të përmirësojnë transparencën financiare të medias.
- Autoriteti i konkurrencës duhet të marrë në konsideratë monitorimin e tregut të medias për të shmangur përqëndrimin e medias në pak duar, apo praktikat e konkurrencës të pandershme.
- Duhet të inkurajohen praktikat e konkurrencës së drejtë, duke siguruar që si radio televizioni publik ashtu edhe operatorët audiovizivë privatë të respektojnë njëlloj legjislacionin në fuqi.
- Duhet të inkurajohen përpjekjet e radio televizionit publik për të orientuar programacionin e tij drejt temave apo shërbimeve me interes publik, ndërkohë që duhet kërkuar një transparencë më e madhe nga ky institucion.

Shoqatat e gazetarëve dhe organizatat profesionale

- Përmirësimi i zbatimit të të drejtave të punës të gazetarëve dhe monitorimi nga ana e autoriteteve në këtë fushë është një detyrë urgjente, që duhet të mundësojë një mbrojtje më të mirë të të drejtave të gazetarëve.
- Forcimi i organizatave profesionale të gazetarëve dhe aktiviteteve të sindikatave duhet të kontribuojë në krijimin e një komuniteti profesional më të fortë, që të jetë në gjendje të përmirësojë lobimin për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e veta.
- Do të ishte diçka pozitive përmirësimi i vazhdueshëm i kurikulave në shkollat e larta të gazetarisë, e shoqëruar kjo me një përfshirje më të gjerë të njohurive praktike për studentët e gazetarisë.
- Përmirësimi i nivelit të profesionalizmit në gazetari duhet të inkurajohet nëpërmjet konkurseve, dhënies të çmimeve, apo aktiviteteve të ngjashme.

